

*Bashkia Shkodër
Biblioteka
“Marin Barleti”*

- *editorial*
- *intervistë*
- *albanologji*
- *letërkëmbim*
 - *arkiv*
 - *tradita*
 - *letërsi*
 - *ese*
 - *kritikë*
- *përkthime*
- *in memoriam*
- *bibliografi*
- *recension*

Gegnia

*e përkohshme
kulturore-artistike*

*1 - 2016
Vjeti I i botimit
Shkodër*

Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

*1 - 2016
Vjeti I i botimit,
Shkodër*

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

1 -2016

Vjeti I i botimit,

Shkodër

Redaksia: Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Lisandri Kola

Botohet nën kujdesin e bashkisë Shkodër dhe bibliotekës “Marin Barleti”

Adresa e redaksisë: Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

info@bibliotekashkoder.com

Shënim:

Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.

▪ <i>editorial</i>	
“Gegënia” në kërkim rrajëve të identitetit	5
▪ <i>intervistë</i>	
Intervistë me studiuesin Willy Kamsi	8
▪ <i>albanologji</i>	
Át Justin Rrota - Lavruesët e shqipes	14
Martin Camaj - Mërgimi i gjuhës	24
▪ <i>letërkëmbim</i>	
Nexhmi Bushati - Një bashkëpunim modest përmes një letërkëmbimi miqësor	28
▪ <i>arkiv</i>	
Ekspertizë mbi disa krijime letrare të P. Arbnorit	40
▪ <i>tradita</i>	
Tonin Zadeja - Shoqëria “Vllaznia” (1919)	53
▪ <i>letërsi/autorë të traditës</i>	
Hamit Gjylbegaj - Poezia e bukuris	65
Pjetër Gjini - Nji shikim!	
Qemal Draçini - Bjen shi	
Gasper Pali - Prendimi i andrrimeve	
Pashko Gjeçi [Pa-Gjë] - Ecco Homo	
Mirash Ivanaj - Nata e fundit	
Arshi Pipa - Vjeshtë e dytë	
Muhamet Ademi [Hesperus] - Pa titull	
▪ <i>ese</i>	
Muzafer Pipa - Frenezi botimesh	73
Kolec Traboini - Poetika e fëminisë	78

- ***kritikë***
Lisandri Kola - *Nji motiv i përbashkët mes Mehmet Ali Pasha dhe Të shtatë kralat rrehin telin*86

- ***përkthime***
Vincens Marku - *Nicolas Boileau “l’Art Poetic”, 1674*.....101

- ***in memoriam***
Komisia Letrare e Shkodrës në 100 vjetorin e saj
Shefik Osmani - *Komisia Letrare Shqipe*112
At Gjergj Fishta117

- ***bibliografi***
Fatmira Lekiqi - *Gjurmë të At’ Shtjefën Gjeçovit në Bibliotekën Publike “Marin Barleti”*123

- ***recension***
Arben Prendi - *Mbi sprovën etnomuzikologjike “Pse qanë kuajt e Akilit? “E qara me bote” dhe prejardhja e iso-polifonisë popullore shqiptare”*128

“Gegnia” në kërkim të rrajëve të identitetit

Prezantimi i revistës ‘Gegnia’, ban pjesë në projektin për artin dhe kulturën që ka iniciue bashkia e Shkodrës, e që do të pasohet edhe me evente të tjera kulturore në të ardhmen. Asht hera e parë në këto njëzet e pesë vjet që një institucion i pushtetit lokal mbështetë daljen e një reviste kulturore si kjo. Kjo revistë, në këtë kuadër, përban një nismë të randësishme për përtrimjen e jetës kulturore artistike të qytetit të Shkodrës në veçanti, por edhe trevës së Veriut në tanësi, tue përfshi këtu pa mëdyshje, edhe trevat e Veriut të Shqipnisë Etnike: Kosovën, shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi etj. Po kështu edicioni i kësaj të përkohshmeje asht një përpjekje me ecë në shembullin e gazetave dhe revistave me emën që ka pasë ky qytet në vitet 1920-1944 e në vazhdim, si: ‘Hylli i Dritës’, “Agimi” ‘LEKA’, ‘Cirka”, “Fryma” etj., të cilat si pasojë e ardhjes së regjimit komunist e ndërprejnë aktivitetin e tyne.

Fatkeqsisht prej vitesh në qytetin e Shkodrës kanë mungue, me ndonji përjashtim, revista kulturore të kësaj natyre. Shpresojmë që “Gegnia” të bahet një mundësi ma shumë me artikulue disa prej problemeve e fenomeneve letrare, artistike, gjuhësore e studimore që po ndodhin këto kohë në kulturën tonë kombëtare e për të cilat asht e nevojshme dhe e dobishme me reflektue e me reague. Reflektime e reagime të cilat do të jenë të mirëprituna e do të kenë hapësinën e duhun në numrat e ardhshëm të revistës “Gegnia”.

Formati i kësaj reviste, çka asht e vërteta, dallon prej edicioneve tradicionale prejse ka kritere dhe interesa të tjera për me paraqitë intesitetin dhe dinamikën e zhvillimeve kulturore-artistike që ndodhin në arealin gegëfolës por edhe ma tej në kulturën mbarëshqiptare. Ekzistenca e të përkohshmes ka si prioritet me dëshmue potencialin e kulturës gege në krejt dimensionin e vet, sigurisht pa përjashtue të dhana e shkrime me interes e në dobi të kulturës sonë kombtare, si edhe artikuj e studime shkencore për çashtje të ndryshme albanologjike apo tjetër fare. Argumentat ma të randësishëm që do të zanë vend në faqet e revistës do të jenë ato me temë albanologjike: gjuhësi, letërsi,

histori, etnografi, kritikë letrare por edhe tema që kanë të bajnë me artin në tanësi: kinema, pikturë, muzikë, teatër, përkthim apo edhe tema socio-kulturore etj.

Shtyllat e strukturës së revistës do të jenë: mendimi i traditës dhe prumjet e reja studimore, letrare e kulturore, gja që përputhet me misionin e saj, siç e kemi vu në dukje; ndriçimi, rizbulimi, afirmimi i kulturës gege të traditës e të tashmes, si pjesë e kulturës mbarëkombtare e ndërkohë artikulimi e studimi i problematikave të tjera të randësishme për kulturën e kombin shqiptar.

Emni i revistës asht simbolik, siç janë zakonisht emnat e revistave, dhe synon me simbolizue shtresat e një tradite shumëshekullore gege në kulturën kombëtare me reflektimin se: me kthye shikimin kah traditat e mira të kulturës sonë asht një model me ecë kah e ardhmja në rrugën e duhun të përparimit tonë kulturor e shoqnor. ‘Gegnia’ lypet me u pa si alternativë kulturore dhe e drejtë legjitime; e hapun dhe e mirëpritun për secilin, larg çdo paragjykimi të mundshëm apo definicioni arbitrar. Prandaj janë të ftuem të bashkëpunojnë të gjithë ata që kanë kualifikimin e duhun me thanë diçka në fushat e masipërme: me opinonet e tyne, me fakte të panjohuna, dorëshkrime të arkivës, reflektime, artikuj, studime, kritikë letrare, krijime letrare, biseda, përkthime etj., lidhun me problematikat apo veprat kulturore të së kaluemes, të tashmes dhe të së ardhmes. Shkrimet kanë me u pranue si në variantin gegë ashtu edhe gjuhën standarde, mjafton të përmbushin kriteret për botim, si edhe të jenë të radhituna në kompjuter. (Për materialet në dorëshkrim, që i përkasin arkivave familjare apo arkivave të tjera, sigurisht redaksia merr përsipër përgatitjen për botim).

Revista në thelb asht apolitike, por kjo nuk do të thotë se nuk do të kenë vend hulumtimet e analizat serioze e shkencore për probleme të randësishme të jetës sociale e politike të së kaluemes, të tashmes apo të së ardhmes. “Gegnia” besojmë se do konfrontohet në vijim me tematika që janë ende tabu në mendsinë e shoqnisë e të kulturës shqiptare. Kjo revistë, pra, duhet pá vetëm si një alternativë kulturologjike, në shërbim të afirmimit të artit dhe kulturës shqiptare në marrëdhانيت intesive me artin e kulturën evropiane.

Numri i parë që del sot para jush, asht ma fort një numër që fton për ndërmendje tue evokue disa figura të randësisishme të kulturës shqipe, gege, që shtrihet në nivel gjuhësor, letrar e ma përtej kulturor. Pa u ndalë ma gjatë në shpjegime të rastit, i urojmë publikut lexim të kandshëm.

Qoftë ky numër i parë fillimi përvujtës i një pune të mbarë!

Redaksia

Gjuha e përbashkët shqipe dhe gegënishtja

Intervistë me studiuesin Willy Kamsi

Ish ambasadori i parë i Shqipnisë në Vatikan, studiuesi, publicisti dhe bibliofili i njohun Willy Kamsi në intervistën e dhanë ekskluzivisht revistës sonë, trajton disa prej çashtjeve ma të mprehta me të cilat ballafaqohet gjuhësia dhe kultura shqiptare. Ndër të tjera ai shprehet se “politika e ndjekun gjatë kohës së komunizmit jo vetëm ka qenë e damshme në vetvete, sepse ka shkelë të drejtat e pamohueshme për identitetin dhe zhvillimin e një kulture e të një bashkësie kaq të gjanë si është ajo geqe në Shqipni e përtej. Gegnishtja si gjuhë krahinore duhet vlerësue jo vetëm si pasuni gjuhësore e gegëve, por si një pasuni gjithkombtare. Si gegë si toskë janë dhe e kanë ndie veten një popull të vetëm e të pandashëm, prá popull shqiptar, e dallimet në mes tyne nuk kanë atë randësi sa me e përcaktue një gjendje të acarue me e cila e nxitun qiti krye me rasën e trazirave dhe kaosit të vjetit 1997.” Gjithashtu ai vlerëson se: “Sot, kur Shqipnia andrron të hyjë në Bashkimin European, duhet që të kihet mendja se, pa respektue të drejtat më elementare të njeriut, dhe një pamje e këtyne janë gjuha e kultura, dëshiri për me hy n’Europë ka me mbetë kurdoherë një andërr, sepse me veprime të ngurta nuk hapen dyert e saja.”

Pyetje: Ka shumë përkufizime për gjuhën shqipe. Sipas jush cili kishte me kenë kumti i saj?

Përgjigje: *Synimi i vijueshëm i shqiptarëve ka qenë lavrimi dhe zhvillimi i gjuhës së vet, tue u vlerësue kjo si veçantí dalluese e kombit, si element bashkues në pikëpamje atdhetare, ashtu si është edhe 28 Nandori, dhe vetëm ky.*

Pyetje: Cili ka qenë roli që kanë luejtë autorët e vjetër e në përgjithsësi letërsia shqipe në ruejtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe?

Përgjigje: *Mjafton të përshkohet letërsia për me pá se sá vjersha janë shkruet me këtë synim, sa proza është marrë me problemin e gjuhës, dhe kjo qysh në kohët më të vjetra. E, kur thomi të vjetra,*

menden e kemi të autorët e parë të gjuhës shqipe, autorë veprash dhe përkthimesh, në të cilat si shtysë përmendet rreziku i humbjes së gjuhës shqipe, shëj dallues i të qenit shqiptar, e me humbjen e saj të humbjes së tipareve të veçanta etnike. E, po i përmendëm, do të kemi ndër ta emna të shquem si bj.fj. Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi, etj.

Por përpjekje të tilla nuk shterrën kurr, madjë edhe nga shkrimtarë të njohun, si Faik Konica, një ndër stilistët më të mirë të toskënishtes. Te revista Albania (I/1897, nr. 8, f.126), tue folë për nevojën e zhvillimit të gjuhës e të afrimit të dialekteve, shprehet në këtë menyrë: “Që të jetë [shqipja] gjuhë si të tjerat duhet të përzjehet Toskërishtia me Gegënishten, në mos në të kuvenduar, në të shkruar. Duhet të përzjehen dal nga dal, dhe nga kjo përzjejtje të dalë një gjuhë e re dhe e shëndoshë: gjuha shqip e përgjithshme.”

Pyetje: Me që jemi te dialektet e shqipes, cili është mendimi i Juej rreth tyre ?

Përgjigje: *Dialektet më së pari janë pasuní gjuhësore e popullit tonë. Æsht e kjartë se nuk mund të bashkohen dialektet me një përziemje sikurse e shprehte Konica, por vrehet dëshiri i zjarhtë që ai kishte për me pasë një gjuhë të vetme dhe se kjo duhet të jetë, prap simbas mendimit të tij, kryesisht, fryt i bashkëveprimit të të dý faktorëve, atij gegë e atij toskë.*

Megjithatë edhe me dý dialekte nuk mund të thohet se shqiptarët nuk qenë të bashkuem. Të gjithë ata që, gegë ose toskë, lexuen e kuptuen autorët dhe shkrimet e palës tjetër, nuk diftuen kurrnjihërë në të kaluemen ndonji vështirësi për t'i kuptue. Nuk ndodhi kurr që të kishte mosmarrëveshje, moskuptime në mes tyre. Të gjithë bashkë luftuen për gjuhen shqipe edhe kur turku mbytte me helm atdhetarët që luftojshin për të. Madjë u shijuen veprat letrare si të Fishtës, ka toskë që e dijnë përmendësh, të Prennushit e të Mjedjës, si anasjelltas të Naim Frashërit apo të Fan S.Nolit e të Mitrush Kutelit. Vështirësitë lindën kur u fut në mes politika, në veçanti ajo komuniste, me të cilën lindi dëshiri me luftue kulturën e gegëve, që përbajnë 2/3 e shqiptarëve, e që shpesh u cilësuen edhe si anmiqtë kryesorë të diktaturës komuniste.

Pyetje: Këtë vit u mbushën plot 100 vjet nga dita e themelimit të Komisionit Letrar në Shkodër. Cili ka qenë roli i saj në përcaktimin e gjuhës letrare?

Përgjigje: *Tue u kthye te argumenti, me të cilin jemi tue u marrë, nuk do të lamë pa vrejtë se Komisia Letrare në Shkodër, e cila trajtoi çashtjen e gjuhës kombtare, mbas një studimi që u krye në Shqipëri dhe në Mesme, nga Dom Ndre Mjedja e Gjergj Pekmezi për anën shqiptare dhe nga Maximilian Lambertz e Rajko Nachtigall për anën austriake, mbërriti në përfundimin se: caktimi i gegënishtes së Elbasanit ishte zgjedhja më e përshtatshme për me u ardhë kërkesave shkencore të një gjuhe kombtare për të gjithë Shqipërinë, sepse, tue qenë ky dialekt në kapërcyell në mes gegënishtes e toskërishtes, paraqite ato veçanti të posaçme që e bajshin të kuptueshëm e të pranueshëm si për gegë ashtu edhe për toskën. Këtu duhet të vëmë në dukje se vendimi i Komisionit Letrar ishte në mënyrë të veçantë përmes gjykimeve, i përshtetun në paravijime shkencore e atdhetare, për me mbërritë në përfundimin që thamë më sipri. Misëti i Komisionit, tue qenë në shumicën absolute shkodranë, shkrimtarë vetë, lavrues të letërsisë gegë, përjashtoj prej tyre vetëm Sotir Pecin, nuk zgjodhën gegënishten shkodrane si gjuhë kombtare, por atë të Elbasanit, dhe për këtë qëndrim u jemi mirënjohës për sjelljen e tyre burnore.*

Pyetje: Cili është mendimi i Juej për vendimet e Kongresit të drejtshkrimt të vjetit 1972?

Përgjigje: *Për disa arsye e argumenta krejt politikë ishte kunorëzim i veprës së nisun, qysh me 1944, për zhdukjen e gegënishtes e të kulturës gegë. Theksonte Faik Konica, para 46 vjetësh, në hipotezën e zhdukjes së gegënishtes: «të duash të ndryshojsh të folmen e një populli, don të thotë të ndryshojsh karakterin e tij, të shkatërrojsh personalitetin e tij». (Albania, po aty).*

Të kemi parasysh se në disa raste, tue ndjekë atë rrugë, u arrit deri në veprime plotësisht antishkencore e të dënueshme, sikurse «përkthimi» toskënisht i folklorit gegë; sllavizimi i emrave katolikë tue e shndërrue Shën Shtjefnin e Shkodrës në Shën Stefan, e me këtë tue lehtësue realizimin e mëtimeve antishqiptare të fqinjëve tonë;

ndërrimi i emnit të Dhimitër Frangut në Dhimitër Frëngu, sepse, mbasi kështu na e paska shkue Fan Noli, kështu po na pëlqeka edhe ne ta shkruejmë. Argument «shkencor» me të vërtetë bindës! Kthimi toskënisht, bje fjala, i përkthimit fillestar të Iljadës, bâ prej Gjon Shllakut, ka prû shtimin e mâ se 300 vargjeve, sepse pasunia leksikore e gegënishtes mund të shkapërcehej vetëm me perifrazimin, në gjuhën «e njësuar», të çdo fjale që shprehte në mënyrë të plotë e lapidare kuptimin e vet. Dëshmi e kuartë kjo se gegënishtja zotnon një pasuni mâ të madhe e mâ të spikatun leksikore se sa toskënishtja, e se humbja e saj rrjedhimisht âsht një humbje kulturore për gjithë Shqipninë.

Si argument sillet se shqiptarët nuk janë në gjendje të kuptojnë e të shijojnë veprat klasike gegënisht. Mbasi këta po na i lexokan, në gjuhën origjinale autorët, edhe klasikë, frengë, italianë, gjermanë, anglezë e të sa gjuhëve të tjera e nuk po paskan vështirësi me i kuptue, ndonse janë gjuhë që nuk janë të linduna te shqiptari, si âsht e mundun të mos jenë në gjendje të lexojnë e të kuptojnë gegënishten që prapseprap âsht gjuhë shqipe? Por tue u kthye te pohimi i parë, një pohim i lëshuem krejt pa përgjegjësi, me një synim të kuartë diskriminues, edhe sikur të ndodhte, kjo nuk âsht për fajin e tyne. Si mund të jetë që gjuha shqipe gege (nuk po e cilësoj dialekt sepse përmasat e letërsisë gege, si art i të shkruemit, e kanë ngritë në gjuhë kundrejt konceptit të dialektit), prá gjuha gege te na qenka tepër e vështirë, kur dihet se vetë mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e Shqipnisë pat qenë kufizue vetëm në disa pak klasë të shkollës tetëvjeçare, e në një nivel shumë t'ultë. Në ato moshë, në çdo shkollë jepen sa fillimet e mësimin të gjuhës. Njohunitë gjuhësore, normalisht, nga një nivel shkollor në tjetrin, duhej të ecshin në rritje. Por kjo nuk ndodhte te na e kjo mungesë shkaktoi në përgjithësi një përpërgatitje gjuhësore kronike, sidomos kur edhe gegënishtja qe hjekë krejt prej mësimin. Kështu u krijue njëzbraztinë e ndieshme në themel për me njohë gjuhën dhe këtë e vërejmë ditë për ditë në çdo shfaqje të jetës, si në shtyp ashtu edhe në radio-televizion. Prandej pohime të tilla nuk kanë kurrfarë arsyeje që të qindrojnë. M'anë tjetër, me një politikë të kuartë shkombtarizuese, gjuha ruse mësohej 8 vjet rresht, ndonse me

pak përfitim për shkak të mohimit në shpirtin e shqiptarit për serbë e rusë, të cilët me shekuj ishin përpjekë për zhdukjen e kombit shqiptar prej këtyne trevave.

Politika e ndjekun gjatë kohës së komunizmit jo vetëm ka qenë e damshme në vetvete, sepse ka shkelë të drejtat e pamohueshme për identitetin dhe zhvillimin e një kulture e të një bashkësie kaq të gjanë si është ajo gege në Shqipëri e përtej. Gegënishtja si gjuhë krahinore duhet vlerësue jo vetëm si pasuní gjuhësore e gëgëve, por si një pasuní gjithkombtare.

Si gegë si toskë janë dhe e kanë ndie veten një popull të vetëm e të pandashëm, prá popull shqiptar, e dallimet në mes tyre nuk kanë atë randësi sa me e përcaktue një gjendje të acarue e cila e nxitun qiti krye me rasën e trazinave dhe kaosit të vjetit 1997.

Pyetje: Ju hyni në grupin e studiuesve që mendoni se duhet bënë një Kongresi i ri gjuhësor. Arsyeja?

Mbledhja e një Kongresi të ri është një domosdoshmëni. Tue marrë në shqyrtim gjendjen e sotme të gjuhës, tue parapá një veprim të përbashkët efektiv të gegënishtes e të toskënishtes, mbasi janë të dyja pjesë e një trupi të vetëm, si dhe tue vendosë bazat për një zhvillim të harmonishëm e të drejtë të gegënishtes, si element bazë i kultures gege, do të arrihet te zhvillimi i plotë i gjuhës shqipe të përbashkët, që ka me u vendue në pajtim të plotë me të drejtat për ekzistencë të të gjitha atyne dallimeve që janë veçantí themelore e vetë kombit shqiptar

Pyetje: A mendoni se problemet gjuhësore si elemente të kulturës lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut?

Gjuha si element parësor i kulturës është e randësishme për ngritjen e ndryshueshmënisë kulturore në rangun e trashigimisë së përbashkët të njerzimit. Dhe kjo me unanimitet adoptohet prej Shteteve Antare të UNESCO-s, të mbledhuna në Konferencën e 31^{të} të Përgjithshme, tue pohue edhe njëherë, me këtë rasë, bindjen e tyne dialogu ndërkulturor është garancia më e mirë për me sigurue mirëkuptim e paqe. Dhe me këtë shmanget njëherë e përgjithmonë çdo arsye për mosmarrëveshje.

Sot, kur Shqipëria andrron të hyjë në Bashkimin Europian, duhet që të kihet mendja se, pa respektue të drejtat më elementare të njeriut, dhe një pamje e këtyne janë gjuha e kultura, dëshiri për me hy në Europë ka me mbetë kurdoherë një andërr, sepse me veprime të ngurta nuk hapen dyert e saja.

Intervistoi: Gjovalin Çuni

Lavruesët e shqipes

Qyshë prej kohësh shqipja, këjo gjuhë e çuditëshme dhe krykëput e dallueme nga të folmet e popujvet t'Europës, nisi të shquejë interesin dhe vemenden e etnografëvet, filologëvet dhe të glotologëvet.

Për të pasun një idé pak a shumë të qartë mbi ata, që u muernë me shqipen drejt për drejt ase tërthuer, e gjykuem t'arsyeshme t'u kushtojshim një kapitull edhe albanologëvet, mbassi gramatika jonë përmban një pjesë të randësishme, - mbi brumin e shqipes, - që është fryt i mundit të tyne: pra u kufizuem mâ fort me linguistë se sa me etnografë e historjanë.

Dhe prej elenkut të tyne zgjodhmë asish mâ në shenj, të cilët për kontribut që kishin dhënë, meritojshin t'u njiheshin nga rishtarët tanë e nga amatorët e shqipes.

Leibnitz (1646-1716)

1.“Gjuhësia porsi një dituní e posaçme e ndertueme përmbi methodën krahasuese është kenësisht një prodhim i fillimit të 19 shekull, por interesi i dijtunís europjane për gjuhën shqipe është shumë mâ i vjetër. Shpirtilargpërfshís i një Leibnitz-it (Gottfried Wilhelm 1646 -1716) pau qyshë një shekull para themelimit të gjuhësis krahasuese, pra në fillim të 18 shekull , mes depertues, probleme që mund t'u lidhshin me një hulumtim të gjuhës shqipe, çâshtjen e gjinís të popujve europjanë, të bashkëlidhënis të gjuhëve europjane përgjithësisht (sikur çâshtjen e bashkëlidhënis të gjuhëve gjermane e kelte), e në fund çâshtjen e rrjedhjes së popullit shqiptár, geni i tij e pau por edhe premisë methodologjike të parë për përgjigjen e të gjitha këtyne çâshtjeve e tjerave si kto: me dá shka është në gjuhë shqipe të vjetër e të trashiguem prej shka është të rí e të marrun huá” (Jokl). Ky dijetar poliedrik, pra, qe i pari që nxiti kërkimet mbi gjuhën shqipe, dhe u përpoq të cilësojë natyrën e saj. Për këtë shprehet, përveç letravet, në veprën: “Dëshiret rreth gjuhëvettëpopujvet - Desiderata circa linguas populorum”. Për të shqipja është një gjuhë e pavarëshme nga gjuhët e tjera.

Thunmann (1746-1778)

2. Për njohunin e shqipes ndëkoi aso kohe edhe historjani gjerman, Thunmann (Hans Erich) profesor i universitetit të Halle-s. Auktori në veprën “Kërkime mbi historin e popujve t’Europës Lindore - Untersuchungen über die Geschichte der östlichen europäischen Völker, Leipzig, 1774, ndalet e flet gjatë mbi çashtjen etnografike të banorëve. Si njohësmâ i kthellët i shqipes, me auktoritetin e një linguisti të randësishëm, ky dijetar mund të quhet prisi a udhëhjeksi i Gustav Meyer-it, tue përcaktue, me provë të patrandëshme, origjinën e popullit dhe të gjuhës shqipe.

Këta e paraqiti ndër fletët (169-366) të veprës së naltpërmendun *Mbi historin dhe gjuhën e Shqiptarëve dhe të Vllehëve* - Über die Geschichte und Sprache der Albaner und der Wlachen. Thunmann-i ribotoi edhe fjalorin e Kavaliotit, i domosdoshëm për atë kohëpërnjohjen e shqipes.

Malte Brun (1775-1826)

3. E drejta e lypë, që në rendin e ndriçuesëve të shqipes të zihet në gojë edhe emni i gjeografit të njohun danez Malte Brun (1775-1826). Ky dijetar i mbështetun mbi njohunit që pat prej Leibnitz-it, Thunmann-it dhe Marci-t, në veprën e vet: *Shkurtore e dheshkonjës së përgjithëshme - Précis de la Géographie Universelle* (1810-29), shkuen ndër të tjera: “Gjuha shqipe âshtë në fund të fundit po ajo që flitej do shekuj përpara Homerit. Këjo nuk ndryshon fort nga gjuha mâ e vjetra, mâ pagdhenuna dhe mâ monosilabikja e Pelasgjëve”. Kështu shprehej aso here i naltpërmenduni Auktor; sado që historia gjykon sod ndryshe për ekzistencën e Pelasgjëve.

Kopitar (1780-1844)

4. Një interes të gjallë për gjuhën shqipe tregoi filologu dhe glotologu i shquem sloven, Kopitar (Jernej 1780-1844), i cili studjoi *Marrëdhënjet mjes gjuhëve rumene, bullgare dhe shqipe* - Über gegenseitigen Berichtungen der rumänischen, bulgarischen und

albanischen Sprache (Jahrbücher der Literatur, Wien, 1826-1829). Mandej Mbi gjuhën e kombit rumen e shqiptár: Über die rumänische und albanische Sprache und Nation (1826); disertatjon mbi gjuhën shqipe, vllehe (valake) e bullgare: *Abhandlung über albanische, walachische und bulgarische Sprache*, Wien, 829. Ky bashkë me Vuk-un “njohnë gjuhën shqipe si një dishiplinë ndihmëse me randësi të studjimeve sllavistike përgjithsisht (Kopitar) e të veprimit të përmbledhjes folkloristike (Vuk)” (Jokl).

Leake (1777-1860)

5. Një drejtim edhe mâ të caktuem, me baza dhe hulumtime përherë e mâ të sigurta, filloi të kishte shqipja, kur duel në dritë vepra e topografit dhe arkeologut anglez, William Martin Leake(1777-1860). *Kërkime në Greqi - Researches in Greece*, London 1814. Oficjer marine, pat rasë të njohë, ndër sa vende të tjera, sidomos të Mjesdheut, Greqín, dhe këtu kolonít shqiptare. Këjo veprë përmban edhe një gramatikë të vogël shqipe.

Xylander (1794-1854)

6. Tue i shtue shumë materjalit gjuhësuer të shqipes, posë atij të mbledhunit djeri atëherë, linguisti gjerman Xylander (J.Ritter von Xylander) përfundoi studjimet e veta mbi gjuhën tânë, tue botue librin: *Gjuha e Shqiptarëvet - Die Sprache der Albanischen oder Schkipetaren*, Frankfurt am Main, 1835. Vërejtjet e holla të veta Xylandri i bani rreth strukturës morfologjike të shqipes, mâ fort se mbi fjalorin e saj; në të cilin kishte bashkue nj’ a 3500 fjalë. Mjerisht por studjimet e tija nuk dhanë frytin që pritej. Albanologu i mâvonshëm, Fallmerayer, thotë për veprën e tij, se “këjo doli si një trupore e bukur, por e pashpírt, djeri që erdhi Hahn-i, i cilli dha frymë, jetë e gjallëni.” Xylander-i âshtë për karakterin indoeuropjan të shqipes.

Hahn (1811-1869)

7. Por ai që ndritë me një shkëlqim të posaçëm ndër të gjithë albanologët e deritashëm âshtë Hahn-i (Dr. Jur. Johann Georg von

Hahn) konsull austro-hungar në Janinë, i cili zotnon një kulturë të shkëlqyeshme të shumllojëshme, këthellohet ndër studimet klasike, historike e mytologjike edhe ndër hyn ndër to në mënyrë krijuese, por, sikur e thekson shprehimisht ai vetë, rrin larg prej studimeve indogjermanistike. E prá sá shum shkas detyron shì atij hulumtimi i gjuhës shqipe e njohunia e historís shqiptare”(Jokl). Vepra e tij mmonumentale *Studime shqiptare - Albanische Studien*, Jena-Wien 1853-54, áshtë një enqiklopedi e vërtetë, për shekullin e vet, mbi Shqipni, historin dhe gjuhën e saj. Ky i çeli shtegun dhe i nxiti albanologët e botës, mâ fort se kurrnjë para si, t’u shpërvjelshin e t’a merrshin në dorë çashtjen e problemevet albanologjike. Vepra përmban edhe një fjaluer kun 5000 fjalësh e një gramatikë të mirë mbi djalektin toskë, ku auktori shkon tue bâ krahasime ndërmjet dy djalektevet, tue folë mbi fenomenet fonetike dhe morfologjike.

Fallmerayer (1790-1861)

8. Mbas rendit kronologjik vjen këtu vepra e historjanit gjerman Jakob Philip Fallmerayer (1790-1861), profesor i historís së përgjithëshme në München. Ky, mbassi shetiti disa herësh nëpër Greqi, Siri, Palestinë e Azi të Voglë, botoi kryeveprën e vet: *Elementi shqiptár në Greqi - Das Albanische Element in Griechenland*, 1857-1860, ku qet në shesh elementin shqiptár e sllav në Greqi. Auktori në këtë veprë i ban një kritikë t’ashpër botimit të Nicocles¹, me të cilin përpiquej të qitte poshtë përfundimet e pionerit të albanologjis, Gjergj Hahn-it mbi autoktonin e Shqiptarëvet.

¹*De Albanesium sive Schkipetar origine et prosopia*, Göttingen, 1855.

Bopp (1790-1861)

9. Por që do të caktonte pozitën e gjuhës shqipe në pikëpamje ditunore njëherë e përgjithmonë, me gjithë ndonjë pohim të kotë të ndonjë linguisti të mâvonëshëm, qe glotologu i përmendun Franz Bopp-i (1790-1861), themeluesi i gjuhësis krahasuese indoeuropjane, njëkohësisht me dijëtarin danez Rask-un. Këtâ mâ së parit e provoi me disertacioni, që lexoi në akademín e Berlinit

në vj. 1843 *Mbi numërorët e përemnat e gjuhës shqipe*; më vonë me botimin: *Mbi shqipen në marrëdhënie t'afërta me gjuhë motra* - Über das Albanische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen (Berlin, 1854-55). Në këtë veprën e fundit dijetari merr në shqyrtim jo përemnat e numërorët, por mbarë gjuhën: lakimin, zgjedhimin, trajtimin e emnavet e pjesët e pandërrueshme. Si material gjuhësuer i shërben Frangu i Bardhë, Da Lecce, Xylander e sidomos Hahn-i.

Schleicher (1821-1868)

10. August Schleicher (1821-1868) glotolog i përmendun, profesor në Pragë e në Jena i dha zhvillim të madh gjuhësis indoeuropjane. Kryevepra e tij është *Shkurtorja e gramatikës krahasuese të gjuhëve indoeuropjane - Compendium der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*, Weimar, 1861-62. U muer edhe me studjimin e lituanishtes, tue shkruar një gramatikë, ende sod, të çmueshme: *Handbuch der litauischen Sprache*, Prag 1856-57.

Ky dijetar, megjithëse e cilëson shqipen si indoeuropjane, ndjekë një rrugë të gabueme, tue e afrue shqipen me greqishten e italishten në grupin e quejtun pelasgjik.

Pott (1802-1887)

11. Një tjetër linguist i përmendun, por që mjerisht për çka i përket shqipes merr fare më thue, tue u shkëputë prej rrugës së drejtë të Boppit, qe Pott (August Friedrich 1802-1887). Simbas tij shqipja nuk ban pjesë në familjen indoeuropjane: është një tepricë para-indoeuropjane iliropelasgjike; numërorët e shqipes janë të huajtun prej sllavishtes. Ky u muer sidomos me marrëdhënjat mjes glotologjis dhe etnografis. Me randësi është, ende sod, studjimi mbi gjuhët e gabelëvet - *Die Zigeuner in Europa und Asien*, Halle, 1845.

G. Stier (-)

12. Në të njëjtin vjet, në të cilin Bopp-i provoi lidhën e shqipes me gjuhët indoeuropjane, një tjetër linguist gjerman, Teophil Stier përpiquej të përcaktonte, nëse Shqipja, është një gjuhë indoeuropjane - *Ist die Albanesische Sprache eine indogermanische Sprache?* (1854).

Ky qyshë mâ përpara kishte nisë me u marrë me probleme të shqipes. Në vjetin 1853 botoi një artikull mbi Shqiptarët e Italisë e letërsinë e tyre. Në vjetin 1856, boton të përkthieme gjermanisht pêsë kângë të De Radës. Mâ vonë harton një essai mbi emnat e ngjyruvet në shqipet - *Die Albanischen Farbennamen* (1884). Për këto punimet e fundit u mbështet në Reinhold-in. Përkimet me greqishten e me latinishten - për çka u përket emnavet të shtasëvet të veprës së naltpërmendun - nuk janë përgjithësisht,

Simbas Stier-it, huazime, por burime të përbashkëta. Origjina e shqipes për mâ tepër, na thotë, do kërkue në një kohë kur nuk flitej kun as greqishtjaas latinishtja!

Kamarda (1821-1882)

13. Prap një shkas të fort i dha studjimit të shqipes pranë glotologëvet të Europës, albanologu arbëresh nga Piana e Shqiptarëvet, Dhimitër Kamarda (1821-1882), arhimandritë i Katolikëvet të ritit grek në Livorno. Kryevepra e tij njehet: *Provë ase pasqyrë e Grammatologjís së krahasueme mbi gjuhen shqipe - Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua Albanese*, Livorno, 1864, Me randësi për studjimin e shqipes është edhe: *Shtesë gramatologjís së krahasueme mbi gjuhën shqipe - Appendice al saggio di Grammatologia comparata sulla lingua Albanese*, Prato, 1866. Këjo veprë e Kamardës ishte, si thotë Ascoli, punimi mâ i gjâni e mâ i imtuemi i Gramatologjís së krahasueme, që pau dritën në mbanë Gadishullin e Italisë. Krejt njashtu si ndonjë vjet mâ vonë i pëlqei albanologut të madh të Graz-it t'a shtynte djeri në tepri ndëkimin e latinishtes në shqipet, po ashtu edhe Kamarda e gjykoi tepër të madh ndikimin e greqishtes në gjuhën tânë.

Ascoli (1829-1907)

14. Me problem shqiptare u muer si për rrëshqit edhe glotologu i përmendun Italian, Ascoli (Graziano Isaia (1829-1907). Ky në *Studjime kritike - Studi Critici*, 1861 shqyrton disa Fragmente shqipe të nxjerruna prej veprës së Hahn-it, të cilavet u ven në krye disa kundrime të mprehta etnologjike e historike rreth shqiptarëvet

(Petrotta). Meyer-i ka një çmim për të, dhe e citon shpesh.

Asht i njohun propozimi i Ascoli-t për të studjue mbishkrimet enigmatike etruske me anën e shqipes. Një përpjekje të tillë e pat bâ edhe Otto Blau, profesor i Leipzig-ut, qyshë mâ përpara, por me përfundime mjaft të dyshimta, për të zhvillue mbishkrime enigmatike të Licjes me shqipen.

Miklosich (1813-1891)

15. Një peshë mjaft të madhe u shtoi studjimevet shqiptare linguisti me famë botnore, pionier i albanologjis, Franz Miklosich (1813-1891), professor në universitet të Vjenës, me origjinë slovene. Æshtë i pari sllavist, që bani studjime të kthella e të matuna mbi të gjitha gjuhët slave. U muer edhe, posë së tjerash, me studjimin e të gjitha gjuhëvet balkanike. Përveç studjimesh mbi gjuhët sllave, për interesin tånë është për t'u përmendë vepra: *Hulumtime shqipe - Albanische Forschungen*, botue trí radhësh: 1. *Elementat slave në shqipet - Die slavischen Elemente im Albanischen*, Wien, 1870; 2. *Elementat romanë në shqipet - Die romanischen Elemente im Albanischen*; Wien, 1871; 3. *Trajta e verbavet të huajtun në shqipen e ndër gjuhë të tjera - Die Form entlehnter Verba im Albanischen und einigen anderen Sprachen*, Wien, 1871. Mandej janë për t'u përmendë: *Kërkime rumene - Rumänische Untersuchungen* (1881), ku zbulon përkimet mjes rumenishtes, shqipes e gjuhëvet të tjera balkanike; *Elementat e turqishtes ndër gjuhë t'Europës lindore dhe juglindore - Die Türkischen Elemente in den südost-osteuropäischen Sprachen* (1884-1881). Miklosich-i është themeluesi i sllavistikës e paraprîs i Meyer-it në fjalorin etimologjik.

Schuchardt (1842-1927)

16. Një rrugëgatitës i brezit të parë të albanologjis, si e quen Jokl-i, bashkë me Miklosich-in, është Hugo Schuchardt (1842-1927) Romanist i shquem, profesor në Leipzig, Halle e së mbarimit në Graz bashkë me Meyer-in prej 1876-1900. Në këtë vjet u tërhoq prej katedre, për të kalue tanë jetën, po në këtë qytet, tue u marrë vetëm me punë shkencore. Filloi mâ së parit me studjimin e latinishtes

vulgare. Vepra e tij: *Vokalismus des Vulgärlateins*, Leipzig, 1866-68, është ende sod me vlerë themelore, ku shqyrtohen reflekset latine, pose gjuhësh së tjera edhe në shqipen e ndër gjuhët balkanike. Mâ vonë u muer me të gjitha problemet e romanistikës. Mbi influksin e latinishtes përgjithësisht (tue përfshí edhe shqipen) shkroi në “*Zeitschrift v. verg. Sprachforschung* XX (1872). Këtij dijetari do t’i dihet nxitja që pat Meyer-i me i u kushtue gjuhës shqipe.

Meyer (1850-1900)

17. Për shumicën e botimevet, për zotsí, zéll e mundë rreth shqipes, emni i albanologut gjerman Gustav Meyer (1850-1900) është i lidhun ngusht me gjuhën tânë. Meyer-i është mâ i madhi përfaqësues i albanologjis të shekullit të kaluem, dhe bashkë me Pedersen-in e Jokl-in formon triadën albanologjike. Lindi në Gross-Strehlitz (Shlezje) dhe diq në një shmendore në Felhof (afër Graz-it) ku qe vjet me rradhë profesor universiteti. Mâ së pari u muer me kërkime të gjuhësis klasike, latine e greke. Mandej mbassi botoi një gramatikë greke (1889), u muer edhe me greqishten mjesjetare: *Neugriechische Studien*, Wien 1894-95.

Por emni i tij do të mbette i padekëshëm për zbulimet e ndryshme mbi gjuhën shqipe. I shtymprej Schuchardt-it u kushtue me gjithë shpirt gjuhësisë shqipe. Vizitoi Greqín e Italín, sidomos kolonít shqiptare, aktiviteti i tij fillon në 1881. Botimet e tij janë:

- *Albanisches* (artikull në “*Allgemeine Zeitung*” 1881);
- *Über Sprache und Literatur der Albanischen - Mbi gjuhën e letërsín e Shqiptarëvet*, 1883; Artikull që e botoi mâ vonë të zgjanuem e të modifikuem në rev. “*La Nuova Antologia*” (1885);
- *Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëvet indoeuropiane - Die Stellung der Alb. Im Kreise, der Indoger. Sprachen* (Beiträge zur Kunde d. Indog. Sp. VIII., 1884) ku shqipja paraqitet si faza moderne e një dialekti ilirik.
- *Studjime shqipe - Albanische Studien*, 6 fashikuj botue prej Akademís së Vjenës (1883-1897).

- *Trajtimi i emnavet shqip - Die Pluralbildung der Albanischen Nomina* (1883);
- *Numërorët e shqipes - Die Albanischen Zahlwörter*, 1884;
- *Fonetika e elementavet indoeuropjanë të shqipes - Lautlehre der indogermanischen Bestandteile des Albanischen*, 1892. Ky studijm i përshtërimit mbas botimit të gramatikës e të fjalorit etimologjik është më i randsishmi në këtë kategori dhe që bazë edhe për të tjerë;
- *Leksiku greqisht-rumenisht-shqip i Kavaljotit - Das Griechisch-Rumänisch-Albanische Wörterverzeichnis des Kavalliotis*, Herausgegeben, und Erklärt, 1895
- *Kontribut për njohunin e djalektevet të foluna në Greqi - Beiträge zur Kenntniss der in Griechenland gesprochenen Albanischen Mundarten*, 1896;
- *Kontribut për njohunin e djalektevet të ndryshme shqipe - Beiträge zur Kenntniss verschiedenen Albanischen, Mundarten*, 1897;
- *Influksi i latinishtes në morfologjin shqipe - Der Einfluss des Lateinischen auf die Albanische Formenlehre* (art. në rev. "Miscellanea" ecc. Firenze, 1886.)
- *Elementat latinë në shqipet - Die Lateinischen Elemente in Albanischen* (në Grundriss der Romanischen Philologie) 1888;
- *Shkurtore e gramatikës shqipe me copa leximi e fjalorth - Kurzgefasste Albanischen Grammatik mit Lesestücken und Glossar*, Leipzig, 1888;
- *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe - Etymologisches Wörterbuch der Albanischen Sprache*, Strassburg, 1891. Por si bazë për këtë fjalor ka atë të Hahn-it, e për etimologjin e fjalëveve tjetër, me arsye, si paraprís Miklosich-in. Mjerisht fjalori është i mbushun me fjalë të ishujvet gjuhësorë; me greqizma, italianizma e turqizma, në vend që të shfrytëzonte më mirë shkrimtarët e vjetër, e të bante ndonjë udhëtim ndër zonat më të rrejtunat prej influencës së huaj. Ai e mendon tepër të madh ndëkimin e latinishtes në shqipet; aqë më, sá

shqipja - na thotë - për një qyme flokut, shpëtoi pa u njehë për gjuhë romanze: ndër 5000 fjalë, që përmban fjalori i tij, vetëm 400 i nxjerrë me rrânjë indoeuropiane. Por shumë etimologjî të tija qenë qitë poshtë e provue mâ vonë si autoktone, sidomos prej Pedersenit e Jokl-it. Sidoqoftë, fjalori etimologjik i Meyer-it qëndron edhe sod, mbas mâ se një gjymsë shekulli, si i vetmi në këtë gjini.

- *Fjalët e huajtuna slave, shqipe e rumune në greqishten e ré - Die Slavischen, Albanischen und rumäischen Lehnworte im Neugriechischen, Wien 1894 (Në “Neugriechischen Studien” II).*

Mjerisht qe jetëshkurtë, dhe, çka mâ zi, për shkak të sëmundjes mendore, do vjet para saj, e këputi veprimin e vet ky albanolog i madh. Po të kishte pasë jetën e gjatë, kush e di ç’farë mendimi do të kishte formue rreth shqipes: gjatë studjimeve të mâvonëshme ai shkoi tue tërhjekë disa mendime të veta, sidomos për rreth ndonjë etimologjije.

Vijon në numrin e ardhshëm

(Marrë nga: Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*. Bot.I, Shkodër, Botime Françeskane, 2006, ff. 563-571)

Mërgimi i gjuhës¹

Shpresoj qi prej përmbajtjes ka me u kuptue çka don me shprehë titulli i kumtesës time, mâ e shkurta qi unë kam lexue deri tash përpara një auditori kaq të meritueshëm. Shumë prej gjanave qi keni me ndigjue bâjnë pjesë në qëndrimin mâ të thellë qi unë kam mundë me mbajtë ndaj ngjarjeve qi i kanë ra për hise gjuhës time. Prej kësaj rrjedh, në një farë mënyret, edhe shkâku ma i thellë qi më ka shtye me u marrë si shkenctar me gjuhën.

Tue qenë se në rasën time bâhet fjalë edhe për ndjenjat dhe jo vetëm për një studim të ftohtë shkencór, e ndjej vedin në vendin e shkrimtarit francez Georges-Artur Goldsmith, kur ky flet për gjuhën amtare : “Gjuha amtare âsht në fund të fundit kumbimi i formave qi fëmija zbulon për herë të parë. Gjuha âmtare asht frymëmarrja e veçantë e trupit njerëzor, âsht pragu për te elementat e hapsinës “

Ky çansim nuk âsht në kundërshtim me at’ çka ndërmmerr puna hulumtuese shkencore, historike (diakronike e sinkronike) qi në fazën e tashme të shqipes zhvillohet në dy drejtime:

- A) si gjuhë natyrale e ndame në degzime dialektikore e në kontakt me gjuhët e tjera që e rrethojnë.
- B) si gjuhë artificiale, n’cilën përdoren mjete kufizuese të dhunshme, krejtsisht në kundërshtim me zhvillimin e natyrshëm të vetë gjuhës.

Ka rreth njëzet vjet qi në Shqipnî po vazhdon procesi i normalizimit të gjuhës, i cili nuk merr parasysh randësinë e dialekteve e të historisë ase të dokumentave si: dorëshkrime, tekste letrare etj. Me lejoni, tashti me ju prû disa të dhana historike të nevojshme. Për me kuptue mirë strukturat e këthella historike të gjuhës shqipe âsht e domosdoshme me njohtë marrdhânjët qi ajo ka pasë më latinishten e vonshme, gjuhë më të cilën ka një periudhë afirmitetit. Llogaritet qi kontakti me latinishten të ketë fillue gjatë shek. II p. Kr.

1 Kumtesë e mbajtur në Universitetin e Salerno-s, më 2/12/1991.

Tue punue në mënyrë paralele mbi shndërrimet qi kanë ndodhë në të dyja gjuhët mundemi me rindërtue historinë e shndërrimeve të tingujve (Lautverschiebung). Tue u nisë prej këtyne shndërrimeve mundemi me shestue rishtas trajtat qi kanë përplotsue mâ vonë sistemet gramatikore të gjuhës shqipe. Ndër këta rindërtime gramatikore duhet me marrë parasysh edhe tharmet e përmbrendshme të gjuhës shqipe, tue i lidhë gjithmonë edhe me zhvillimet qi i kanë rranjët te baza indoeuropiane. Periudha prej shekujve IX-X m. Kr. Deri te shekulli XVI, përfaqson një fazë shumë të randësishme, atë qi na sot e quejmë faza e “shqipes së vjetër”.

Ekziston edhe një teori me baza shkencore, simbas së cilës shumë pjesë të Ungjillit e të Dhjatës së Vjetër të përfshime në “Meshar” të Buzukut, i përkasin një periudhe para 1555, vjetë në t’cilin u botue vepra. Këto pjesë, të mbajtura prej nesh si mâ të përshtatshme janë përkthye prej liturgjisë greke. Janë tekste qi kanë një gjuhë e një stil të ndryshëm në krahasim me ata qi ka përkthye Buzuku vetë. Megjithatë shihet në këtë tekst një gjuhë koherente. Në këtë kohë fillojnë me u dukë diferencimet ndërmjet gegnishtes, qi nuk e ka fenomenin e rotacizmit, dhe tosknishtes qi i nënshtrohet këtij fenomen. Bile, kishe me thanë, qi këtu bâhet fjalë për një fazë të shqipes qi studjuesat gjermanë, qysh prej shekullit të kaluem, e kanë quejtë: Gemeinalbanisch (shqipja e përbashkët).

Mbas pushtimit turk, qi nisë prej shekullit XVI, fillon edhe Zersplitterung (copëtimi) i dy degëve gramatikore të shqipes. Kah ana tjetër edhe mbrenda për mbrenda secilit dialekt ky copëtim sjell krijimin e të folmeve të reja. Gegnishtja ka fatin me i pasë të dokumentueme të gjitha këto struktura gramatikore. Por, këto venome (privilegje), dialektologjia e sotshme shqipe nuk i ka shfrytzuë aspak e aq mâ pak ata qi gjinden në krye të procesit të krijimit të normës së saj. Kështu, në njëzet vjet (1952-1970), âsht krijuë në Shqipni një gjuhë letrare, të cilën Enver Hoxha, si nun i saj, e pagzoi tue e quejtë “gjuha kombëtare”. Në zhvillimin e këtij procesi të krijimit të normës gjuhsore nuk u përfill historia, pra, tradita e gjuhës shqipe, e cila, si u pa mâ sipër, ka një randësi të madhe. Rruga e mënyrës së krijimit të normës së “gjuhës kombëtare” âsht vendosë vetëm prej politikanëve,

prej një grupi të Byrosë Politike me prejardhje prej jugut të Shqipërisë.

Kundërshtimet e shkencatarëve, ndërmjet të cilëve bëjnë pjesë dy lavrues të vjetër të kësaj gjuhe, shqiptari Aleksandër Xhuvani e gjermani Max Lambertz, nuk patën asnjë efekt. Lambertz-it i gjegji Enver Hoxha vetë, tue i thanë: “Ky është një vendim politik!” Absurditeti i kësaj politike u kritikue për vjet me rradhë prej Arshi Pipës, ndër shkrime që tash së fundi janë përmbledhë në një vëllim prej rreth treqind faqesh prej Columbia University Press, me titull: “Politics of Language in Socialist Albania”.

Teoria themelore që drejtoi procesin e ndjekun për zbatimin e normës, që në të vërtetë është vë në jetë me dhunë, i përket Stalinit. Gjuha e fituesit përgjithsohet e bëhet gjuhë e shtetit. Hoxha, në vend të gjuhës, imponoi praktikisht dialektin e vet, asë më mire, një prej nëndialekteve të tosknishtes lindore. Gjuhëtarët shqiptarë duhet t’u bindeshin vetëm urdhnave që vijshin prej nalt. Ecurija mbështetej në mënyrën induktive, pa përfillë traditën.

A) çdo variant tjetër gjuhsor letrar u ndalua, në veçanti ai i veriut, që si e pamë, është më i vjetri e më i pasuni me tekste e është më i përdoruni prej shumicës së popullit shqiptar. U pengue edhe zhvillimi i tosknishtes tradicionale letrare, në veçanti përbësja e saj përëndimore, që është zhvillue në hapsinën prej bregut shqiptar të Jonit deri në Peloponez e prej aty bashkohet me zonat arbëreshe të Italis jugore. Këtu është trashigue një traditë letrare e zgjedhun e tanë sqimti, e ngjashme me klimën e butë mesdhetare. Gjithë kjo zonë ka karakteristika gjuhsore të përbashkëta që e dallojnë këtë të folme prej tosknishtes përëndimore.

B) për gati një gjysë shekulli para ardhjes së stalinizmit, tre variantet letrare janë zhvillue lirshëm në një simbiozë harmonike. Weigand-i, Nachtigal-i, Pekmezi, ky i fundit ishte një shqiptar me nënshtetësi austriake, Xhuvani e deri edhe autorë veriorë si Fishta e Gurakuqi (Karl), këshilluen që unjisi i gjuhës zyrtare të mbërrihej nëpërmjet “avitjes” së dy gjuhëve letrare kryesore, gegnishtes dhe toskenishtes. Kjo gja duhej me u krye jo në mënyrë të vrazhdë, por në një kohë të gjatë. Në të vërtetë, deri në 1944 shoqëria shqiptare zhvillohej në një rreth simbiozet familjare, kulturore e gjuhsore. Në

veçantí në Tiranë qenë mâ të ndieshme kontaktet gjuhsore ndërmjet atyne qi përdorojshin dialekte të ndryshme. Ky afrim ishte dashtë me u ndjekë me kujdes për me gjetë rrugën mâ të drejtë me punue për unjisimin e gjuhës. Këta janë treguesit qi procesi i krijimit të një norme të udhëhequn prej parimesh të drejta, ishte dashtë me ndjekë. Por, kjo gja nuk qe e mundun, mbasi gjuhësia shqiptare, fatkeqsisht, nuk kishte bazat e veta të zhvillueme në mënyrë të mjaftueshme.

C) A ka mundësi sot për me ndreqë gabimet e bâme? Kishe me thanë se po. Ne kemi sot shumë metoda dhe përvoja në fushën e gjuhësisë moderne. Do të ishte e këshillueshme për çdo komb qi, përpara se me ia hí punës për krijimin e normës themelore të gjuhës së vet, të mbante parasysh zhvillimin gjuhsor. Âsht e domosdoshme puna parapërgatitëse: duhet mbajtë mend qi për secilen pjesë të gramatikës ekzistojnë monografi të plota qi s' duhen lanë mbas dore.

D) Âsht e domosdoshme qi sot në Shqipni të zhvillohet një shkollë e re gjuhsore.

Tue përfundue, uroj qi edhe në Shqipni të ketë ardhë koha në të cilën nuk kanë me qenë mâ politikanët ata qi do të vendosin për çashtjet gjuhsore dhe letrare. Qi çdo vendim, në veçantí ata qi i përkasin tanë Kombit, të merret në përputhje me vullnesën e shumicës së popullit: idealja kishte me qenë një pëlqim i gjithanshëm, por kjo âsht e tepërt sot për sot.

Përktheu prej italishtes: Ardian Ndreca

(Marrë nga: "Phoenix". E përkohshme kulture, Viti VI, nr. 4-6 (30-32), 2002, ff. 201-205)

*Një bashkëpunim modest përmes
një letërkëmbimi miqësor*

(Hamdi Bushati - prof. Eqrem Çabej)

Nuk e teproj sa herë marr në dorë “epistolarin” e të ndjerit babait tim, Hamdi Bushati, kur them se ndihem i “zënë ngushtë”: gishtat e mi prekin letra e kartolina, të zverdhura tashmë nga koha, shkruar dekada më parë, disa edhe para 70-80 vjetësh, nga personalitete që, me ndonjë përjashtim, tani nuk rrojnë më, por që i lanë nder vetes, kombit e kulturës sonë. Para sysh më kalojnë autografet e Lumo Skendos, Ilo M. Qafëzezit, Osman Myderrizit, Hamit Gjylbegajt, Lefter Dilos, Myqerrem Janinës, Tahir Dizdarit, Jonuz Tafilajt e, më “të rinjve” Aleks Budës, Rrok Zojzit, Kristo Frashërit, Stavri Naçit, Qemal Haxhihasanit, Vexhi Buharasë, Ibrahim Hoxhës etj., por midis tyre edhe ai i të mirënjohurit prof. Eqrem Çabejt.

Ndonëse, si ish student (me korrespondencë) i Profesorit e që jam ulur para tryezës së Tij, më se një herë, për t’iu shtruar provimeve të fakultetit, ia kam borxh, ashtu si armata e tërë studentëve të tij, nderimin e merituar, tani është letërkëmbimi i lartpërmendur kudo të përqëndrohem në këto radhë.

Le të jenë këto radhë modeste një tregues i thjeshtë homazhi për ish-punonjës që çdo mjet, qoftë dhe letërkëmbimin e zakonshëm, e vunë në shërbim të kulturës sonë.

Kam në dorë kopjet e 8 letrave (14 faqe të daktilografuara) të dërguara nga im atë si dhe 2 kartolina të Profesorit dhe një kartvizitë të Zonjës Çabej që falënderon për ngushëllimet e marra me rastin e vdekjes së bashkëshortit të shquar.

Letra e parë mban datën 1.12.1996, kurse e fundit 6.8.1966. Nga se, që në letrën e parë, hyhet në temën menjëherë, pa ritualin e zakonshëm të prezantimit, lë të kuptohet se duhej të ishte një njohje e mëparshme. Janë dy-tre fakte që tërthorazi e mbështesin këtë hamendje.

Së pari, Profesori ka qënë mësimitdhënës, për disa kohë në

gjimnazin e Shkodrës, ndërkohë që Hamdi Bushati që drejtues shkollë e, njëheri, bashkëpunonte me shtypin e kohë, sidomos me periodikët “Kalendari Kombiar” e “Diturija”, raste të përshtatshme për njohje. Në revistën “Leka” (vitet 1933,1935,1939), ky i fundit kishte botuar tre artikuj mbi toponomastikën e tre fshatrave të Shkodrës (Bushat, Kosmaç, Melgush). Përderisa këto punime tërhoqën vëmendjen edhe të albanologëve të shquar të N. Jokl e Karlo Taljavini, të cilët i ribotuan në revistën me prestigj “Indogermanische Jahrbuch” të viteve 1935, 1937, 1941 (sipas P.Daka, “Kontributet për bibliografinë e gjuhës shqipe” në “Studime filologjike”, nr.3,4/1966 dhe nr.1/1967) me siguri janë pasur në konsideratë nga Profesori. Dëshmi e këtij interesimi dhe vlerësimi është dhe fakti që Çabej u është referuar materialeve të mësipërme, sepse i ka cituar në njërin nga vëllimet e serialit “Studime filologjike” të Prof. Çabejt, (botime të Prishtinës). E përforcon hamendjen time rreth njohjes paraparaprake të të dy të përmendurve dhe fakti që të dy rezultojnë “bashkautorë” në të njëjtin botim, përderisa në antologjinë për shkolla të mesme “Bota shqiptare”, Tiranë,1943, ka shkrime të njërit e të tjetrit.

Duke iu kthyer letrave, vërehet një veçori e përbashkët : në vend të hyrjes , 4-5 rreshtat e parë i shërbejnë autorit për të kërkuar ndjesë duke qenë se ai po merrte guximin të bënte vërejtje, qoftë në formë plotësimesh apo pasurimi shënimesh, mbi fjalët shqip që Profesori botonte numër pas numri në faqet e shtypit shkencor (“Buletini i Universitetit Shtetëror,seria e shkencave shoqorore” dhe revista “Studime filologjike”) duke ua bërë analizën etimologjike. Autori i letrave e bën të qartë se i vetmi motiv që e shtynte në këtë drejtim ishte: “...fakti i kërkimeve Tueja (të Profesorit-N.B.) mbi etimologjinë e fjalëve, që më ka ngjallë një interesim të veçantë tue u ndjekë njëkohësisht edhe nga dëshira e sinqertë që, kur të botohet, vepra e Juej, të dalë sa ma e plotësuese.” Që kjo ishte shprehje e çiltërt e konsideratës më të lartë për punën e Profesorit dhe një ndjenjë e thellë dashamirësie, pa as më të voglin paramendim ose pretendim, e gjejmë të përsëritur edhe herë të tjera. Edhe pse patën kaluar tre vjet korrespondencë, ai nuk ngurron që në letrën e dt. 25.3.1965 të ritheksojë: “Dëshiroj që fjalorin tuej etimologjik t’a plotësoni mirë

e ma mirë. Ai fjaluer ka me qenë një visar i paçmueshëm për gjuhën tonë...”H. Bushati ishte i vetëdijshëm se kishte hyrë një fushe që s’ ishte e vetja e ku nuk ndihej i sigurtë, prandaj i drejtohej me lutjen e përsëritur: “...të më falni për çdo gabim që mund të më rreshqasë.”

Siç dihet, Hamdi Bushati qe gjurmues edhe studiues në fushën e toponomastikës, të etnografisë, të historisë lokale e, në një masë më të vogël, i folklorit të qytetit. Të gjitha këto i dhanë një shans të mirë për t’u njohur jo vetëm me trashëgiminë kulturore, por edhe me pasurinë e fjalës së gjallë. Në anën tjetër zotërimi i mirë i osmanishtes e njohja e arabishtes, krahas njohjes dhe të italishtes etj. i ofronin një mbështetje të mirë, kur, ndër shpjegimet etimologjike, i drejtohej dhe metodës krahasuese.

Kuptohet që vërejtjet kishin të bënin me ato fjalë, nuancat e të cilave, si nga kuptimi, si nga shqiptimi ishin tipike për Shkodrën (qytet e fshatra përreth) duke evidentuar variantet e reja, të ndryshme nga ato të pasqyruara në lëndën e botuar. Për të qenë sa më bindës, Hamdi Bushati nuk ngurronte që, etimologjisë së një fjale në diskutim, t’i kushtonte deri më se 30 rreshta argumentim.

Nga letërkëmbimi merret vesh gjithashtu se i nderuari Profesor i mirëpriste këto shënime të herëpashershme dhe mikut shkodran ia çmonte ndihmën e pa interes; kjo dëshmohej si nga fakti që ky komunikim vazhdoi për katër vjet radhazi, si nga fakti tjetër që ky i fundit i kujtonte Profesorit takimet në Tiranë, ashtu si dhe porosinë që kishte marrë që të mos i ndahej këtij përkushtimi serioz e të dobishëm. Kështu, në letrën e nëntorit të 1963-së, lexojmë: “Fjala e Juej m’asht ba detyrë për me hulumtue rreth etimologjisë së fjalëve të gjuhës shqipe që botoni herëpashere”, ndërsa në letrën e shkurtit të 1965-ës: “Ky kontribut i emi e dij se asht i vorfën dhe fare i vogël, madje dhe me gabime, por tue dashtë t’i rrij besnik dishirit Tuej që për çdo botim Tuejin t’Ju evidentoj ato shprehje shkodrane që nuk bajnëpjesë në shënimet Tueja, edhe kësaj here iu vuna punës që t’ju shkruiej...”

Krahas shënimeve të mësipërme, në letërkëmbimin bëhet i pranishëm dhe një fakt me interes: preukopimi i Hamdi Bushatit për botimin e shkrimit të vet “Nga letërsia e vjetër shqipe me alfabet arab”si dhe angazhimi i Profesorit për një kohë të gjatë në këtë

drejtim. Nga informata e Profesorit e dt.19.2.1965 lexojmë: “Kam folur për punën e artikullit Tuaj për botim. Më janë përgjegjur që Ju duhet ta çoni artikullin në redaksinë e revistës “Studime filologjike”.

Ky artikull pësoi një odise të vërtetë, siç kuptohet nga këto dy letra të dërguara nga Shkodra: “Me këtë rast po Ju lajmëroj dhe një herë se atë artikullin e humbun (nënvizimi im-N.B.), siç e dini, e përsërita sikur me thatë edhe Ju (nënvizimi im-N.B.), kur ishim atje këtë herën e fundit. Me dt.6 të këtij muaji ia dërgova redaksisë “Studime filologjike” me bindjen se interesimi i Juej nuk ka me mungue tue ba të mundun që artikulli të shtypet...” (Letra e dt.6.2.1965)

“Që me sot u ba plot një vjet që ia kam pasë dërgue redaksisë... artikullin. Zoti Myqerrem Janina, disa ditë ma parë më shkruente se si personalisht ishit interesue Ju përsëri për artikullin tem. Ju falenderoj shumë dhe të më falni për mundimin që keni marrë...” (Letra e dt.6.2.1966)

Për fat të keq ky artikull nuk u botua asnjë herë dhe pse ishte nënshkruar me pseudonim. E keqja s'mbaron me kaq: në arkivin e familjes s'ka mbetur as origjinali as kopja e tij). Censura e indoktrinuar tejskajshëm në ato vitet e revolucionarizimit s'i mori në konsideratë as rekomandimet e Çabejt të madh. Merret me mend sa keq do ta ketë ndjerë veten Profesori. Për autorin e artikullit mbetej ngushëllimi që miku i shquar e kishte mbajtur premtimin: fundi ishte jashtë fuqive të Tij dhe kundra dëshirave. Interesimi i Tij i fundit ishte në sintoni të plotë me frymën e respektit dhe të dashamirësisë që kishte shoqëruar komunikimin reciprok midis dy intelektualëve miq. Ky leterkëmbim modest, pavarësisht përmbajtjes përcjell një mesazh kuptimplotë: dijetari i mirëfilltë, si rasti i Çabejt, nuk e njeh madhësitinë boshe, egocentrizmin e mizantropinë, ashtu sikurse dhe një studiues i përkushtuar kulturës së vendit të vet, si rasti i Hamdi Bushatit, nuk i kursen energjitë e veta, kudo e kurdo, për një qëllim fisnik.

Mendoj se për ta plotësuar dhe konkretizuar leterkëmbiminë mësipërm, nuk është e tepërt të riprodhohen, ashtu siç janë, vërretjtet e Hamdi Bushatit kushtuar disa fjalëve të caktuara, etimologjia e të

cilave ka qenë objekt studimi nga ana e professor Çabejt. Renditja e fjalëve do të respektojë renditjen sipas letrave dhe kronologjinë e tyre
Letra e dt.1.12.1962 (i referohet Bul. Un. Sht., nr.3, viti 1962)

-“gështallë”: Përveç kuptimeve të dhanuna nga Ju, në krahinën e Shkodrës përdoret në trajtën “kashtallë” dhe shënon: “dy copa dërrasash të holla që vlejné për të lidhë gjymtyrët e thyeme”

- “gogol”: Me shpjegimin që i dhanë, nuk njihet këtu. Gratë shkodrane e përdorin kur duan të trembin fëmijët e pabindun; një lloj përbindshi imagjinar që shfaqet në errësinë. Unë mendoj se rrjedh nga fjala arabe “gul” apo “gol”, me kuptimin e masipërm, por që në shqip asht transformue në “gogol”. Jam mbështetë në veprën e S. Frashërit “Kamusi Turqi”, fq. 971 dhe “Terxheme i Kamus”, arabisht – turqisht, vol. 3. f. 307, Stamboll, v. 1305 Hixhri.

Në Shkodër ishte një familje me llogabin “Gogoli” e që u shue. Përfaqësuesi i fundit qe Hafiz Gogoli, një i verbët i talentuem që edhe mund ta keni njohun.

-“grat”: Nuk e di se përse në spjegimet e ndryshme Tueja nuk asht dhanë dhe kuptimi metaforik me të cilin e përdorin shkodranët: “... nuk ka grat puna”, “...nuk i ban grat rruga”, “...pare e pa grat” etj.

-“grosh”: “Kamusi Turqi” i Sami Frashërit e spjeron si të rrjedhun nga fjala gjermane -” groschen” ose latinishtja “grossus”. Përdorej si njësi monetare në perandorinë osmane, me vlerën e 40 pareve baraz 1/100 e lirës turke. Jo vetëm në Shalë përdorej si formë shpërblimi, siç spjegohet, por në krejt malcinë. Groshi përdorej që në kohna të vjetra të pushtimit osman tue zavendësue akçen; ishte rrjedhojë e lidhjeve me qytetin. Këtë fjalë Ju e mbështetni te latinishtja “danarius grossus”. Ndërkaq, sipas S. Frashëri, fjala arabisht “dinar” – monedhë ari (¼ e lirës turke baraz një akçe), nga arabët ka kalue te latinët e vjetër në trajtën “danarius”.

-“gungë”: Paskajorja e foljes së prejardhur nga kjo fjalë, në Shkodër përdoret si në trajtën “me gungue” ashtu dhe në trajtën e deformatuar “me gumue”. Kjo e dyta, ma e përdorun, merr dhe kuptimin e deformimit të siprinës së një sendi jo të fortë. Shtrebnimi gjuhësor i mjaft fjalëve asht diçka që ndeshet herëmbashere në të folunin e përditshëm. Ja p. sh. në zhargonin popullor fjala “kungull” transformohet në “kumull”: “kumuj pitje”, “kumuj mishi”, “pite me kumuj”.

-“gjaj”: Shkodranët përdorin dhe trajtën “i gjasoj filanit” ose “i përgjasoj”, kurse trajta “gjasë” e shoqnueme me parafjalë ose me folje ndihmëse merr kuptimin e shprehjes “ka mundësi”, p. sh. “me gjasë ka ardhë filani prej...” ose “ka gjasë të ketë ardhë” etj.

-“gjedheshter”: Besoj se kjo fjalë nuk ka të bajë me emnin “gjedhë”, përderisa ka kuptimin: kamatë, interesë në të holla. Po këtë kuptim ka fjala “gjedheshter”, nga persishtja (shih “Kamusi Turqi” i Sami Frashërit, fq. 1153; “llavoli mypterabbati lugati Osmanije. Vol. II, fq. 158, Stamboll, v. 1298 Hixhri”). Nuk më duket bindës lidhja e gjetun me fjalën “gjellë” tue supozue se Gazulli nuk ka pasë njohuni të duhuna mbi gjuhët orientale. Mendoj se fjala “gjedheshter” ka hy në malci si rrjedhojë e marrëdhajeve me qytetarët: kur janë marrë uha të holla dhe ndër “senetet” turqisht, në vend të fjalës “fais” asht përdorë fjala “gjedheshter”, që në përdorim të përditshëm asht transformue në “gjedheshter”, ashtu si ndodh zakonisht me fjalët e hueja.

-“gjel”: Tue qenë se nuk asht shenue kuptimi metaforik i kësaj fjale, e shoh me vend të baj shtesën që vijon: u atribuohet personave që para të tjerëve, në grup, mbahen me të madh, mburren, prirje për t’u imponue etj. (krahaso me italishten: “far il gallo”). Kemi shprehjet: “filani duel gjel-kapull”, asht ngrehë si gjel,...si gjel në pleh,...si kaca-gjel” etj.

Letra e dt. 21.8.1963 (i referohet BUSH seria Shk. Shoq., nr.1, viti 1963)

-“hajger” m.: “harmëshor”, në Shkodër njihet vetëm trajta “hamshuer – hamshori”, ashtu siç e ka botue dhe Kordinjano.

-“hajthëm”: Ma tepër këtu përdoret trajta “i hajmë”, “e hajme” sikur sinonimi “e marueme” (krh.italisht: “magra”).

Asht me interes frazeologjia që citoni: “e prehu thikën, e bani halë” që në Shkodër thuhet ndryshe: “e prehi, e bani anëzë” ose “e kam preh si anza”. Në Shkodër, nga fjala “halë”, kemi shprehjen metaforike “e ka halë në sy” me kuptimin “nuk mund ta shohë me sy”.

Nuk di në se e keni në fjalorin Tuej fjalën “ham”, e cila ka lidhje me fjalën “hamshor”; kjo fjalë vjen nga persishtja, me kuptimin “i papjekun, i ndenjun, i papunë”. Janë të njohuna shprehjet: “kalë ham” (kalë i ndenjun), “jam bamë ham gjithë ditën” (kam mbetë ndenjun), “pamuk bam” (pambuk i papunuem).

- “hakel”: Nga kjo fjalë rrjedh shumësi “haklishte”, i ndjekun nga sinonimi “kerthingla”, kur janë fare të vogla.

-“hase”: - Në Shkodër quhej një lloj buke e shtrime si pite në formë të rumbullaktë, në ngjasim të “samun”-it, e të njajtit brumë, e palyeme sipër. Përdorej shumë në kohën e perandorisë osmane, veçanërisht nga moshat e reja, në kohën e zamrës, shoqnuem me djathë ose jo. Gjithashtu, simbas porosisë, përdroreshin edhe për festa, dasma, ceremoni etj. Sot, në kohët tona, nuk përdoren. Kam bindjen se fjala “hase” ka kuptim të veçantë dhe jo të bukës së bardhë: rrjedh nga turqishtja “hassa” e njëllojtë me “e veçantë”. Në turqisht, në disa shprehje, kemi mbiemnat: “hazine i hassa” (thesari mbretnor i veçantë), “hassa odasi” (dhoma e veçantë) etj.

Në Shqipëri përdoret edhe fjala “has”, sinonimi i fjalës “safi”: rrjedh nga fjala “halis”, e kundërta e imitimit. Kështu kemi: “has nagant” e kjo mund të përdoret edhe për “has ekmek” (bukë e papërzieme me miellna të tjerë). Rrjedhimisht “has ekmek” nuk ka të bëjë me fjalën “has”: duke mos u njohun etimologjia e fjalëve, në të folmen popullore asht marrë njena fjalë për tjetrën.

-“harlisë”: Nuk asht e njajtë me “azdisë”, këtu tek na; “harlisë përdoret përgjithsisht për bimët e zarzavatet kur marrin zhvillim, sidoemos mbas shiut ose mbas plehnimit. Fjala “azdisë” rrjedh nga fjala “azgin”: do të thotë “i frigshëm” (shih: S. Frashëri – Kamusi Turqi, vol. I, fq.32). Kështu, në Shkodër, thuhet “kal azgin”, ndërsa për burrat që janë për t’u pasë frigë, kemi shprehjen “burra azganë”; prej këndeje ka rrjedhë folja “m’u azganue”. Pra, në shprehjet e fundit, nuk ka vend për fjalën “harlisë”.

-“hurbë”: Përgjithësisht këtu përdoret në trajtën “hurfë”: “m’e pi hurfa – hurfa ... një lang”.

-“ijë”: Tue u bashkue me parafjalën “ndë” jep trajtën e aglutinueme “ndijë” ose “ndije” si

p.sh. “po kam një dhimbë ndije”. Dëgjohet dhe “në mëndije”; herë-herë edhe “po më dhemb në të hollë” (në bel, në mesin e trupit).

Letra e dt. 8.11.1963 (referohet BUSH, S. Sh. Sh., nr. 2, viti 1963)

- “jakë: Më ra në sy shumësi i urdhnores”ejani”, kurse në Shkodër përdoret “eni”.

-“jashmak”: Krahas spjegimeve Tueja, plotësisht të argumentueme, duhet t’ju informojë se në Shkodër kjo fjalë nuk asht njohun dhe as gratë e vjetra, me të cilat kam kontaktue, nuk e kanë përdorë. Deri në vitin 1910 gratë myslimane përdorshin “ferexhe” (binish, qereqe) dhe në vend të “jashmakut” përdorej “agëzlleku”: dy copa pëlhurë e bardhë, lidhun mbas kreje, tue lane sytë jashtë. Në vitin e cituem, u ba e detyrueshme veshja e çarçafit allaturka dhe e perçes. Gabimisht fjala “perçe” asht zavendësue fjalën “byrde”, e cila dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” nuk ka marrë spjegimin e mirëfilltë.

Po më jepet t’ju kujtoj fjalën “jereni” (shakaja, tallja) e përdorun shumë këtu. Ju ndoshta nuk e keni pasë të planifikueme.

-“jerevi”: Këtu përdoret zakonisht për një shtëpi përdhese e rrallë për stallë lopësh ose dhensh. Familjet e mëkambuna ndërtojnë “jerevi” të posaçme për fshatarët mysafirë.

-“Jezer”: Përveç spjegimeve të paraqitura, duhet pasë parasysh se “Jezeri” asht një ndër majat ma të larta të bjeshkëve të Shkodrës. Tue u mbështetë në shprehjet e malcorëve, Cordignano shënon fjalinë: “diellin e ka xanë Jezeri” sepse ishte aq e lartë maja e malit Jezer.

-“jezid”: Në vështrimin figurativ bektashjan e të ndonjë sektit tjetër ka domethanjen që i keni dhanë Ju; në të vërtetë fjala “jezid” vjen nga fjala arabe “zijade” (tepri). “Jezidi” asht dhe një sekt gjoja fetar i përhapun në Jemen dhe Mosull (Irak).

-“kalavesh”: Simbas meje nuk ka të bajë me fjalën “kara” as me turqishtën “kalan”. Them se duhet kërkue etimologjia e parashtesës “kala”, e cila zakonisht ka kuptim pexhorativ: kam pasë rast ta dëgjoj kur flitet për njerëz të plogtë, qyqmana, të vogjël si p.sh. kalamish, kaladredh etj. po kështu dhe për parashtesën “skala”; “skalapurri”, një lloj ndajfolje mënyre: “...foli skalapurri”, kur dikush flet pa u mendue, pa i matun fjalët.

-“kallm”: Në rrethin e Shkodrës kjo fjalë shënon një bimë që rritet në kënetë. Maja e kallamit përdoret për ushqim bagëtish, në vend të barit. Nuk ka të bajë me kallamin. Kur bima mbillet, quhet “kallam i butë”, ndërsa ai që mbin vetiu në kënetë, asht “kallam i egër”. Ky i fundit vlen vetëm për “masurë” (tuba të hollë për mbështjellje peni) dhe në ndërtim. Me fjalën “kallam” emërtohen dhe qafat e çorapëve. Nuk di se ç’mendim keni për fjalën arabe “kalem”, i cili, në të vërtetë, asht një kallam i hollë i vendeve tropikale dhe që asht përdorë në kohë të vjetra për të shkruar. Mendoj se mos asht etimologjikisht një variant i fjalës “kallam.

Letra e dt. 28.12.1964 (i referohet rev. “Studime filologjike”, nr. 1, Tiranë, viti 1964)

-“kerçu-m”: Më duket se nga këto fjalë rrjedh emni “kerçik” e me radhë: “kerçiku i kambës”, “kerçikëgjatë”; kur dikush shtrin kambët para një tjetri, i thohet “mblidhi pak kerçikët”; hera-herës, në mënyrë figurative, nënkupton aftësitë, mundësitë: “fëmija ka kerçikun e vogël”,...nuk ka kerçik ta kryejë atë detyrë”. Në këtë rast le ta kujtojmë fjalën “kreç”: lakna e bardhë, kur njeshet dhe merr trajtën e rrumbullakët në majë të kërcyellit të vet.

-“kercunë”: Figurativisht xavendëson mbiemnin e gjinisë femnore “e mjerë”. Ndërkaq emni “kercunari” këtu ndigjohet pothuaj fare; xavendësohet me “i mjeri”, “i shkreti”. Përdoret frazeologjia “mizë për kerçu” që tregon një grupim të madh njerëzish të mbledhur si thneglat në një kerçu.

-”cungu”: Nga kjo fjalë kemi “cungel-a”, cungje të shkurtë cilindrikë të përdorun për përforcimin e binarëve apo të gërshanzave të hatllave të një karabinaje. Në Shkodër asht dhe llagapi familjar Cungeli. Në shprehjen ”rrobaqepsi i ka lanë pantallonat cung”, fjala merr kuptim figurative. Kemi dhe fjalët derivate:”cumrrak”, “cubel”, “dorëcung” si dhe folje “me cungue” kur një peme i shkurtohen degët.

-“Kërshëndella”: Ky emën feste në Shkodër përdoret në trajtën e shkurtë: “Kshnella”.

-“kij”: Krahas përdorimit të përditshëm të kësaj foljeje për të shënue procesin e krasitjes së drujve frytorë, në Shkodër kjo gjen përdorim në lojën e femijëve me arra.

-“kodër”: Krahas nocionit të zakonshën gjeografik, merr dhe vështrime toponomastike. Në analogji me rastin e toponimit në Gjinokastër, spjegu e bindshëm nga ju, edhe në lagjen Kiras të Shkodrës ka një shesh paksa të ngritun, i cili mbante toponimin “kodër” dhe ku mblidheshin pleqtë e lagjes. Nga kjo rranjë janë krijuë toponimet “Kodër-Shingjergj, “Kadërkoll” (Kodërkoll) etj.

- kokërr”: Në kuptimin figurative shënon njeriun e veshun e të mbathun mirë, i kërputun e i pipiriquem. “Kokërrdac” thohet për një gjellë të pazieme mirë, të payndyrë, pa shije.

Shprehja “m`asht çue shtati kokërr” nënkupton çaste ethesh, frigësimi, shqetësimesh, ndërsa te “filani asht kokërr e mirë” bahet fjalë për njerëz me influencë. Prindi ose mësuesi autoritar karakterizohet “kokërrac me fëmijët”. Fjala “kakruk” përdoret për thelbin e arrës që del i plotë, për gështenjat e pjekura të qërueme bukur, për hinin e cingares që grumbullohet në maje të saj si dhe, metaforikisht, për fëmijët e vogjël që kapërdisen në ndonjë kolltuk në sytë e ma të mëdhejve. Kompozita “kokërr- kandari “u atribohet personave të shkurtë e të ntrashun.

-“kumbull”: Në Shkodër, kuptimi i saj varet nga gjinija: në gjininë femnore, “kumbull-a”, shënon frutin e njohun; në gjininë mashkullore merr dy kuptime: a) “kumbull-I” (në vend të kungullit, zarzavade), p.sh. kumbull i njomë, kumull-kapadollëm etj. B) “kumull uji” për poç uji, për trajtën e ngjashme me kungullin.

-“kumt”: Kam ndigjue prej plakave: “...e ka mbushë kumtin”, për ata që e mbushin kupën dhe bahen fajtorë.

-“kurtinë: Pjesë e toponimit “Qafë Kurtinë” pasqyruem në toponomastikën e fshatit Bushat (rev.Leka, nr. 9-10, viti 1933). Simbas traditës popullore ka qënë dikur një lagje.

Letra e dt 25.3.1965 (i referohet revistës “Studime filologjike”, nr.2, v.1964)

-“lagje”: Sipas spjegimit Tuej, asht shumësi i emnit “lag” dhe, si i tillë, i afërt me fjalët “pusi”, “pritë”etj., por në Shkodër e rrethe kjo trajtë, e shumësit apo e njëjësit, nuk përdoret; njëjësi përdoret vetëm në trajtën ‘lak”, ndërsa shumësi në “leqe”. Kjo fjalë që metaforikisht tregon pusi, pritë etj., në kuptimin konkret shënon konopin tue gjetë përdorim dhe në shprehjet “leqe e samarit”, “ leqe për të xanë rosa të

egra”, ”me xanë me leq” si dhe toponimi “Leqet e Hotit”.

Folja “me lague”, në kuptimin” me instalue”, në Shkodër nuk ndigjohet. Këtu folja “me la(r)gue” me kuptimin e çvendosjes; “lagonju nga rruga”, “lagou këtej”

-“gerbulë”: Përveç kuptimit që ka si smundje, nga kjo fjalë shkodranët kanë nxjerrë foljen rifleksive “me u gerbulë”, shoqne me foljet tjera: “me qa” ose “me vajtue”. Kështu kemi shprehjet: “asht gerbulë tu e qa...”, “u gerbul së vajtuemi..

Letra e dt 6.8.1965 (i referohet revistës “Studime filologjike”, nr.1, v.1965)

-“pajandër: Përveç spjegimeve nga ana Juej, në Shkodër fjala merr një kuptim të figurshëm “me u mbajtë me pajandra” d.m.th. me ushqye shpresa të kota si dhe “me u mbështetë në pajandra”- me u besue zgjidhjeve imagjinare.

Sinonime me te dhe që konfondonen bashkë, asht kompozita “pajë-andrra” që mendoj se rrjedh nga bashkimi i foljes “me pa” dhe emnin “andrra” që do të thotë “ të prirësh ndaj fantazisë, andërrimeve”. Pra ndonëse me etimologji të ndryshme, me të njajtin kuptim metaforik.

-“palare”: Këtë fjalë kam pasë rast ta ndigjoj të përdorun dhe në Shkodër nga gra të moshueme. Konkretisht, në praninë teme, një vjehërr i tha nuses së djalit: “Si më solle këtë palare” (pjatë të shtrime, të hapët)?”

-“pallë”: E dëgjojmë shpesh këtu tue përdorë me kuptim figurative në shprehjet: “ban pallë me mend “(mendon t'i kryejë punët simbas dëshirës së vet); “bëj pallë e mos çaj kryet! (kryej punën tande...!); “nuk ia ha palla” (nuk ia merr mendja- nuk merr vesht).

Vijon në numrin e ardhshëm

Ekspertizë mbi disa krijime letrare të Pjetër Arbnorit

Në diktaturën komuniste shteti kontrollonte gjithçka, që nga jeta intime, personale deri tek letërsia, arti, kultura. Janë të shumta rastet kur shkrimtarë, artistë të fushave të ndryshme janë dënue për shkak të krijimeve të tyre artistike, ose ato kanë qenë ndër shkaqet e randimit të akuzës së tyre. Rezultati i persekutimit të shkrimtarëve solli dukurinë e letërsisë së ndalueme, e cila nuk lejohej të botohej, konfiskohej nga organet e sigurimit, deri edhe përdorej në gjyqe si dëshmi e aktivitetit reaksionar të autorit. Fatkeqësisht një pjesë e mirë e kësaj letërsie ose humbi nëpër burgje ose ende sot asht në dorshkrime e panjohun.

Në këtë numër të revistës “Gegënia” po sjellim një pjesë nga Procesverbalet e hetimit dhe Ekspertizës së bame mbi disa krijime letrare të shkrueme gjatë viteve të burgut prej shkrimtarit Pjetër Arbnori (1935-2006). Ekspertiza e detajume mbi dorëshkrimet e këtij autori asht e firmosun nga hetuesi S. A. dhe firmosun prej shkrimtarit A. C., me shkrim dore ku thuhet se është dakord me të. Në këtë rasë por edhe në të tjera duket qartë bashkëpunimi i organeve të sigurimit të shtetit me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve. Autori P. Arbnori kritikohet dhe denoncohet ashpërsisht sepse ka shkruar një letërsi që bjen ndesh me realizmin socialist, dhe me moralin e shëndoshë komunist sepse në krijimet e tij letrare ka pasqyruar imoralitete, botën reaksionare borgjezo-revizioniste, fetare etj., të cilat përbajnë “propagandë kundër ideve tona socialiste”.

Mbi bazën e këtyre hetimeve dhe ekspertizës jo vetëm që iu konfiskuen dorëshkrimet por mbi autorin u shtuen edhe disa vite burg ma tepër. Dokumentet flasin vetë e nxjerrin në pah absurditetin e këtyre ndëshkimeve dhe të sistemit që i prodhonte ato. Ftojme të gjithë ata që zotnojnë ose kanë mundësi të nxjerrin prej arkivave dëshmi të tilla, t’i sjellin për botim në numrat e ardhshëm, në mënyrë që të përkujtojmë e të ndriçojmë sadopak kalvarin e vuejtjeve që kaluen një pjesë e shkrimtarëve dhe artistave shqiptarë nën diktaturë.

Redaksia

EKSPERTIZË

Mbi disa krijime letrare të Pjetër Arbnorit

Materialet letrare përbëhen nga disa novela e tregime, një roman për fëmijë (pjesa e parë) dhe disa përkthime nga letërsia e huaj.

Krijimet letrare origjinale të autorit janë influencë e shëmtuar e letërsisë së verdhë, romantike e sentimentale, krejt të kundërt me letërsinë tonë të realizmit socialist. Në shumicën e tyre, ato janë impresione të veçanta jete të autorit, të cilat i përshkon pesimizmi, mbyllja në guackën e vetvetes dhe largimi nga problemet e mëdha të jetës. Në pjesë të ndryshme të shkrimeve letrare mbahet një qëndrim reaksionar tepër i qartë, pavarësisht se autori herë-herë është përpjekur ta mbulojë këtë, por prapëseprapë idetë e tij dekadente e çoroditëse janë shumë të hapta e të shkruara me dorën e autorit me bindjen që ai ka për to. Idetë e tij dekadente dalin në dritë edhe për probleme të tjera shoqërore, për problemet e gruas, të fesë etj.

Analizën e krijimtarisë letrare të autorit do ta bëjmë duke u ndalur në disa probleme që spikatin në shkrimet e tij, duke i dokumentuar ato me mendimet që shpreh vetë autori, pa u ndalur veçmas në çdo tregim ose novelë. Në ndonjë rast edhe mund të ndalemi në një krijim të veçantë. Këtë e bëjmë kryesisht për të vërtetuar se një ide reaksionare e autorit nuk është shkruar rastësisht në një tregim apo një novelë, por ajo përshkon tërë krijimtarinë e tij letrare.

1.) Në shkrimet e tij autori largohet nga problemet e mëdha të kohës, të jetës dhe të fut në një botë intime, të vockël, me ballo, dashuriçka ose qejfe, me brenga të tij të brendshme. Kjo që bën shkrimet e autori të jenë tipike për letërsinë e sotme borgjeze e revizioniste dhe për ato ndikime të huaja që i kritikoi me forcë Plenumi i 4-t i Komitetit Qendror.

Nëqoftëse autori ka mendime të veta për këtë problem dhe i mban të mbyllura në vetvete, kjo është një çështje e tij. Ne t'i thojmë atij se kjo nuk është një gjë e mirë dhe kaq. Por, nëqoftëse këto idë ai i përhap me gojë tek të tjerët, atëherë ne kemi të drejtë t'i themi se kjo është propagandë kundër ideve tona socialiste. Nëqoftëse këto

idé ai i shpreh me shkrim, si në rastin që po analizojmë, atëherë kjo mbetet një propagandë e dokumentuar. Të shkruash për t'i mbajtur vetë shkrimet, kjo nuk ka kuptim dhe nuk ngjet. Këto që shkruhen në Shqipëri presupozohet që t'i drejtohen lexuesit shqiptar. Këtu merr fund e drejta e autorit dhe fillon e drejta jonë për të thënë se këto shkrime janë bërë me qëllim të keq, për të çoroditur njerëzit tanë, për t'i mësuar ata që të largohen nga problemet e mëdha të kohës, të jetës, të vendit, për t'i nxitur ata që të bien në pesimizëm, që të shohin vetëm dashuriçkat, imoralitetet, pijet dhe vese të tjera të cilat, me sa duket, autori i ka patur ose i ka fort në zemër.

Mjaft nga shkrimet e autorit përshkruajnë ngjarje të periudhës para pushtimit italian të Shqipërisë ose gjatë okupacionit. Kjo bie në sy sidomos në romanin “Shtëpia e mbetur përgjysmë”. Autori nuk merret me hallet e mëdha të Shqipërisë së pushtuar nga fashistët. Ai nuk i sheh hallet e popullit të shkaktuara nga ky pushtim. Në romanin e mësipërm (fq. 54-55) jepen mendime të shprehura nga mësues të ndryshëm, si p.sh. “Hitleri është më i forti i botës”, “është i fortë Hitleri, por më i fortë është inglizi”, “Çurçilli është politikani më i madh i botës”, “Stalini është gjeniu i botës”...Pasi përmend këto, autori vë në gojën e heroit të veprës së vet fjalë:

“Eja e merr vesh tani! Cilit t'i besosh? Cili është më i miri e i ligu?”

Për mua ata le të luftonin sa të ngopeshin në e kishin me qejf atë lodër, veç ne mos na mungonte buka, veç nëna mos të lodhej deri në mesnatë, veç të arrinim t'ia vinim çatinë shtëpisë së re. Për këtë i lutesha çdo natë Zotit...”

Dorëshkrimi mban vitin 1969. Si mund të shkruhet në kohën tonë kështu? Pavarësisht se fjalët e mësipërme janë vënë në gojën e një fëmije (që, në fakt, në vepër del i zgjuar dhe vlerëson shumë mirë mjaft gjëra nga ngjarjet dhe jeta që e rrethon), këto ne i vlerësojmë si mendime të autorit. Edhe sikur ta marrim si fëmijë, i cili i asaj moshe gjatë Luftës Nacional çlirimtare nuk dinte të dallonte se kush ishte i miri dhe kush ishte i ligu? Si mund t'i serviret lexuesit tonë të sotëm një arsyetim i tillë se gjoja njerëzit tanë, duke përfshirë edhe fëmijët e të rinj, në atë periudhë, qëndronin aq të shkëputur nga ngjarjet sa të

thonin.. “për mua ata le të luftonin sa të ngopeshin” dhe të shikonin aq ngushtë hallet e tyre e për këtë t’i luteshin Zotit ?

Në fragmentin e romanit që fillon në fq. 99 kapet një ngjarje në momentin kur kapitulloi Italia. Sa gjëra interesante do të priste një lexues mbi kujtimet e asaj dite. Por autori taman atë ditë gjen të përshkruajë me hollësi erotike aventurën e një vajze të pandershme me dashnorin e saj. Korrupsioni dhe imoraliteti, siç duket, e kanë tërhequr më fort autorin, se sa një ngjarje e tillë që në Shqipëri nuk kishte të madh e të vogël të mos i interesonte, mbasi për këtë kapitullim të Italisë ne kishim derdhur shumë gjak e kishim bërë shumë luftë.

Në tregimin “Kumbullat që çelin vonë” flitet për një gjeolog që është marrë si hero i shkrimit. Flitet për kohën tonë dhe do të ishte interesante që, përmes tij, të flitet me respekt për njerëzit e rinj që çajnë malet për të zbuluar pasuritë e nëntokës. Por jo. Autori të largon nga kjo botë e njerëzve dhe na e fut gjeologun në një histori dashurie, bile në një hall se cilën të marrë midis dy femrash.

2.) Në shkrimet e përfshira në fletoret e P. Arbnorit zenë një vend të gjërë ngjarjet që lidhen me kishën, me fenë, me shenjtorët. Në leximin e parë të lihet përshtypja sikur autori vende-vende mban qëndrim jo fetar, ndërsa vende-vende mban një qëndrim fetar të bindur. Por secili njeri nuk mund të mbajë një qëndrim mëdysh ndaj një fenomeni të tillë, siç është feja. Edhe autori nuk mund t’i shpëtojë kësaj. Mendimi që nxirret nga një lexim i vëmendshëm i shkrimeve është se autori është fetar. Një njeriut tonë ne do t’i bënim një kritikë shoqërore dhe ta bindnim për kotësinë e bindjeve fetare. Por këtu kemi të bëjmë me një rast tjetër. Ç’vërehet në shkrimet e lexuara?

P. Arbnori u le shumë vend në shkrimet e veta (sidomos në romanin për fëmijë) ideve fetare. Fakti se ai jep kujtimet e një fëmije nuk e ndryshon aspak qëllimin që ai ka. Nga mënyra se si i jep idetë fetare ne themi se ai bën propagandë në favor të këtyre ideve.

Duke nisur nga fq.60 e romanit “Shtëpia e mbetur përgjysmë” flitet se si heroi i veprës, Toli, hyri në shoqatën kulturore-sportive të klerit në Shkodër, që dihet se është ajo e jezuitëve. Nga mënyra e bukur, me të cilën autori e përshkruan ambientin kishtar të shoqatës,

fëmija arrin në përfundimin se: “do të thoja se isha në një shkollë moderne nga ato që thonë se janë përjashta”

Në fq.60 flitet kështu për meshën e madhe: “zëri i armoniunit përhapet nëpër kubetë e arkatat e larta, jehon nga të gjithadrejtimet dhe vjen e të mbështjell me një vel të butë ngjyra–ngjyra që valëvitet deri satë fut në ëndërrime; tymi i kaltëremë i temit që digjet të sjell aromën dehëse; kori I djemve të rinj të mbush me gëzim; pastaj jehon zëri i trashë i basit që shungullon gjith hapësirat, aq sa të duket si zëri i Zotit ka pikturuar Maria Kallambi në tavanine kubesë dhe që, mjekërbardhë prapa reve të bardha i dorëzon Moizehut dy pllakat e arta me dhjetë urdhnimet e tij; e në fund, kur fillon kori i vajzave të fshehura në galeri prapa grileve, mua më duket se janë zëra njerëzish, por të gjitha ato ëngjëllushkat me fkitra të vizatuara rreth Shënmërisë, që ia kanë marrë një kënge ndër lëndinat e parajsës”.

Një mënyrë e tillë të shkruari ia ngacmon një fetari të moshuar ose ish-fetari nostalgjinë për kishën, për Zotin, për ato ambiente dhe ato ceremoni fetare që kishte dikur kleri. Një të riu, që nuk e ka jetuar atë periudhë, ia paraqet ceremonitë fetare me ngjyra të ëmbla, të bukura, dehëse, ëndërruese. Si mund të shkruhet kështu, kur ne e dijmë se ç’ideologji helmuese ishte feja, kur e dijmë se tamam nga ato kisha, ato shoqëri gjoja kulture-sportive janë përgatitur e përpunuar sa e sa agentë të Vatikanit, me të cilët ka patur të bëjë drejtësia jonë revolucionare?

Në fq.62, në gojën e heroit të romanit, autori shprehet haptazi: “Një gjë tjetër që më pëlqente mua ishte dhe mësimi i historisë së shejtë”. Përse i serviret kjo lexuesit të sotëm shqiptar? Ai nuk e njeh historinë e shenjtë. A nuk është kjo një mënyrë nxitjeje nga ana e autorit që t’i ngjallë lexuesit kërkshërinë dhe dëshirën për ta njohur këtë histori?

Nga faqja 63 e tutje përshkruhet me hollësi përgatitja e një shfaqjeje teatri nën drejtimin e jezuitëve. Autori jep përmbajtjen, jep hollësi të saj dhe më në fund thotë: “Shfaqja doli e mahnitshme” (fq. 68). A nuk kemi të bëjmë këtu me një tendencë të qartë të autorit për ta bërë lexuesin që të ketë simpati, respekt e dashuri për punët fetare, pra dhe për ideologjinë fetare? Të lihet përshtypja sikur priftërinjtë

ishin vetë si shenjtorë, sikur mendonin për gjëra të bukura, për art, për muzikë, për valle, për sport, sikur i hante merakun si e si t'i edukonin fëmijët me ndjenja të bukura, të pastra, ndërsa ne e dijmë se prapa veladonit të jezuitëve se ç'kriminelë fshiheshin, se ç'banditë kishte këtu Vatikani, që fshiheshin nën petkun fetar.

Nga fq.75 e tutje në roman flitet përsëri me shumë hollësi për ceremonitë fetare dhe flitet me shumë respekt dhe me shumë diallëzi përhapet nga autori ideologjia fetare. Gjer edhe në vargjet që najep autori:

“Amanet shejti Shna Rrok

Lutju ti të madhit zot”

Me priftërinj, me murgesha, me xhakoj ose fëmijë të tjerë që ishin tërhequr për t'u molepsur me ideologjinë fetare, na i jep autori me një kujdes të madh dhe me një merak të madh që t'ua bëjë lexuesve tërheqëse ato ceremonitë fetare e, nëpërmjet tyre, vetë fenë dhe ideologjinë fetare. Të shkruash në këtë mënyrë dhe për qëllime të tilla kjo, është një praktikë e zakonshme vetëm për letërsinë borgjeze, së cilës, në këtë çështje, i është shtuar tani edhe letërsia revizioniste. Ne e hedhim poshtë këtë: lloj letërsie reaksionare dhe, si qytetarë, kemi të drejtë të kërkojmë që autorit t'i ndalet dora.

3.) Në shkrimet e autorit ka shumë imoralitet, aty përhapen shumë ndjenjat erotike, seksuale, degjeneruese, mendikime tepër negative për lexuesin tonë shqiptar.

Sikurse në roman, edhe në tregimet e novelat, ka të ngjarë që autori t'i konsiderojë si shkrime autobiografike. Jeta e tij mund të ketë qenë e tillë (unë nuk e njoh fare). Ndoshta ai edhe në punën e dashurisë e të martesës mund të ketë patur probleme, hidhërimi e diziluzione. Kjo është puna e tij. Por, të sjellësh në letërsi një frymë të tillë erotike, diziluzioni, seksualiteti – kjo gjë kthehet në një pozicion ideoestetik të caktuar që është diametralisht i kundërt me letërsinë e realizmit socialist.

Ne nuk jemi kundër dashurisë, përkundrazi ne i inkurajojmë marrëdhëniet e drejta midis të rinjve, ne e mbrojmë dashurinë e vërtetë e të pastër, qoftë nga konservatorët dritëshkurtër, qoftë nga aventurierët vagabondë që nisen nga qëllime imoraliteti.

Autori i shkrimeve që po analizojmë ka një këndvështrim krejt të ndryshëm për dashurinë, për marrëdhëniet midis njerëzve, sidomos ka koncepte, krejt të hueja për ne, kundrejt femrës.

Tregimi “Bisedë mbas buke” është artificial, krejt pa vlerë. Ai të kujton moton “dyshò në gratë”. Ai është më tepër një produkt i mendjes së autorit, se sa një fakt jetësor që mund të ndodhë në shoqërinë tonë të sotme socialiste. Epizodi i këmbëve nën tavolinë shërben për të hedhur idenë e për të bërë përgjithësime të diziluzionit ndaj femrave tona, në përgjithësi. Pavarësisht nga mbyllja që ka bërë autori, tregimin e përshkon tej e fund idea e pështirosjes ndaj femrës. Lexuesit i krijohet një boshllëk shpirtëror, banal. Këtë ka dashur të bëjë autori. Një lexues i pjekur nuk e pranon këtë kursesi si letërsi të mirëfilltë.

“Mbi romantikën në dashuri” është një tregim, ku autori e fetishizon, e shenjtëron dashurinë dhe kjo nuk është një dashuri e thjeshtë dhe e pastër, por tepër e përciptë, me një romantikë të sëmure gjë që është ndikim i letërsisë së verdhë borgjeze, pavarësisht nga motivet gjoja shqiptare që autori ka dashur të përziejë në të. Duke dashur gjoja ta mbrojë dashurinë kundër konservatorizmit, ai në fakt afirmon konceptet e tij liberale për dashurinë.

Në tregimin “Kumbullat që çelin vonë”, autori ve në epiqendër marrëdhëniet e martesës. gjeologun Petrit autori na e paraqet si një njeri me halle për martesë. Befas atë e ve në marrëdhënie me një gjimnaziste, por diziluzioni nga këto marrëdhënie e bën të kthehet tek një e njohur e parë, Julia, me të cilën martohet. Edhe në dashuri, edhe kur martohet me Julinë, heroi i tregimit, një gjeolog, paraqitet si një njeri i ngrysur, sikur jeton në dimër e përfundon po në dimër me kompromisin që zgjodhi për martesë. Ai e ka shumë të lehtë të kalojë nga një dashuri në një tjetër dhe ky është një koncept liberal mbi dashurinë që P.Arbnori e manifeston edhe në shkrime të tjera.

Në tregimin pa titull (fletorja nr.5) idea qendrore është lidhja e dy të rinjve mbi bazën e njohjes së rastësishme. Autori ia vështirëson lexuesit për të kuptuar në se tregimi prek ngjarje të paraçlirimit, apo të pasçlirimit. Por, nga disa hollësi, më tepër ai vendoset pas çlirimit. Në këtë prizëm dhe e analizojmë. Tregimi është mbushur ndjenja

sensualiste (e shoqja e “kushëririt” e fut C-në në banjë dhe është gati t’i shkojë vetë aty, gruaja e korrierit, me gjoks të fryrë, e fton në shtratin e saj, meqenëse i shoqi s’ ishte aty, vajzës që ky dashuron i futet vetë në shtrat dhe kjo është mësuesja e fshatit, që banon vetëm në shkollë etj.) Tamam letërsi dekadente për degjenerimin e lexuesve, sidomos të rinisë.

4.) Në shkrimet e autorit trajtohen shumë aspekte të jetës së degjeneruar. Në roman ka shumë ahengje, pije, qelepirlëqe. Shpesh ka skena ku njerëz të thjeshtë, të varfër, të mirë paraqiten në mënyrë të tillë që të mos kesh simpati për ta. Në kohën e pushtimit italian flitet për fëmijë që zenë rradhën për të marrë ushqime nga kazani i ushtarëve italianë. Nuk ka qenë fenomen që shqiptari t’u nderte dorën pushtuesve, as nuk ka qenë fenomen që pushtuesit të merakoseshin aq shumë për t’u bërë bamirës! Në një moment tjetër, në roman, paraqiten qytetarë në Shkodër në kohën e kapitullimit të Italisë, që grabisin dërrasa, kapakë dritaresh, shtylla dhe ç’tu vijë për dore. Paraqitet një skenë që i poshtëron dhe i ulë shumë ata që marrin pjesë në një grabitje të tillë: edhe sikur në një vend të ketë ndodhur ndonjë gjë e tillë, a është ky fakt përgjithësues për njerëzit tanë dhe për popullin tonë?

Kur përshkruhet një demonstrate antifashiste (fq. 71) flitet për një vajzë, të cilën e kishin përjashtuar përgjithmonë nga Instituti femëror (tani në demonstratë ajo mbante flamurin) dhe që familja e kishte bërë hasha. Nuk dihet në ka ndodhur, por edhe sikur të ketë ndodhur një rast i vetëm, a ia vlen të thuhet që vajzat e tilla antifashiste kishin familje të tilla që t’i bënë hasha? Sido që të ketë qenë, vajza të tilla trimëresha antifashiste nuk vinin nga familje që të ishin aq reaksionare e aq fashiste sa t’i bënë hasha.

Në roman paraqiten në lagje grupe djemsh që kishin braktisur shkollën dhe bënë shumë zullume. Autori shkruan se ata shihnin filma.

Pavarësisht se kjo i takon periudhës së paraçlirimit, a duhen dhënë lexuesve të vegjël (sepse romani është për fëmijë) shëmbuj nxitës të tillë nga filmat kauboj ose të tjerë të degjeneruar?

Në fq. 55 thuhet se fëmijës së romanit, Palit, i kishin rënë në

çmim tre libra. “Historia e Skënderbeut” e Fan S.Nolit, “Anzat e Parnasit” dhe “Kasollja” e Ibanezit, secili më i bukur se tjetri.

Për librin e dytë nuk përmendet autori, por dihet që është padër Gjergj Fishta. Ai, sipas gjykimit tonë, është shkrimtar reaksionar katolik. Kujt ia shet P.Arbnori vlerësimin “Secili më i bukur se tjetri”? A ka nevojëpubliku ynë për një gjë të tillë. Përkundrazi. Vërtet ngjarjet zhvillohen paraçlirimit, por dorëshkrimimban vitin 1969, dhe unë kam të drejtë të theksoj se lexuesve shqiptarë të sotëm u rekomandohet një shkrimtar reaksionar (Gj. Fishta). Autori e ka bërë këtë me një qëllim të caktuar.

Në fq.57 të romanit, vihet në gojën e një personazhi:

“Mana” që u hidhte perëndia izraelitëve në shkretëtirë nuk ishte caktuar për disa, po për të gjithë”.(Ky shembull është i marrë nga Testamenti i Vjetër- një kod i njohur i kristianizmit).Tani del pyetja: Ç’i duhet lexuesit tone Testamenti i Vjetër? A nuk është një propagandë brutale fetare për t’u dhënë të kuptojnë lexuesve se perëndia mendokërke për të gjithë e jo vetëm për disa?

Në mbyllje të romanit flitet për një bandit, Ndue Ndueithi. Jepen me hollësi aventurat e tij me forcat qeveritare në kohën e pushtimit nazist, me Markagjonin, me delegatin apostolic të Vatikanit. Krisi pushka e bëhet baterdia. Ç’i duhet një fakt i tillë lexuesit tonë. Nuk gjeti autori P. Arbnori një rast heroizmi të guerilasve ose të patriotëve të tjerë (si ai i tre heronjve të Shkodrës) për të përshtuar, po merret me banditë. Bile këtë bandit autori na e paraqet në një skenë (fq. 151) kur njerëzit ishin grumbulluar në një dyqan për të blerë kripë. Por kripë nuk u shitej sepse duhej të furnizohej më parë ushtria. Atëherë banditi jep urdhër që të hapet dyqani dhe qytetarët nevojtarë marrin kripë dhe largohen. Dihet se veprime të tilla kanë bërë partizanët në zonat e lira, por t’i atribuosh një gjest të tillë një banditi, që ta paraqesësh në sytë e popullit si " njeri të mirë " - këtë mund ta bësh vetëm me logjikën e një...

Novela “Zhgënjimi” na jep një personazh kryesor, që është huazim nga letërsia romantike dekadente, njeri me kontradikta të brendshme të pa besuesuara, të mbyllur në guackën e vet individuale, pa forcë, pa perspektivë. Të kapësh personazhe të tillë kryesorë –

edhe kjo është një çështje ideore. Kurrën e kurrës letërsia jonë e realizimit socialist nuk do të merrej me personazhe të tillë, veçse për t'i vënë në shenjestër, por edhe në këtë rast jo në atë rol që i ka dhënë autori. Dashuria, në këtë novelë, është parë si një forcë e mbinatyrshme, për më tepër, vetë fundi i saj gjithnjë i errët, e bën atë edhe më ireale. Në thelb aty trajtohet fundi i hidhur i një dashurie. Kjo nxit lexuesin për pesimizëm dhe i lë atij një boshllëk në perspektivë, një keqardhje për fatkeqësinë e saj (të dashurisë). Kur flasim se letërsia dekadente borgjezo-revizioniste nxit pesimizmin, fatalitetin në jetë, intimen mesquine dhe individuale në marrëdhënie midis njerëzve, ne kemi parasysh taman vepra të tilla që kanë ide si ato të novelës “Zhgënjimi”, ku Dani një personazh vagabond i thotë heroit të novelës, Martinit për kumatën e vet, Mirelën:

Ti e ke hall se e kam kumatë? Eh, budalla. Për mua kur të duash je ilirë....

Ta nxitësh një person të njohur rastësisht (Martinin) për marrëdhënie imorale me kumatën e vet –kjo vetëm në librat e verdhëborgjezë revizionistë mund të ndodhë.

“Ardiani” është titulli i një tregimi që ka në qendër një personazh aventurier, immoral vagabond. Ky nuk ka as punë as ideal tjetër në jetë veçse ti ngacmojë vajzat e gratë, tu bjerë në qafë, ti joshë për qëllime imorale. Është një personazh për të cilin të vjen ndot. Nëqoftëse P. Arbnorit i vjen pas oreksit një personazh i tillë, përse ai e ofendon kaq shumë lexuesin tonë duke i ofruar atij paçavure të tilla, shkrime të tilla që të nxisin për veprime të poshtra imorale, antiedukative?

Në roman, nga faqja 141 e tutje, flitet për një person, Uka iColit, që vjen në familjen e Palit. Ai është një njeri shumë i varfër, shumë i uritur dhe del se punon si hamall në Portin e Durrësit, dhe që na paraqitet nga autori si njeri që vjen kur ishte shtruar një gosti feste dhe Uka ban e gllabëron çdo gjë që shtrohet në tryezë dhe, si të thuash, i len fëmijët pangrënë. Ashtu siç është paraqitur lexuesit i disgustohet një njeri i tillë. Përse duhet vënë në një gjëndje poshtëruese një njeri i tillë. Përse duhet vënë në një gjëndje poshtëruese një njeri, që është hamall ose malësor i varfër?

Kjo ide të çon edhe në një idé tjetër. Në përgjithsësi, sidomos në roman, autori na jep një familje të varfër. Ai tregon raste të qëndrimit prej kopraci, matrapazi, dallaverexhiu të njerëzve të shtresave të pasura. Mjaft të varfër paraqiten me hallet dhe vuajtjet e tyre. Mund të themi se këto janë gjëra pozitive në vepër. Por kjo “pozitive”ka diçka tjetër. Sa më sipër, flitet për të varfër apo të pasur në kohën e Zogut e të pushtimit. Por njerëzit e varfër në veprën e P. Arbnorit, paraqiten si njerëz që vetëm jetojnë vuajtjet dhe vështirësitë e jetës, që venë re zullumet që bëjnë tregtarët apo të pasurit e tjerë. Këto njerëz shpesh më tepër kërkojnë “mëshirë kristiane” (ata i luten Zotit, ata i nënshtrohen fatit, ata nuk mendojnë asnjëherë se ç’duhet të bëjnë). Është një periudhë ajo kur në Shkodër (ku zhvillohen ngjarjet e romanit) si dhe në vende të tjera, vepronin grupet komuniste, pastaj vepron P.K.SH.

Ka shtresa të tjera të popullsisë (sidomos punëtorë, zejtarë, studentë etj.) që lëvizin, që nisin të fitojnë ndërgjegjen klasore e ndërgjegjen ndërkombëtare, që hidhen në veprim dhe nuk i nënshtrohen atij, dhe as mbështesin shpëtimin tek Zoti. Të lexosh P.Arbnorin të duket se jeton në një vend ku nuk ka forca të tilla dhe ide të tilla. Atij nuk i interesojnë ata forca të cilat nuk qëndrojnë thjesht në gjëndje pasiviteti, përmes së cilit nuk tronditet pushteti i të pasurve apo edhe pushteti i okupatorit. Ato hidhen në veprim (greva e protesta para pushtimit) dhe pastaj në revolta, protestë, kryengritje të armatosur në kohën e pushtimit nazifashist.

Të përshkruash njerëz (qoftë edhe të varfër) që nuk shohin gjë tjetër veçse të ndërtojnë një shtëpi, të shesin kumbullat ose fiqtë e oborrit, të shkojnë nëpër ahengje, të marrin pjesë në procesione fetare, të shohin filma kauboj me aventura, në një kohë kur njerëz të tjerë të shoqërisë bëjnë greva, hidhen në luftë të armatosur, u derdhin armiqëve hekur në tru dhe i asgjësojnë më nagantin e guerrillasve. E gjithë kjo që bën P.Arbnori është një diversion ideologjik e politik përmes krijimeve letrare.

Çdo qytetar i ndershëm dhe patriot, çdo lexues shqiptar do të ironizonte rëndë P. Arbnorin për përpjekjet e poshtra që bën që të përhapë helmin e e ideologjisë reaksionare përmes shkrimeve të

tij. Çdo lexues i yni do t'i flakte poshtë këto romane, tregime apo novela të autorit si gjëra të ndyra që, jo vetëm nuk meritojnë të drejtën e qytetarisë në rendin tonë shoqëror, por që të zemërojnë e të nervozojnë, (të indinjojnë e të revoltojnë për guximin që merr një njeri i degjeneruar duke gjykuar vetëm nga ata që ka shkruar) të ofrojnë paçavure të tilla duke menduar se do të ketë syleshë për t'i përtypur ato.

P. Arbnori, nga sa mund të gjykohet përmes shkrimeve të tija, vuan nga mungesa e zgjuarsisë dhe dinakërisë. Ai duhet ta ketë gjykimin në vend të paktën në atë shkallë sa të kuptojë se një letërsi e tillë dekante nuk shkon dot në rendin tonë shoqëror. Bëhet pyetja: mos i ka vajtur atij mendja për ta botuar jashtë Shqipërisë, këtë e di ai

Mos e ka destinuar këtë letërsi ta përhapë fshehurazi mes njerëzve, armiq të klasës, që notojnë në po këto ujra si ai, këtë e di ai.

Me Kushtetutë e me ligjë ndalohet propaganda reaksionare dhe përhapja ose krijimi me qëllim përhapje të letërsisë reaksionare. Lexuesi do të kërkonte që, në rastin konkret të shkrimeve të P.Arbnorit të zbatohet Kushtetuta dhe ligji te veprojë.

Durrës, 30. IV. 1979.

S. F.
(firma)

Mbasi jam njohur me këto materiale, jam dakort me mendimet e shprehura në këtë ekspertizë.

A.C.
(firma)

Pjetër Arbnori (1935-2006)

Krijimtaria letrare:

- *Kur dynden vikingët*”, novelë, Shtëpia Botuese “Bilal Xhaferri”, 1992.
- *“Mugujt e mesjetës”*, roman, 1993.
- *“Bukuroshja me hijen”*, novelë, Shtëpia Botuese “Bilal

Xhaferri”, 1994.

- “*E bardha dhe e zeza*”, roman, 1995.
- “*E panjohura*”, *Vdekja e “Gebelsit”* novela, 1996.
- “*Shtëpia e mbetur përgjysmë*”, roman, 1997, për të cilin Pjetër Arbnorit iu shtuan dhjetë vjet burg.
- “*Vorbulla*”, roman, Shtëpia Botuese “Bilal Xhaferri”, 1997.
- “*Letër nga burgu*”.
- “*Nga jeta në burgjet komuniste*” (studime historike 1992).
- “*Brajtoni, një vetëtimë e largët*”, roman, 2000.
- “*Lufta për të mbetur njeri*”, intervista, 1990-2000.
- “*Historia e Anglisë*”, Andre Morua, përkthim, 1996.

Shoqëria “Vllaznia” (1919)

Shoqëria “Vllaznia” zë një vend të rëndësishëm në jetën kulturore-artistike dhe politike të qytetit të Shkodrës. Veprimtaria e saj filloi në vitin 1919. Megjithëse e kufizuar në kohë (1919-1922), veprimtaria e kësaj shoqërie qe shumë e pasur dhe e gjithanshme.

Të nisur nga qëllimi fisnik për t’i shërbyer atdheut, më 16 shkurt 1919, në shtëpinë e fotografit patriot Kel Marubi, anëtarët e shoqërive “Vaso Pasha” dhe “Mustafa Pasha”, dy shoqëri që formalisht i ndante përkatësia fetare, por jo ideali kombëtar, u bashkuan dhe formuan shoqërinë me emrin kuptimplotë “Vllaznia”. Në shoqëritë e porsaformuara aderuan edhe pjesa më e madhe e anëtarëve të shoqërisë “Nji tubë djelmi shkodrane”. Baza shoqërore e shoqërisë “Vllaznia” qe mjaft e gjerë. Në të bënin pjesë, artistë e tregtarë, shkrimtarë e gazetarë, nëpunës e zanatçij, sportistë e shkollarë. Nismëtar për themelimin e shoqërisë “Vllaznia” qe poeti Hilë Mosi, pjesëmarrës me armë në dorë në kryengritjen e Malësisë së Madhe të vitit 1911, themelues i disa shoqërive atdhetare-kulturore në Korçë e Shkodër, anëtar i “Komisës letrare shqipe”, publicist dhe shqipëruar i talentuar. Ai ishte bërë tashmë një personalitet i njohur dhe shumë popullor në qytetin e lindjes, prandaj në mbledhjen themeluese të shoqërisë, Hilë Mosi u zgjodh njëzëri kryetar i saj. Nën kryetar u zgjodh Hysen Draçini, arkëtar Patuk Saraçi, këshilltarë Kel Marubi dhe Luigj Kodheli, kontrollorë Taip Hilmia dhe Omer Ruzhdia, sekretar Jonuz Tafilaj, llogaritar Ali Borshi. Në kryesinë e shoqërisë bënin pjesë edhe drejtuesit e katër degëve vepruese të shoqërisë: Kristo Floqi për degën letrare, Salih Nivica për degën teatrore, Ndue Paluca për degën muzikore dhe Kolë Margjini për degën gjimnastikore. Meqë Salih Nivica ishte i zënë me botimin e gazetës “Populli”, si zëvendës i tij u zgjodh Mati Logoreci.

Në dokumentin programatik, botuar së bashku me rregulloren (statutin) e shoqërisë në numrin e parë të së përkohshmes letrare “Agimi”, shprehet qartë qëllimi që do të udhëhiqte anëtarët e “Vllaznisë” në veprimtarinë e tyre: “Duem të zgjojmë kombin

shqypetar në zhdrivillimin e gjuhës së tij letrare e në kulturën qi ka me vijue mbas tashit...” (Agimi, maj 1919, fq.1-4). Me që atë vit Shkodra ndodhej nën kontrollin e forcave ushtarake aleate të komanduara nga gjenerali francez Bardi de Fourtou, shoqëria u detyrua të pranonte se do ta zhvillonte veprimtarinë e vet “... tue mos u përzi në politikë”. Por siç do të shohim më poshtë, shoqëria “Vllaznia” nuk vonoi ta shpallte veten si një shoqëri edhe me karakter politik. Rregullorja e shoqërisë “Vllaznia” përbante 19 nene të ndarë në katër kapituj: I. Anëtarët, detyrat e anëtarëve veprues; II. Degët e shoqërisë dhe detyrat e tyre; III. Paria dhe IV. Shpërblime. Shoqëria “Vllaznia” kishte gjithashtu vulën, distiktivin e flamurin e saj. Flamuri i shoqërisë qe flamuri ynë kombëtar me katër shirita në to, me gërma ngjyrë ari degët e shoqërisë. Shoqëria “Vllaznia” gëzoi konsideratën më të lartë nga Luigj Gurakuqi, i cili, në një takim me anëtarët e shoqërisë “zhvilloj, me atë rethorikën e vet si e ka zakon, qëllimin qi secila Degë e Vllaznisë do ta ketë parasysh, e pat fjalë lavdërimi e nderimi për shoqin tonë”. (Agimi, prill 1921 fq. 178). Fakti që në muajt e parë të krijimit të saj shoqëria numëronte 172 anëtarë veprues dhe 74 anëtarë ndihmëtarë, flet qartë për jehonën e favorshme që shkaktoi në opinionin qytetar shkodran formimi i shoqërisë “Vllaznia”. Si lokal, në fillim, shoqëria pati dy dhoma në Shkollën e Parrucës.

Ndërkohë degët e shoqërisë kishin filluar apo përgatiteshin të fillonin veprimtarinë e tyre. Për t’u shënuar, gjatë vitit 1919, është veprimtaria e degëve letrare dhe teatrore. Kështu, duke u mbështetur në rubrikën “Veprimet e deritanishme” (Agimi, maj 1919, fq. 5), mësojmë se me 5 prill 1919 shoqëria hapi një shkollë nate me 4 rende dhe 7 mësues, shkollë të cilën e ndoqën mbi 100 të rinj e të rritur. Programi mësimor përfshinte, në periudhën e parë, dhënien e lëndëve me shkrim, këndim e aritmetikë. Gjatë kohës numri i nxënësve arriti deri në 200. Falë punës plot vetmohim të mësuesve që jepnin mësim në këtë shkollë, ajo luajti një rrol të rëndësishëm në luftën kundër analfabetizmit. Gjithashtu dega letrare hapi në një prej mjediseve të Shkollës së Prrucës një sallë leximi që u frekuentua nga shumë qytetarë shkodranë. Fondit të librave që shoqëria “Vllaznia” trashëgoi nga “Komisia Letrare shqipe” (1916-1918), iu shtuan gjatë

kohës libra të rinj, gazeta e revista të ndryshme shqipe dhe të huaja. Në veprimtarinë e degës letrare bënte pjesë edhe organizimi, kohë pas kohe, i konferencave me karakter divulgativ apo shkencor, siç qe “Mbi vjetërsinë e shkrimit të gjuhës shqipe” mbajtur më 21 prill 1919 nga Kristo Floqi në sallën e kinemasë së qytetit. Vlera të veçanta, në kontekstin e veprimtari së degës letrare, ka botimi i së përkohshmes letare “Agimi” ku bashkpunuan disa nga pendat më të mira të kohës. Përveç pasqyrimit të veprimtarisë së degëve të ndryshme të shoqërisë, në këtë të përkohshme u trajtua me kompetencë probleme të gjuhës, të arsimit, historisë, edukatës, shkencës, të traditave të popullit, kulturës, artit e deri tek ato të sportit. Drejtues i saj gjatë vitit të parë të botimit qe Kristo Floqi; kurse, duke filluar nga viti i dytë i botimit (maj 1920) dhe deri në numrin e fundit të vitit të tretë (mars-prill 1922), drejtues i saj qe Karl Gurakuqi.

Po aq e pasur gjatë vitit 1919 qe edhe veprimtaria e degës teatrore. Kështu më 29 e 30 qershor 1919, shfaqet në kinemanë e qytetit komedia “Shërbëtori i dy zotnive” e komediografrit italian Carlo Goldoni, përkthyer e përshtatur nga Hilë Mosi. Interpretuan: Kolë Gurakuqi dhe Hilë Mosi (në rolet e dy zotnive), komiku i njohur Gjon Krajni (në rolin e Tafrrukut), Ali Borshi, Lin Deda, Tef Leka, Jonuz Tafilaj. Skenari: Luigj Kakarriqi. Në mes të akteve, orkestra e shoqërisë “Rozafat”, ekzekutoi pjesë të ndryshme muzikore. Shtojmë se bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë “Vllaznia” dhe dy shoqërive simotra “Rozafat” e “Bogdanit” qe mjaft i frytshëm edhe në veprimtarinë e ardhshme. Më 11 gusht 1919 shfaqet drama 3 aktesh “Ermina e vorfën”, shkruar nga Kolë Gurakuqi sipas subjektit të një filmi austriak të kohës. Interpretuan: Lin Deda, Roza Shoshi, Kolë Mjeda, Kolë Gurakuqi, Ali Borshi, Jonuz Buliqi, Tef Leka, Jonuz Tafilaj, Omer Ruzhdia, Muhamet Reçi. Regjia: Luigj Kakarriqi, dekori: Gasper Simoni. Për herë të parë së bashku me burra, interpretoi edhe një aktore femër, gjë që shkaktoi mjaft polemika në shtypin e kohës. Drama u përsërit edhe me datën 14 dhjetor 1919. Me 14 shtator 1919 shfaqet komedia “Dy shërbëtorët” e Goldoni-t, përkthyer dhe përshtatur nga Hilë Mosi. Në rolet kryesore interpretuan Cin Daija dha Lazër Gurakuqi. Regjia: Luigj Kakarriqi. Në mes të akteve pianisti

Luigj Filaj luajti pjesë të zgjedhura muzikore. Duke komentuar këtë shfaqje, e përkohshmja “Agimi”, ndër të tjera, shkruan: “Ndonëse origjinali e tregon vendin e njerëzit e komedisë ndodhë në Itali, edhe kësaj here Hilë Mosi dijtë me e shkruar këtë komedi e me i dhënë një trajtë aq shqyptare sa me u dukë më fort pjesë origjinale se sa një përkthim” (Agimi, tetor 1919, fq. 93-94). Më 27 nëntor 1919, në përvjetorin e shtatë të shpalljes së Pavarësisë, aktorët amatorë të shoqërisë “Vllaznia” dhanë për publikun shkodran dramën historike me 5 akte “Karl Topia” veprë origjinale e Kristo Floqit. Drama “Karl Topia” së bashku me komedinë “Shërbëtori i dy zotnive” u përsërit edhe me datën 21 dhjetor 1919.

Gjatë vitit 1919 u dhanë gjithsej 12 shfaqje teatrore. Me të ardhurat e vjelura nga shitja e biletave u pasurua skena, rekuizita dhe u siguruva financimi për botimin e së përkohshmes “Agimi” gjatë gjithë vitit. Shtojmë se për përballimin e shpenzimeve administrative, pajisjen e degëve të ndryshme me mjetet e nevojshme etj., krahas kuotave të anëtarëve të shoqërisë, e konsiderueshme ishte edhe ndihma në të holla që dhanë bujarisht shumë familje të njohura shkodrane.

Viti 1920 shënoi një rritje cilësore të veprimtarisë së Shoqërisë “Vllaznia”. Krahas degëve letrare dhe teatrore, filloi të konkretizohet edhe veprimtaria e degëve muzikore e gjimnastikore që kishin mbetur deri në fazën përgatitore. Nga ana tjetër, largimi i forcave të huaja ushtarake nga qyteti dhe bashkimi i Shkodrës me qeverinë kombëtare të dalë nga Kongresi i Lushnjës, krijuan terrenin e përshtatshëm për shtrirjen e veprimtarisë së Shoqërisë edhe në sferën publike. Për këtë qëllim mbledhja e kryesisë së Shoqërisë mbajtur më 23 prill 1920 vendosi njëzëri që: “programi i jonë të zgjanohet tue u marrë edhe me politikë, kështu qi shoqnia të bahej prijsja e të gjithë djelmnís shqyptare në lamën letrare e politikë...” (Agimi, maj 1920, fq. 15). Duke filluar nga viti i dytë i botimit (maj 1920) edhe e përkohshmja letrare “Agimi” të quhet e përkohshme letrare-politike. Ndonëse me karakter lokal, shoqëria “Vllaznia” nuk u mbyll në guackën e vet. Ajo qe plotësisht e ndjeshme ndaj ngjarjeve të vendit, jashtë Shkodrës, duke mbajtur gjithmonë një qëndrim entuziast. Në një shkrim me titull “Moti sot” botuar nga Hilë Mosi në organin e shoqërisë, ndër të

tjera lexojmë: “Shpresa jonë ka nisur të shtohet edhe më shumë, kur shofim se edhe djelmënia e Durrësit, tue marrë si pasqyrë shoqërinë tonë, themelohet ndër kohënat e fundshme një shoqëri me emnin “Vllazënia”. Na shpresojmë se të tilla shoqëria kanë me u ngrënë kudo në Shqipëri edhe se djelmënia shqiptare tue perdoruem mjetet *mâ të bukura: Letratyrën, theatrin, muzikën dhe gjimnastikën ka me e shfít* popullin tonë në një jetë të ré, qi ka me u quejtë ajo e përlindjes së Shqipërisë” (Agimi, janar 1920, fq. 138)

Para se të vazhdojmë me kronikën e veprimtarisë së degëve letrare e teatrore, shënojmë se, ndërkohë, ishin miratuar rregulloret e reja dhe zgjedhur drejtuesit e rinj të këtyre degëve, përkatësisht Karl Gurakuqi për degën letrare dhe Kolec Deda për degën teatrore. Ndësa fusha e veprimtarisë së degës letrare përqendrohet si dhe më parë në mbarëvajtjen e shkollës së natës, mbarështrimin e bibliotekës dhe botimin e së përkohshmes “Agimi”; dega teatrore vazhdon ta pasurojë repertorin e vet me pjesë të reja origjinale, të përkthyer apo të përshtatura nga repertori i huaj.

Serinë e shfaqjeve për vitin 1920, aktorët amatorë të shoqërisë “Vllaznia” e çelën me dramën me 3 akte “Filja” të dramaturgut gjerman Theodor Körner, përkthyer dhe përshtatur nga Hilë Mosi. Drama u dha më 19 mars 1920, në përvjetorin e gjashtë të ngritjes së flamurit kombëtar në kështjellën Rozafat dhe me rastin e bashkimit të Shkodrës me Qeverinë e Tiranës. Ngjarjet e dramës, në variantin shqip, zhvillohen në Kurbin të Krujës, dhe trajtojnë episode nga qëndresa e popullit tonë në të kaluarën. Në shfaqjen e dramës asistuan Ahmet Zogolli, ministër i brendshëm dhe Hoxha Kadrija, ministër i drejtësisë. Më 5 prill 1920 shfaqen idilin me një akt “Shqypnia”, të shkruar nga Kolë Gurakuqi dhe komedinë me një akt “Bija e bankierit” të Kristo Floqit. Më 25 dhe 26 prill 1920 shfaqet drama me katër akte “Atdheu” ose “Lufta e Silistrës” e shkruar nga Namik Qemal (1835-1890), përkthyer nga Sabri Qyteza (variant gegë nga Kolë Gurakuqi). Interpretuan: Ramadan Mendiçi, Shuk Radoja, Luigj Halepiani, Ndoc Temali. Regjia: Luigj Kakarriçi. Së bashku me dramën “Atdheu” përsëritet edhe komedia “Bija e Bankierit”. Drama pa komedi u shfaq edhe me 27 prill për nxënësit e shkollave

të qytetit. Më 6 dhe 9 qershor 1920, në skenën provizore ngritur nga shoqëria “Vllaznia” në Lulishtën Popullore, jepen komedia me një akt “Vllazni e interesë” e Kristo Floqit interpretuar nga Ndoc Temali, Luigj Kakarriqi, Salvator Kurti etj., farsa “Fëmijët tonë”, përshtatur sipas shkrimtarit Branislav Nushiq nga Luigj Kakarriqi dhe interpretuar nga Tish Prendushi dhe Zef Shkanjeti, si dhe komedia me një akt “Do të vras vedin” e Kristo Floqit, e interpretuar nga Luigj Kakarriqi (në rolin e Patukut) dhe Ndoc Temali (në rolin e shërbëtorit). Më 13 qershor 1929 jepen komeditë me një akt “Nder e qytetni” dhe “Reklamë e blofë” të Kristo Floqit. Më 28 nëntor 1920 shfaqet tragjedia me pesë akte “Pirro Neoptolemi”, punuar nga Kristo Floqi sipas veprës “Andromaque” të Jeane Racine. Në variantin e dhënë, autori i mirënjohur i sa e sa pjesëve teatrore, përshkruan ngjarje që kanë të bëjnë me historinë e lashtë të popullit tonë. Interpretuan: Tef Leka (në rolin e Pirros). Ramadan Mandiqi (në rolin e Orestit), Shuk Radoja (në rolin e Andromakës), Luigj Halepjani (në rolin e Hermionës), Lush Radoja (në rolin e Qefizës), Ndoc Temali (në rolin e Kleonës), Ali Borshi (në rolin e Pilladit), Zenel Broja (në rolin e Feniksit). Për të parën herë, orchestra e shoqërisë “Vllaznia” ekzekuton në pushimet mes akteve pjesë të ndryshme muzikore. Më 26 dhjetor 1920 jepet komedia me tre akte “Mjek me përdhuni” e komediografit francez Molière, përkthyer dhe përshtatur nga Kolë Gurakuqi dhe farsa “Nusja e pela”, përkthyer, siç duket, nga italishtja prej Ejëll Ljarjes. Interpretuan: Salvator Kurti, Shuk Radoja, Loro Kovaçi, Zef Qerraxhija. Me 6 shkurt 1921, ditën e Karnavaleve, shfaqet komedia një akti “Koprraci” e Goldoni-t, përkthyer nga Karl Gurakuqi dhe Shyqyri Borshi, i cili interpretoi gjithashtu edhe rolin e kopracit. Së bashku me komedinë, u dha edhe farsa “Dragomani”, përkthyer nga Shyqyri Borshi dhe monologu “Mbi feminizmin”. Komedia “Koprraci” që pati mjaft sukses u përsërit edhe me 20 shkurt së bashku me monologun humoristik “Trimnija e frikacakut” të humoristit italian Gandolini, përkthyer nga Shyqyri Borshi. Vepra e fundit teatrore që përgatitën aktorët amatorë të shoqërisë “Vllaznia” për artdashësit shkodranë ishte drama “Besa” e Sami Frashërit, që u shfaq në kinemanë e qytetit me 26 nëntor 1921. Rënia

e veprimtarisë së degës teatrore gjatë vitit 1921, në krahasim me dy vitet e mëparshme, duhet shpjeguar, në radhë të parë, me largimin nga Shkodra, për arsye pune, të disa prej amatorëve më cilësorë të shoqërisë “Vllaznia”.

Larg Shkodrës, për shkak të detyrave të rëndësishme shtetërore që mbulonte, ndodhej edhe kryetari i shoqërisë Hilë Mosi. Prandaj, mbledhja e përgjithshme e datës 9 janar 1921 pasi shpalli njëzëri Hilë Mosin kryetar nderi të shoqërisë; zgjodhi kryesinë e re të përbërë nga Patuk Saraçi, kryetar; Hysjen Draçini, nënkryetar; Kel Naraçi, sekretar; Ramadan Mandija, arkëtar; Kolë Mjeda dhe Ismajl Anamali, këshilltarë; Ali Borshi dhe Kolec Deda, kontrollorë.

Krahas veprimtarisë së gjerë të degëve letrare dhe teatrore, një vend të dukshëm zë edhe veprimtaria e degës muzikore. Drejtues i saj duke filluar nga muaji maj i vitit 1920, qe mjeshtri Zef Kurti. Për t’u shënuar gjithashtu ndihmesa e vyer që ka dhënë në mbarëvajtjen e degës muzikore të shoqërisë “Vllaznia” mësuesi me përvojë drejtuese i muzikës Luigj Prela. Baza e kësaj veprimtarie qe, në radhë të parë, banda muzikore (shoqëria kishte dhe një orkestër, të kufizuar në numër, në formë madolinate). Me një efektiv të vogël, por luftarak, duke patur mbështetje të mirë të ish pjestarët e bandës muzikore të Shkollës së Artizanatit, ajo fillon shumë shpejt të gjallërojë me tingujt e saj festive ngjarjet e ndryshme me karakter kulturor, shoqëror apo politik që karakterizuan gjatë asaj periudhe jetën e qytetarëve shkodranë. Ja disa nga faqet e ditarit të veprimtarisë së degës muzikore të shoqërisë “Vllaznia” në përgjithësi dhe të bandës muzikore në veçanti.

Më 20 dhjetor 1920, ajo i prin manifestimit mbarëpopullor me rastin e pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Ndërkohë, banda muzikore e shoqërisë kishte filluar të jepte rregullisht koncerte për popull në lulishten kryesore të qytetit. Më 30 mars 1921 arriti për një vizitë në qytetin e Shkodrës deputeti francez Justin Godart, i cili në Konferencën e Paqes dhe në sa e sa botime të tij mbrojti me forcë çështjen shqiptare. Në banketin e shtruar për nder të tij nga Bashkia, muarën pjesë edhe banda muzikore e shoqërisë “Vllaznia” dhe orkestra e shoqërisë “Rozafat” “të cilat patën nderime të posaçme

prej z. Godart...” (Agimi, prill 1921, fq. 179-180). Në datat 11 dhe 13 maj 1921, dega muzikore dhe teatrore e shoqërisë “Vllaznia” bënë një turne në qytetet Lezhë, Tiranë, Shijak, Durrës dhe Shëngjin. Nga kronika e këtij turne të suksesshëm shkëpusim fragmentet: “eskursionistat hynë në qytet të Tiranës nëpërmjet joneve të ambla të bandës së “Vllaznisë” e të valleve kombëtare... Me datë 12 dega teatrore çfaqë në lokalin e shoqërisë “Lidhja komtare” e Tiranës dramën “Pirro Neptolemi” të përcjellun me një monolog. Ndër pushime dega muzikore knaqi veshët e ndigjesavet... me dt. 13 i paraqitet publikut të Tiranës komedija “Koprraci” e farsa “Dragomani”, mbasi mbasdreke ishte dhanë një koncert i kandshëm prej degës muzikore në fushë të Selvijat”. (Agimi, maj 1921, fq. 17-18). Më 24 maj 1921, Shoqëritë “Vllaznia” dhe “Bogdani” dhanë në sallën e kinemasë së qytetit një argëtim teatror-muzikor për nder të një grupi deputetësh që kishin ardhur ato ditë me mision në Shkodër. Më 3 shtator 1921, me ftesë të Bashkisë së Vlorës, banda muzikore e “Vllaznisë” shkon në qytetin e Vlorës për të marrë pjesë në festimet që u organizuan atje me rastin e bashkimit të Vlorës me Qeverinë Kombëtare. Me këtë rast ato i bënë një vizitë atdhetarit Avni Rustemi. Më 24 shtator 1921, populli i Shkodrës priti profesorin Eugène Pittard, mbojtësin e palodhur të drejtave të shqiptarëve në qarqet diplomatike europiane. Në hyrje të qytetit kishte dalë për ta pritur mysafirin e shquar edhe banda muzikore e shoqërisë “Vllaznia”. Në mbrëmjen e datës 26, shoqëritë “Vllaznia” dhe “Rozafat” shtruan për nder të bashkëshortëve Pittard një banket në Hotel “Europa” ku së bashku me të ftuarit tjerë ishin të pranishme edhe dy orkestrat e shoqërive mikpritëse. Me 28 shtator 1921, shoqëritë “Vllaznia” dhe “Rozafat” dhanë në nderim të Avni Rustemit një banket në Kafën “Adriatik”, ku morën pjesë autoritetet vendore, banda muzikore e “Vllaznisë” dhe orkestra “Rozafat”. Karl Gurakuqi e përhëndeti mikun dhe atdhetarin e shquar në emër të shoqërive. Më 29 nëntor 1921, malësorët e Hotit, të Grudës e të Kastratit, të udhëhequr prej françeskanëve të Malësisë së Madhe dhe prej bandës muzikore të shoqërisë “Vllaznia”, u mbledhën para bashkisë së qytetit për t’i paraqitur përfaqësuesve të Lidhjes së Kombeve protestën e tyre për padrejtësinë që u kishte bërë Europa

duke i lënë nën zgjedhë të serbëve dhe për të kërkuar bashkimin e trojeve të tyre me Shqipërinë. Më 23 dhjetor 1921 organizohet në Shkodër një tjetër miting i madh në shenjë solidariteti me shqiptarët e krahinave veriore të shpëputura padrejtësisht nga kufijtë e ligjshëm të atdheut dhe për t'i paraqitur Komisionit të Lidhjes së Kombeve për caktimin e kufijve, kërkesën për shpëtimin e Hotit e të Grudës. “Banda muzikore e shoqërisë “Vllaznija”, si gjithmonë, as kso here, s’u kursye me marrë pjesë në këtë miting të mjerueshëm”. (“Hylli i Dritës”, dhjetor 1921). Më 7 mars 1922 arrin në Shkodër Komisioni Aleat për Caktimin e Kufijve. Në hyrje të qytetit, së bashku me popullin dhe autoritetet vendore, kishin dalë për t’i pritur edhe anëtarët e shoqërive të ndryshme me në krye bandën muzikore të Shoqërisë “Vllaznia”.

Me të drejtë emri “Vllaznia” ka mbetur në kujtesën tonë si i pari klub sportiv shqiptar me të cilin janë të lidhura fillesat e disa llojeve të sportit. Klubi sportive “Vllaznia” i qytetit të Shkodrës është krenar për sukseset që ka arritur, duke mbrojtur për më se tetë dekada ngjyrat e këtij emri kuptimplotë. Më poshtë po rreshtojmë disa momente nga veprimtaria e degës gjimnastikore të shoqërisë “Vllaznia” me drejtues, nga muaji maj 1920, Rrok Daberdaku.

Më 13 qershor 1920, pas ndeshjes së futbollit midis skuadrës së ushtarakëve italianë me qëndrim aso kohe në Shkodër dhe asaj të shoqërisë “Vllaznia”, u organizua një vrap prej 4200 metrash me pjesmarrjen e 25 vrapuesve. I pari arriti Kolë Gjoni, i cili e përshkoi këtë distance brenda 17 minutash. Përveç vrapit u organizua edhe një ecje sportive me të njëjtën largësi të cilën e mbuloi i pari, me kohën prej 23 minutash, Palokë Nika. “Ky zotni asht për t’u lëvdue se asht një ndër mâ të xetit e mâ të interesuemit për sport...” (Agimi, korrik 1920, fq. 47). Më 4 korrik 1920 organizohet përsëri një vrap prej 8 km. Për mbarëvajtje të tij u formua një komitet i posaçëm nën kryesinë e Luigj Gurakuqit. I pari arriti Palok Kola e pas tij, sipas radhës, Loro Rroku, Lluco Çetkovi e Ndue Meshkalla. Përfituesit u ndanë dhurata të ndryshme. Me rastin e 28 nëntorit 1920, krahas sa e sa veprimtarive të tjera, u zhvillua edhe një ndeshje futbollit që u ndoq nga shumë amatorë të këtij sporti. Ndeshja u zhvillua në sheshin para

Prefekturës. Më 28 mars 1921 zhvillohet një ndeshje tjetër futbollit, kurse më 29 të këtij muaji një garë çiklistike me itinerar Lulishta Popullore-Çezma Koplík. Konkurrimi i çiklistëve, të veshun me kostume sportive, ngjalli interes të veçantë te qytetarët shkodranë të cilët, me brohoritje, duke patur në krye bandën muzikore të shoqëris, përcollën dhe pritën përfundimin e garës. Fitues të garës, nga vendi i parë në të tretin genë, Loro Nika, Ndoc Kurti dhe Gaspër Daberdaku. Shoqëria “Vllaznia” ka meritën se ka organizuar e para në Europë një rreth të vërtetë çiklistik për amatorë. (Sporti, 15 Shkurt 1944). Më 23 shtator 1921 skuadra e futbollit e Shoqërisë “Vllaznia” qe ftuar nga Shoqëria Gjymnastikore e Tiranës për të zhvilluar një ndeshje futbollit me skuadrën e saj. Ndeshja që është njëkohësisht e para ndeshje futbollit midis skuadrave të këtyre dy qyteteve, u zhvillua me datën 25 pasdreke dhe u fitua nga skuadra e Shoqërisë “Vllaznia”. Krahas ndeshjeve të futbollit që zhvilloheshin here pas here midis lojtarëve anëtarë të shoqërisë, dega gjymnastikore organizoi më datën 5 mars 1922 edhe një vrap prej 8 km. Fituan garën, nga vendi i parë në të tretin, Paç Marku, Tef Prendushi, Loro Berdica. Drejtues i degës gjymnastikore të Shoqërisë gjatë periudhës së fundit të veprimtarisë së saj qe Tush Kakarriqi.

Në fillim të vitit 1921 me nismën e Avni Rustemit ngrihet në Vlorë Federata “Atdheu”, e cila kishte për qëllim bashkimin kombëtar të mbështetur në lartësimin moral, shoqëror dhe ekonomik të popullit shqiptar. Që me formimin e saj, Federata “Atdheu” u bëri thirrje të gjitha shoqërive kulturore të vendit të bashkoheshin në një program dhe një emër, duke patur një qendër të përpashkët e degë të ndryshme. Thirrjen e mësipërme shoqëria “Vllaznia” e diskutoi në mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve të saj më datën 13 mars 1921, mbledhje në të cilën mori pjesë edhe një i dërguar i Federatës. Me zëra të përbashkët, mbledhja dha pëlqimin për aderimin e shoqërisë “Vllaznia” në Federatën “Atdheu” dhe caktoi kryetarin e nderit të shoqërisë, Hilë Mosi dhe Karl Gurakuqi si përfaqësues të saj në kongresin që me të drejtë u quajt Kongresi i Bashkimit Kombëtar. Kongresi i zhvilloi punimet e tij në qytetin e Vlorës nga data 25 prill deri më datën 3 maj 1921. Në përfundim të punimeve, Kongresi

miratoi statutin e ri të Federatës “Atdheu” dhe zgjodhi këshillin e përgjithshëm të përbërë nga: Kolë Tomara, kryetar; Karl Gurakuqi, sekretar; Ahmet Dakli, arkëtar; Bedri Pejani, inspektor; Seid Kemali, drejtues i revistës. Kryetar nderi me zëra të përbashkët u zgjodh nismëtari për krijimin e Federatës “Atdheu” Avni Rustemi.

Për t’iu përshtatur gjendjes që solli me vete aderimi i shoqërisë “Vllaznia” në federatën “Atdheu”, u mbajt me 16 tetor 1921, në sallonin e Shkollës Qytetëze, mbledhja e përgjithshme e Shoqërisë ku u zgjodh gjithashtu edhe kryesia e re e përbërë nga Kolë Kraja, kryetar, Sandër Saraçi, sekretar; Omer Ruzhdija, Ali Borshi dhe Spiridon Kacarosi, kontrollorë.

Më 8 nëntor 1921 bëri një vizitë në qytetin e Shkodrës kryetari i nderit i Federatës “Atdheu” Avni Rustemi. Në mbasdrekën e asaj dite mbajti në sallonin e kinemasë së qytetit konferencën “Mbi detyrët e rinisë ndaj Atdheut të vet”. (Agimi, nëntor 1921, fq. 140).

Kriza qeveritare që shpërtheu asokohe në Tiranë si rezultat i grindjeve midis partive të Këshillit Kombëtar, shqetësoi me të drejtë patriotët e vërtetë. Duke u bashkuar me këtë shqetësim, shoqëritë e ndryshme të qytetit të Shkodrës i drejtuan Parlamentit këtë telegram: “Gjithë populli ka sjellë sytë kah ju; ka mbështetë shpresat e veta. Ky ju ka dhânë provët mâ të shndritshmet për urti e bindje, por ju, mjerisht me dasi tuej keni lëkundë themralin e zvoglue autoritetin e Qeverisë. Bajmë pra thirrje patriotizmit qi t’i pushoni grindjet, qi të sakrifikoni ambicionet vetjake në elter të Atdheut e qi të merni parasysh popullin qi po vuen në vorfni e të kujdeseni me i gjetë mjetet e gjallnimit”, Kel Marubi; p. Shoq “ Rozafat”, Zef Kadarja; p. Shoq. “Puntore”, Kolë Mjeda; p. Shoq “Detare”, Omer Ruzhdi; p. Shoq. “Bogdani”, Zef M. Harapi. (Agim, dhjetor 1921, fq. 160)

Viti 1922 qe viti i rënies së veprimtarisë së Shoqërisë “Vllaznia” dhe i shpërndajes së saj. Për t’u shënuar gjatë muajve të parë të vitit 1922 është veprimtaria e degës letrare me drejtues Kolë Kamsin. “Përveç të mbajtunit të revistës, dega asht përkujdesë në një mënyrë të veçantë me smadhue bibliotekën e me përmisue sallën e leximit ku djelmnia kalon kohë me dobi tue lexue libra, revista e gazeta shqipe e të hueja. Edhe dega muzikore nën drejtimin e Luigj Prelës, ndonëse

disa pjestarë janë largue nga Shkodra për arsye pune, merr pjesë si dhe më parë në manifestime kombtare, ndër të kremte e argëtime të popullit”. (Agimi, mars-prill 1922, fq. 223). Me gjithë kohën e shkurtër të ekzistencës, me veprimtarinë e saj të gjithanshme, Shoqëria “Vllaznia” ndihmoi shumë për mbajtjen gjallë në popull të ndjenjave të atdhedashurisë, i shërbeu edukimit të ri të jetës kulturore-artistike në qytetin e Shkodrës.

Marrë nga: Jeta kulturore e Shkodrës
(mesi i shek. XIX-mesi i shek. XX). Tiranë:Asmus,
2006, ff. 51-61)

Hamid Gjylbegaj (1888-1979)

*Intelektual desident. Njeri me kulturë të gjanë
dhe autor i një serie veprash poetike.*

Poezia e bukuris

Poezia e bukurija,
Si arsyeja dhe vetdija
Por teprija e hartit
Të rrëcon prej s'naltit

Poezija është e bukur,
N'sa t'perdheshmen n'qiell e ngritë;
Voeja n'vëme bâhet flutur,
Errësina i duket dritë !

Kërkon lulet nder kopshtije,
E i shijon për ças e orë;
Për kujtim për shêj dashtnije,
Bukurin shijon pa prâ !...

Lulet, veç, sa t'jenë n'gëzim t'vet,
Kanë shum erë, dhe bukuri;
Mbassi t'këputen kush s'iu jet,
N'dorë i merr ênde një fëmi !....

Prandej lulen, kur t'a zgjedhim,
Me gjithë rrâjë duhet m'e nxjerrë;
Sepse n'kopshtin qi t'a mjellim,
Eren kurr s'ka për t'a bjerrë.

Pjetër Gjini (1908-1988)

Shkrimtar, gazetar dhe kompozitor, me një kontribut të vyem në “Radio Tirana” gjatë viteve 1938-1944. Æsht cilësue si një ndër krijuesit dhe kantautorëtma të shquem shqiptarë në krijimtarinë humoristike.

Nji shikim!

Pranverat prap kthehen
Rinija por, nget,
Ændrrimet po mshehen
N’ mal - breznin e vet.

A)

Kot thirra kaq mote
Ndiesija s’ t’ u prek
Prap zëmra qi t’ dote
Ndër vuetje po hjek.

A)

Sod, shpresën e kputa,
Mundimet jan’ kot
Mjaft stina t’ u luta
Me kangë e me lot.

A)

Tash s’ lypi kujtime,
Jo, lule s’ kërkuj,
Nënqeshje, premtime,
Kurr ma nuk androjt.

A)

Nji hir veç prej teje
Po due n’ ket prendim:
Kur t’ endesh pran’ meje
Me m’ fale nji shikim,

Prej të t’ cilit përhera
Do t’ dejem n’ gazmend,
T’ kaluemet pranvera
Kah t’ sielli ndërmend.

A)

*(Marrë prej rev.:
“Shkëndija”, Maj-Qershuer
1941, f. 46)*

Gasper Pali (1916-1942)

Poet lirik dheprozator. Ban pjesë tek brezi i artë i 30-40-s, që u shkollue jashtë vendit, konkretisht në Firenze.

Poezitë e tij dallohen për sensualitetin poetik dhe për një estetikë novatore në letërsinë shqipe.

Prendimi i andrrimeve

Zhurma e karrove

meket mbi qelqe t'bardh' të dhomës s'ime,
nga sheshi ktu tue ardhë.

E mbrend' s dridhet n'ajri
as ma e vogla valë.

E mue andrrimet më bulojnë
e syt' me ndriza hijesh m'avullojnë.

Vegime m'lejnë atherë
në ket mjesditë zhegore.

E shoh, shka s pashë kurr në jetë.

ndiej shka s ndjeva kurr një herë:

vasha me buz' n't'cillat shperthyen burbuqet,
shtëpija të ndertueme

n'rubina, si mollza fytyrash vashnore,
ku rrrshqet gazi, si 'i mij gush' bilbilash.

Por një za nga fundi i shpirtit më trandë.

Shkyhet tisi i vegimeve t'krijueme.

Me një herë zhduken lulishtat prrallzore

si hyjt, që shkputen në një natë verore.

Zani më grishë me jetue

e jo me afrue qepallen me qepallë

e me ndejë tue andrrue.

Më thotë zani: me i kndue jetës,

më thotë zani: me i kndue kohës,

më thotë zani: "Kndoj s'vertetës!"

Shkoder, 10 Qersh. 1941

(Marrë nga: Gasper Pali, *Prendimi i andrrimeve*
[përgatitë dhe pajisë me shënime nga Lisandri Kola]
Dit' e Nat', Prishtinë, Kosovë, 2015, ff. 43-44.)

A)

Qemal Draçini (1922-1947)

Kritik, studiues, publicist, lëvrues i prozës dhe e poezisë.
Së bashku me Muzafer Pipën themeloi revistën
letrare "Fryma". At Gjergj Fishta i propozoi ta
kishte sekretar. Vdiq në moshë shumë të re
në burgjet komuniste.

Bjen shi

Bjen shi pa da mbi qytetin e heshtun,
Thell n' dhomë vetmitare gjimon stuhija;
Mbi xhamat e ndymë rrjedh ujt n' njimij vija.
Thell pershkohet ujt n' tokë nga afshi rreshkun.

Mbi xham t' djersitun, ça nga njimij vija,
Me germa t' shtrembta emni i saj a shkruet:
Emni i saj – dashtnit ledhatuese.
n' kohen e larg't, – porsa ish n' prak rinija.
Bjen shi pa da e dhimbshem trishtija
Zatet n' zemër tonë, si zog mali i tretun.
Mallim i trishtimit zgjohen n' zemër t' fjetun.
(Një za vikat t' madhe, nalt ktu te shpija).
Emni i saj, shkruet n' xham t' ndyt, nga djersa rimë.
Kur men shiu, nis kadal, me djersë, m' u shqimë.
Shkodër, 12 Korrik 1944

(Marrëprej vëllimit: "Era", Enti botues 'Gjergj Fishta',
Lezhë, 1995, f. 342)

Pashko Gjeçi [Pa-Gjë] (1918-2010)

Përkthyes i shquem i veprave të autorëve klasikë grekë, italianë, anglezë dhe gjermanë, mes të cilave përmendet përkthimi i “Komedisë Hyjnore” të Dantes.

Ecce Homo!

“Ecce Homo!” - briti, me sá zâ, qi kí’te,
romaku. Krahve t’ shprishun hjellë një mloje,
me ’i kunorë ferrash n’ krye, kambë-zbathë, po vite
një nieri. Populli uluriti: “Kryqzoje!”
“Mâ ky s’ka faj” tha, kah për të dhimë ndite.
Ndrejtë n’ kambë, me ’i kallam n’ dorë, pa qitë fjalë goje
kish mbetë, e gjak prej krës nper mjekerr bite -
“Ká fye Çezarin” zane ushtuen. Të droje
filloi zyrtari atbotë: “S’ due me u perzí
n’ gjak t’ njaj t’ pafaji”. U dridhen si n’ gjamë t’ motit
shpijat: “Aj gjak raftë krejt mbi né, mbi fmí!”
Kadalë i çoi qerpik’ t e rit prej lotit
Martiri edhe i shikjoi... Por e kan ndí
Ato mure sá i randë kje gjaku i Zotit.

(Marrë prej revistës:

*“Zâni i Shna Ndout”, Nr. 4, 1937,
ff. 105-106)*

Mirash Ivanaj (1891-1953)

Ministër, politikan dhe figurë autoritare. Cilësohet si reformues i arsimit shqiptar. Së bashku me të vëllanë Martinin shkruen poezi në serbokroatishte. Soneti i zgjedhun në këtë numër asht përkthye nga dr. Pjetër Dreshaj.

Nata e fundit

Nga soneti “Otilijes”

Në mes të natës së errët, kur vijnë orë të llahtarisë
E fantazmat ngrehin valle e qyqja e zezë duke qarë
Me zë të dhimbshëm kërkon të natës thesar
Pishtari dritëmadh varrimin tim stolis.

Këngë e dhimbshme vdekjeje, s’ dëgjohej as ofshamë
S’ dalin nga gjoks i molisur dhe as sarkofagu
S’ laget nga lotët, që e dashura m’i çon prej së largu
E flakë e pishtarit fiktohet në çastin e mbramë...

E gatshme gropë e varrit ka hapur krahët e vet
Të pranojë trupin tim në të përjetshmen shtëpi jetike
Me zemërim e kapluar, mbi të ngriten plot pikëllim,
Në vend lulesh kurorë ferrash, e dashur, ku je, medet!
Sepse gjithkush aty i la, përveç një hije besnike,
Përmbi sarkofag është shtrirë oh, ai qenka fati im...!

(Marrë nga: Vëllezërit Ivanaj, *Kulla e shpresës sime...*, Tiranë, 2008, f. 42)

Arshi Pipa (1920-1997)

Poet, përkthyes, studiues, dhe albanolog që ushtroi veprimtarinë e tij në Shqipëri dhe disa universitete amerikane ku kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij. Themelues i revistës “Kritika”, e para revistë letrare që i kushtohet kritikës, si edhe “Albanica” që e drejtoi mbas 1990 në Amerikë.

Vjeshtë e dytë

Shkëlzejnë nën rrezet e pjerrta
pemët e vjeluna
me kunorën e plotë gjelbëroshe.
Janë tash vetëm për vete,
të bukura e të kota,
lirue nga barra e fryteve.
E një qiell i panjollë
e një prâjë e gjanë rretheqark,
trazue veç rrallë nga zukatja e një kandrre,
i ndjellin shpirtit një ndije
t’ambël pranije
qi shembullen amshimin.

E mâ e vërteta më duket
ndër stinët e motit vjeshta.
E mundem ashtu me gëzue
rrezet e vokta e gjethin
e gjelbër, tue harrue
pakuptimin e qenjes.

(Marrë prej vëllimit “Libri i burgut”, 1994, f. 192)

Muhamet Ademi [Hesperus] (-)

Poet me ndjesi të thellë lirike, i cili heshti përgjatë komunizmit, tue e ba poezinë e tij pjesë të sirtarit derisa u botue në 2011 (mbas vdekjes) vepra “Liria e fjes së bari”. Kjo vepër asht dhe fituese e çmimit I në Panairin e Librit të atij vjeti.

(Pa titull)

natën nuk mund t’a kapi
nër gishta t’ mÿj t’a shtrydhi
t’a thej si lulen n’ gjij

fryma e saj valavitet
hija e saj dridhet
nër buzët’ e syt tonë
deperton
si heshtja permes gjethvet
t’ pluhnosun

fanitet hareja
e ndrydhun n’ gjoksin tim
t’ plaguem

e rrjedh në pika gjaku
e gjaku âsht kangë
e gjaku âsht lumtuní
e gjaku âsht Bukurí

por bukurija ban
qi lodja të jetë natë
e nata kangë qi s’prânë
në mue

(Marrë prej revistës: “Fryma”, vjeti I, nr. 1, Shkodër, Kallnuer, 1944, f. 14)

Muzafer Pipa [m.] (1914-1916)

Jurist dhe shkrimtar. Drejtor përgjegjës i revistës “Fryma” themelue në bashkëpunim me vëllanë, Arshinë, dhe Qemal Draçinin. Arrestohet, torturohet dhe vritet në vitin 1946 në Degën e Sigurimit në Shkodër, pasi në detyrën e avokatit, mbrojti dhe kundërshtoi dënimin më vdekje të ish mësuesit të tij të gjimnazit “Illyricum”, Át Gjon Shllakut, si edhe pjesëtarët e tjerë që u dënuen në atë rast. Koçi Xoxes, gjyqtar të procesit, dhe Bedri Spahiut, prokuror të çështjes, do t’i drejtohej me këto fjalë: «Si asht e mundun zotnij, që një trup gjykues, i cili për kryetar ka një ish-teneqexhi e për prokuror një ish-kafexhi të mundet sot me gjykue elitën e kulturës shqiptare?

Frenezi botimesh

Libri Shqip kishte vdekur prej shumë kohe më parë. Tash e nja dy muaj ka zënë e po ngjallet. Gjatë katër vjetesh librave Shqip u kish shkuar moda. Të pakë ishin ata që i lëçitnin, më të pakë ata që i shkruanin ...” Libri italian u derdh mbi ne si një valë, si një rrebesh. Jo se deri atëherë nuk njihej fare. Po pranë librit italian ishte, më i kënduar, libri frëng, gjerman ose englez. Brenda një kohe të shkurtë ky libër u zhduk nga qarkullimi: U tërhoq nga bibliotekat, u sekuestrua, u dogj. Mbeti vetëm libri itajjian. Nëpër vitrinat e librave, nëpër raftet e barakave ku shiten cingare bashkë me libra e fletore, nëpër dhogat e vendosura mbi dhe dhe në ndonjë shesh o ndonjë qoshe udhe, nuk shihnje tjetër përveçse libra, revista, gazeta italiane. Po libri shqip? Edhe ay i gjori kishte humbur. Po t’a donje në ndonjë librari, duhej ta kërkonje vetë, të futur në ndonjë kënd të errtë, të lënë në fatin e tij të zi, mbuluar nga pluhuri dhe nga merimëngat. Afër tij çu ku gjenje edhe ndonjë libër frëngjisht, nga ata të lirët, të çngjyrosur, të bërë si mos më keq. Dhe dukeshin shokë të shkretë, të mërguar, që i qanin hallet njëri-tjetri.

“Po sot? Sot, kur kalon udhëvet, ndryshej të shëkon libri shqip. Fëtyra e tij sikur është e qeshur dhe ka marrë sërish krenarinë e parë.

“Hej! Pa shiko si jam tashi! të duket se të flet. Vëndi im se vëndi im! E zura prap fronin. Malli im mall i vjetër! Në çfarë zemre nuk buçet!...”

Ky që flet kështu, pak arrogancë, është libri i ri, ay që porsa lindi dje. Dhe kështu na janë këta të rinjt, sapo lindin duan të urdhërojnë! Duhet dorë e plakut që t’u a përmbledhi pak. Dhe libri plak është atje pranë për t’a qortuar: Libri plak, ay që ka tepruar nga shokët e lashtë, i humbur, i harruar një herë, ka dalë përsëri ndër vitrina. E ka ngjyrën pak të zbehur, në krahasim me shkëlqimin e librave të rinj. Por kjo I ka hije. Duket kështu si një bujar i lashtë me fjalë të matura e të rënda. Në mes të gjithë atyre libravet të rinj ti nuk sheh më tepër se një, e shumta dy libra të vjetër .Por janë mjaft për të mbajtur rregullin...”

Dashuri për librin! Ngjarje me të vertetë e jashtëzakonshme për ne! Ishte një here një dëshirë. Sot është një punë e sosur. Të bëhet zëmra mal kur sheh popullin kështu t’e tur për këndim. Mjafton të hyjsh në një çfarë do librarje e do t’a vështrosh me sytë e tu. Kur kanë qenë libraritë kaqë të mbushura me njerz e me libra? Kur ka pasë kaqe popull këndonjës? Flas për rendin mesatar të popullit, për atë që nuk di italisht ose një tjetër gjuhë të huaj por që don të këndojë. Isha vetë këtu e nja dy javë më pare në një librari dhe po vështronja si shiteshin librat. Erdhi më pare një burrë i pjekur, jo intelektual, dhe diçka bleu: pas tij dy studenta kërkuan shqipërimet e Nolit: “Po “Kasollja” kur do të botohet pyeti njiri librarin. I qeshi fytyra kur mori vesh se do dilte për së shpejti. Erdhi dhe një vajzë e re më vonë, që hyri me vrull dhe pyeti me zë tël artë: Ç’libër të ri kemi sot? Dhe kur ai i u përgjigj, me buzë në gaz se për atë ditë nuk kishte liber të ri: “Oh, sa keq! A të vij pra nesër?” Zoti B. më tha pastaj se ishte një punëtore.

“A s’është për t’u gëzuar? Kjo thirrje «O sa keq!», e dalë përnjëherësh nga zëmra e një vajze shqipëtare kur nuk gjen një libër të ri që pritte. Është urimi më i miri për fatin e librit shqip.”

Kët letër m’a shkruen një shok ma i ri.

I përgjegjem.

Libri shqip, po thonë ka fillue “me lulzue”. E ndrydhun për një kohë të gjatë, mendja prodhuese shpërthei sa gjeti rasën e parë të

volitshme. U fillue me librat, u vazhdue me revistat, po ndiqet sot me gazeta e revista të reja. Nuk mbahet mend një periudhë në të cilën shtypi të ketë pasë kaq përhapje.

Dy gjana për t'u shënue në lidhje me "lulzimin" e librit e të shtypit përgjithsisht: ky lulzim asht i tillë sa shpejt do t'arrijë në një sipërprodhim. E dyta: ky lulzim asht vetëm pjesisht i tillë, madje ma tepër asht një iluzion lulzimi. Po spjegohem. Në rasen e pare mjafton me ba një statistikë rreth libravet të botuem gjatë tre muejve të fundit. Ky numër asht jashtzakonisht i madh në krahasim me çfarëdo periudhe tre mujore të vjetve tjerë. Në kta tre muej asht prodhue sa për tri vjet prandaj. Me një farë nguti u mbush shpejt e shpejt mungesa e vjetve të vorfën në prodhime letrare. Por ky hov po vjen tue u shtue gjithnji. Sot janë lëshue të gjithë me botue. Shpijat botuese kan rifillue veprimtarinë e tyne ma me zell se kurr. Tjera kan dalë qi kanë vu në lëvizje letrarë e tipografina. Kto të fundit janë vazhdimisht të zanuna me punë: Ka ardhë koha me ba mik pronarët e tyne për me t'u shtypë libri. Nuk po flasim për çmime! Dhe sa për letrarë, edhe ai i kategorisë së tretë ka gjetë punë (ai ma tepër, dyfish, trefish se të tjerët.) Problemi i botimevet ka sjellë mbas vehtes problema tjerë, teknike e ekonomike. I parë ndër ta, ai i letrës qi ka e nuk gjindet, e kur gjindet, shitet me çmime hiperbolike. Vala e botimevet, e nisun kështu nga tryeza e shkrimtarvet, e bajtun ndër zyrat e botuesavet, e derdhun ndër zhurmat e makinavet të shtypshkronjavet dhe këndeje e shpërndame, nga magazinat e tregtarvet ndër vetrinat e lbrarvet, përban një rrjet të gjanë pune qi bjen shpejt në sy në vendin t'onë të vogël.

Kjo frenezi botimi (asht fjala e drejtë kjo) do të kalojë si çdo frenezi. Edhe për do kohë, derisa llogarija nuk asht ba ende, ky hov do të vazhdojë, madje edhe mund të shtohet. Por do të vijë një ditë qi tregu shqiptar do të jetë plot me libra. Libri nuk do të shkojë ma: Nuk do të ketë njerëz të mjaftueshëm për t'i ble. Pse nuk do të ketë njerëz të mjaftueshem për t'i ble. Pse nuk do të jetë e mundun me i lexue. Libri asht edhe ai një send ekonomik, prodhimi i tij rregullohet mbas ligjvet të përgjithshme t'ekonomis. Kur ka shumë libra në treg, një pjesë e tyne nuk lexohet. Myket pra më ndonji skutë dyqani e

ndoshta edhe shitet me peshim, letër për fushekë gështenjash. Këtë fat e kanë ma tepër librat e këqij: Se ata të mirët, heret a vonë, shiten gjithmonë. Qe çka parashifet lehtaz tue vrejtë ritmin e prodhimevet letrare: mbas krizës së mungesës e të shterpësis do të vijë një krizë sipërprodhimi. Dami këtu asht thjesht ekonomik: e pson jo populli por botuesi. dallojmë se dam pëson edhe populli: Frenezija e botimevet prodhon libra të mirë e libra të këqinj: ma shum të këqij se të mirë. Botohen libra veç për me fitue. Fiton shkrimtari, fiton botuesi, fiton tipografi. Asht koha kur libri sjell fitim! O burra! Të rrokim pendat! E bijnë atëherë veprat, si kërpurdhat mbas shiut! Përkthimet marrin dhen. Kush asht ai qi nuk njef një drejt gjuhe moderne? E kush asht ai i marrë qi nuk përkthen ndonji send? Un, fjala vjen kam pasë përkthye një herë e një zaman, ndonji romanx a roman, nga ata qi të bajnë me notue nëpër lot e psherëtima ase qi ti turullosin trutë a t'i verbojnë sytë me thesare të gjetuna më ndonji ishull midis deti. E marr, e daktilografoj shpejt e shpejt dhe e çoj te ndonji botues qi e dij se s'i ka fort hundët e holla (gjindet ndonji sish pa hall!) Një orë pazarllëk, e puna ka mbarue. Kam futë në xhep njëzet a dyzet lëpushka, simbas trashësisë së volumit, dhe jam këthye në shpi, sherbez! (E jemi te shënimi i dytë.) Duhet me thanë se një pjesë e madhe e prodhimit letrar, të kohëvet të fundit asht i ktij malli kallëp. E këtu nuk hyjnë veç përkëthimet, si ato të kallëpit të masipërm. Por edhe ato t'ashtuqejtunat origjinale. I ke pasë ba do bejta dikur qi ti vetë i ke harrue. Vrap gjeji ku i ke, mblidhi e botoji! Veniu ndonji titull "original" o s'paku "tërheqës"! Të mos kesh kujdes ma gjatë. Libri shqiptar shkon! Një tjetri, tue dalë gjumi befas, majmun kopilan, i bjen ndër mend për do novella, "trafiletti" a letra t'ambila qi ka pasë shkruar asi zamani kur e kish kapë "spleeni" a por edhe sevdaja. Dy tri "ritocchi" e qe volume asht gati. E boton, i shitet. Urra! Libri shqip shkon! Asht koha e grafomanvet. Filani ka pasë marak me shkruar gjithmonë drama e romana. Qysh i ri e kish ba të përmendun vedin për këso marrifetesh. Veç çka? I vorfën i shkreti! Por tash i ka ardhë dita. Shtypi asht i lirë. Mjafton sa me ia nisë, se mandej fitimet janë me thes! Ndonji mik gjindet për sherr, qi ia uhan do pare (kur nuk asht aq budall sa mos me ia marrë shpin a rrogat

peng!) Shkon, shkon libri shqip! Pak reklam! E mos druej! Për një muej shiten dymij copë!

Frenezija e botimit dërmon veç stocket e letravet të caktueme për letërsin e këtij kallepi (medet për atë letër qi po gjindet aq zor!) Ajo prishë edhe veprat e mira. Nguti asht gjithmonë i damshëm. Mund të vrehen në ma se një prej veprave të shënueme të kohëvet të fundit “kusuret” e rrjedhuna nga nguti, nga dëshira e fortë m’e pa veprën të dalun në dritë sa ma parë.

Kuptohet tash pse u tha që në fillim se ky lulzim i librit shqip asht një iluzion lulzimi, ma tepër se sa një lulzim i njimendët. Sa për vedi, do të dojshe ma fort një vepër të përsosun se sa njëqind mesatare, një vepër të përsosun ma fort se... Por çka po thom? Të dobtat a janë kurr për t’u dashtë? Por populli këto libra shef, kto libra blen: Dhe sa pare ban të reçojsjsh e të cilsojsjsh kte ase at vepër të mirë a për të keqe! (Reçensime? bre se ç’po dalin në mejdan për çdo ashik ka një kritik, për çdo shtyllë ka një hyll!). Populli asht naiv e gënjehet: ma tepër se “Hamletat” e “Makbethat” atij i pëlqejnë “Urat e psherëtimave”, “Prandverat e vdekshme” e romanet e verdha! Në paç marifet me u a zhigatë ktyne të mbramevet edhe ndonji figure (kinse me i lustrue!) ose edhe ma mirë, ndonji surrat me ngjyra, e ke fitue davan. Pse libri shqip shkon! Shkon, zotnij, atëherë ma tepër se kurr!

Po si me ia ba pra? Me i a lanë fatit?

Le të përpiqet shkrimtari, me sa t’i vijë për dore, me fjalë e me këshilla, me reçojsime e me kritika, t’a edukojë ndjenjën e artit te populli, t’a ngrejë popullin. Të hajë çka të mundet e sa të mundet. Por përpara të gjithavet të marri përgjegjsina ay vetë tue mësue me shembullin e vet. Vetëm në kët mënyrë, letërsija shqipe do të mund të trajtohet.

Letërsija shqipe ka nevojë për dinjitet.

(“Fryma”, nr. 4, 1943, ff. 151-154)

Poetika e fëminisë

Hyrjen e kësaj trajtесе për poetikën e fëminisë sime do ta sintetizoj me dy fjalë para se të paraqes ata rrëfime e atë botë njerëzore, të cilët i ruaj gjithëherë të paharruar në mendjen e në zemrën time: Fëminia ime dhe lotët e mi të brishtë, rrinë ende fshehur në atë rrugicë në Shkodër që atkohë mbante emrin “Badra”. Mua më dukej emri më i bukur në botë, por disa thonin se ishte thjesht emri i një barishtjeje të egër. Gjithsesi Badra ime nuk kish si të ishte e egër anipse pjesë e hidhur e jetës sime ka qenë.

Gjithçka në kujtesën time mbi rrugicat e fëminisë në qytetin e Shkodrës nis me 14 korrikun 1951, ditë kur im Atë mbylli sytë përjetë. Isha vetëm 5 vjeç, në moshë për ta ndjerë dhimbjen, por tepër i vogël për të kuptuar tragjedinë. Ishte një ditë që ka mbetur pezull në kujtesën time. Vinin në këtë rrugë me qindra fshatarë nga Hoti i Ri e Gruda e Re, nga Kastrati, Postriba e Gruemira si dhe qytetarë nga Shkodra. Shtëpia jonë ishte me dy kate dhe mbaj mend se trupin e babait e vunë në dhomën e mirë, në katin e sipërm, por aq të shumtë ishin njerëzit sa që dikush sugjeroi ta zbrisnin trupin në katin e parë, sepse shkallët e drunjtë mund të përbënin rrezik për ata që hynin e dilnin për homazhe. Mbaj mend nëpër kujtime përvëluese fëmijërie, se atë ditë shumë duar kaluan nëpër faqen time, mbi ballin dhe flokët që m’i qethnin shkurt, e kjo më bëri të shkrehesha në vaj. Kur kaloi nata dhe erdhi e nesërmja, 15 korriku, u shpëtova atyre që përkujdeseshin dhe dola në oborrin e madh ku njerëzit po nxirrnin në krahë trupin e babait. E çonin në Fushë të Rrmajit dhe unë iu vura pas kortezhit. Duke folur me fëmininë time e duke pyetur, pse mua kaq i vogël duhej të më vdiste baba, por, eh,... kurrkush nuk më përgjigjej. Ishin të zënë, hidhnin mbi të dheun e zi, në atë varr ku është edhe sot e kësaj dite, të cilin e rreh trishtueshëm herë murlani e shiu dhe herë-herë dielli përvëlues i Shkodrës. Në atë mes korriku çdo gjë u ndërpre - mbeti veç ai varr ku kam vajtur me qindra herë në fëmini, në rini dhe më pas. Ngeli ai varr si një muranë që lidh kohën

e tij me kohën time. I vetmi kujtim, e vetmja lidhje.

Po kisha Dadën time Katrinë e për mua kjo do të thoshte gjithçka. Ishte italiane me atësi, dije e kulturë, por në karakter - shqiptare. Ajo më mbulonte çdo mbrëmje kur më zinte gjumi, ma hiqte lehtë librin nga dora dhe bënte kujdes të vinte një shenjë në faqen që kisha lënë përgjysëm. Ishte e bija e Motrës Tone Idromeno(Skanjeti), Xhokonda shqiptare, për të cilën më fliste shpesh, kish mbet jetime nga nëna shumë shpejt. Ishte mbesa e Kolë Idromenos dhe gruaja e tim eti. Kaq shumë isha i lidhur me Dadën Katrinë si ajo lule dorëzonja që ngjitej nëpër muret e avllitë e oborreve shkodrane, po edhe ajo tek unë kish derdhur të gjithë dashurinë e zemrës së saj.

Dada Katrinë, ajo nënoke e dashur dhe fetare, me vel të zi mëndafshi - që shkonte herët në orët e mëngjesit në Kishën e Madhe ku predikonte nipi i saj Dom Ernesto Çoba (i vrarë ky më pas në burgjet e diktaturës) - ishte një histori e gjallë, qoftë me jetën e saj, qoftë me çka dinte e tregonte. Më tregonte për kandilët e mëdhenj në të cilët kishte mbajtur të fshehur flamurin kombëtar - të Skënderbegut - se kështu i thoshte.

Por, erdhi një kohë që mbeta edhe pa dashurinë e saj. Pas një operacioni diletant në spitalin e Shkodrës, kirurgu (emrin e të cilit nuk dua ta përmend, sepse nuk jeton më dhe ai), që ia kish lënë operacionin studentëve, tepër vonë e pa se ishte një diagnozë e ndërhyrje e gabuar e fatale. E operuan për të dytën herë dhe ajo nuk duroi. Nisi të shuhej ngadalë. I thanë që duhej të më lajmëronin mua në Tiranë (isha në shkollën pedagogjike) por ajo u la amanet: *“Kurrresi! Eshtë kohë provimesh, do të dali mësuës. Edhe po të vdes, mos i thoni. Kur të vijë në Shkodër, mos harroni të ma sillni në Rrmaj te vorri, ta shoh, se ka shumë mall Dada për djalin!”*

Mbylli sytë, ata sy të bukur e inteligjentë që kurrë më në këtë botë nuk do t'i shoh. M'u shua dhe një dritë shprese, u shtua edhe një dhembje që kurrë nuk mund të shuhet, anipse jeta vazhdon tej e përtej vdekjes, as njëmijë vdekje nuk mund ta ndalojnë vazhdimin e saj. Kur erdha në Shkodër e kishin varrosur. Shkova në Rrmaj, ku varri ishte ende me dhé të freskët. E kishin futur në një varr me babain. Ata ishin sërish bashkë, sërish dhe përjetësisht. Të nesërmen

trokita në derën e trashgimtarëve të Jakë Zorbës dhe tezes Milenë, nënës së poetit Zef Zorba, motrës së Dadës Katrinë sepse aty kishte kaluar ditët e fundit të jetës. Shtëpia ndodhej diku pranë vilës së Doktor Prelës dhe Kishës së Fretënve, por vajzat e Tezes Lenë, më thanë se nuk kishin asgjë. *“Po ndonjë fotografi, - u thashë, - ndonjë letër a ka lënë, ndonjë relike familjare a diç tjetër?”* *“Kurrëgjë, - më thanë, - kurrëgjë!”*

Ma prenë shkurt e nuk kish farë kuptim të rrija, aq më tepër, krejt kot po përpiquesha ta fshihja një pikë lot prej 16-vjeçari që më tradhëtonte. E këtë para tyre nuk e desha. Kisha patur në jetën time dy njerëz të dashur prej të cilëve nuk më kishte mbetur asnjë gjurmë, asnjë fotografi, asnjë relike e kjo më dukej një fatkeqësi akoma më e madhe. Një plagë që nuk dija si do ta mbyllja. Më dukej si një varr i hapur, por tashmë jo në Rrmaj, por në shpirtin tim.

Tejet vonë, kur kisha mbaruar universitetin për gazetar e kisha dalë në jetë, aty nga viti 1982 në Fototekën “Marubi” gjeta fotografinë e saj bashkë me tim Atë. Ishin të rinj e të bukur. Më dukej se tashmë i kisha pranë e nga thellësia e shpirtit u thashë: *“Dadë, kërkova veç njërin e ju gjeta të dyve, e, për besë,... tashmë kurrë nuk do t’ju humbas!”*

Koha e solli të kem edhe unë Odisenë time nëpër botë, që poetikisht e quaj Trinia ime, të kaloj dete dhe oqeanë e që nga Athina e kupës së helmit të Sokratit të prek ëndërrimin e gjithë botës, Amerikën. Tanimë e kam edhe një shtëpi tjetër në atë vend. E gjithëherë kam kërkuar ta marr me vete atë fëmijëri që ka sinonimin e Badrës, por edhe të pëllumbave të shumtë që mbaja atbotë, por nuk munda. Sepse fëmijëria jonë nuk mund të ikë kurrkund përveçse aty ku ka përgjakur gjunjët duke hedhur shtat e duke u rritur. Fluturimet e pëllumbave të fëmijërisë sime të rrugës Badra kanë mbetur si mirazh në qiell, në kujtesën e ajrit, kaltërsive, ndërsa gjurmët e hapave të mi, si grimca të vogla në pluhurin e rrugës, në relievet e shtëpive, ca prej të cilave të rrënuar e me mure mbuluar me myshk.

Fare pranë shtëpisë time të fëmijërisë gjendej shtëpia ku kishte jetur poeti i pushkatuar Lazër Shantoja. Ajo kishte një oborr të madh dhe në fëmijërinë tonë losnim në barin e gjelbër, Atje kishte shumë

lule por binin në sy marshallojat dhe një lule dorëzonjë. Kur botova një antologji me vjersha nga poetët që nuk jetojnë më të parin vura Dom Lazër Shantojen me poezinë e tij “Dy lule”. Atë botë nuk e kuptoja se poezia do të ishte dashuria më e madhe e jetës sime dhe lule dorëzonja do të më shfaqej aq shumë e përgjakur.

Shtëpia me ngjyrë tullë që edhe sot e kësaj dite qëndron në këmbë dhe e fortë, ishte e familjes së Zef Çarkut që rregullonte çadra dhe e të birit Çirilit. Nuk e di çfarë bëhet me njerëzit që dikur jetonin aty. Në vazhdim e shtëpia e Gurazezëve, Kolës biçiklist dhe të birit Rozarit, si dhe Ernest Guraziut e të bijve, Jakobinit e Rudolfit, të cilët mbanin gardalina që e mbushnin tërë lagjen me cicërime të gëzuara e kur dikush hapte radion, ato i shtonin cicërimat më shumë.

Diku ngjitur me ta ka jetuar familja Plumbini, i njohur ndër ta Viktor Plumbini, futbollist i “Vllaznisë”. Përballë Gurazezve ka qenë shtëpia hijerëndë e Rrok Shahinit, të bijve të tij Gjonit e Kolës (traktorist i njohur ky i fundit). Tashmë kjo familje është shuar. Në shtëpinë e Shahinëve shpesh vinte mik Maqo Çomo, që ishte ministër bujqësie dhe sillte me vete edhe dy fëmijë të vegjël. Njëri nga ata ishte një vogëlushe sa një kokërr mollë. Në fëmijët e rrugicës Badra e shihnim me kërshtëri atë njomzake Tirane, që tash e njohim të gjithë me emrin Drita Çomo, poete me fat tragjik. Në shtëpinë e tim eti, mbaj mend se jetonte një familje ku unë shkoja shpesh, ishte Pjetri, një malësor i vjetër dhe i urtë që rrinte buzë oxhakut (më kujton kompozimin e Kol Idromenos “Plaku nga Postriba”), e shoqja më një emër që më habiste Sose dhe vajza e tyre Roza, shoqja ime e shkollës, por e veçanta ishte se kishin një djalë që hodhi shtat në shtëpinë e tim eti e që tashmë është bërë legjendë për sportin shkodran, volejbollisti e trajneri Mark Grimci.

Në këtë rrugicë ka jetuar edhe babai i Çesk e Tonin Zadejës, Rroku, rrobaqepës. Të parat pantallona në adoleshencë mi ka qepur ai. Pranë tyre jetone familja Zojzi dhe Mjeda, Kol Mjeda kishte vdekur në burg të Burrelit dhe vetëm pas viteve ‘90 mundi të kishte një varr në Rrmaj. Në shtëpinë Zojzi jetonte mësuesi im Kol Alimhilli. Ishte hollak i gjatë, i heshtur, i vetmuar dhe lëshonte fjalë idhnake sepse nuk ishte i kënaqur me gjërat që ngjishnin rreth e rrotull. Një vëlla,

Ton Alimhilli, e kishin vrarë nazistët në Kampin e Përqëndrimit në Prishtinë. Mësues Kolës ju fik zemra duke pirë kafënë e mëngjesit në Kafën e Madhe. Për të kam shkruar poezinë “Cokla” një rrëfim meditativ fëminor për bjerrjen e gegnishtës. Përballë tyre jetonte një armen, Agopi, që mbante një dhel për në shtëpi dhe kur njëherë i ra zjarr, ai e kish mendjen të shpëtonte dhelprën e asnjë pasuri tjetër para saj. Diku më lart shtëpia e Serreqëve, të njohurit profesor Tish Serreqi, që kishte një nënë italiane të mrekullueshme (më bëhet me emrin Xhulia), e cila punonte në spital e sa herë vinte nga puna takonte Dadën time Katrinë. Bisedonte me të e i jepte për jetimët - ishte fjala dhe për mua - ndonjë rriskë bukë gruri që ishte një lumturi për kohën kur populli ushqehet vetëm me bukë misri. Mirënjohje për atë nënë!

Më tej vinte familja Dema, ngjitur ajo Ndoja ku është rritur aktorja e njohur Ema Ndoja. Përballë ishte familja Gora e suflerit të njohur të teatrit Ndoc Gora dhe e plakës Syn Perja. Mur në mur ishte familja gjakovare Dionizi, me një djalë të arratisur. Mbaj mend se aty vinin dy motra nga Tirana, të bijat e Gjon Dionizit, njëra quhej Eda, ndërsa tjetra që nuk ia mbaj mend mirë emrin, dogji veten me benzinë në Tiranë, sepse mbeti në një provim në Universitet. E sa pikëllim ra atbotë në rrugicën tone për vajzën e bukur të Gjon Dionizit.

Çfarë trishtimi sjellin kujtimet! Në krye të rrugës në një shtëpizë të vogël si një jerevi jetonte një profesor i madh edhe me trup, edhe me emër, Kol Ashta. Konsiderohej më i madhi i plejadës së gjuhëtarëve në Shkodër. Por ai gjuhëtar e mësues i madh nuk la trashëgimtarë e pastaj gjërat derivojnë përkah harrimi. Kush flet sot për Kol Ashtën? Askush. Nuk e di, por në krye të rrugës nuk e pashë ndonjë pllakë përkujtimore me emrin e tij. A ndonjë emër rruge gjëkund në Shkodër. Ndoshta ka... Por mu bë se dëgjova zërin Profesorit Kol Ashta që më 5 dhjetor 1942 kishte thanë për faqet e gazetës “Balli i Rinise”:

“Mos e përbuz poezinë, pse ajo kundron zëmrat djaloshare ku levizë gjak fisnik, një hov ilir i rí, i vërtyteve shqiptare të pasterta, të drejta, fatosore, qi përfaqsojnë cilsít racore të njeriut shqiptar. Ajo këndon pafajsín, qi bjen pranverën ndër zëmra.”

Ja pra që poezinë e paskam patur në rrugicën time shumë kohë

para se të lindja. E kisha parë sa e sa herë profesorin megjithë zonjën e tij mësuesen Neta dhe nuk e dija në fëmëni se fjalët e tij të arta do të bëheshin pasion i jetës sime. Të mos harroj mësuesen e bukur me biçikletë Dori Shestani, që mund të thoja një poezi në bicikletë... kështu me shfaqet ende sot. Kujtoj kompozitorin Simon Gjoni, nëna e të cilit, Dranja, ishte bijë e hotianit, luftëtar i vitit 1911, Preloc Prek Peci dhe kish dalë nuse nga shtëpia e babës tem në këtë rrugicë.

Pak më poshtë nesh ka qenë një shtëpi me oborr të madh, në të vërtetë ishin disa shtëpi brenda atij oborri, e aty pranë derës rrinte gjithnjë një plakë fort e moçme, e gërmuqur me emrin Mrikë, që kishte veshje mirditore. Shpesh ajo fshihej prapa derës e shihte për plasash. Plakat e tjera të lagjes tregonin njëhistori të tmerrshme për Mrikën. Ajo ishte lindur në Shkodër e qe martuar në Mirditë e atje i shoqi i kish vrarë të vëllain që kishte ardh për të bujtë. Ajo për hakmarrje e kishte vrarë burrin e vet me spatë ndërsa flinte. Ne nuk e besonim se Mrika e kishte bërë këtë vrasje, por ajo kishte një fytyrë e vështrim të ftohtë e kurrë nuk buzëqeshte ndaj ne, fëmijët e Badrës, e kishim frikë.

Vite më vonë kur kam lexuar “Bardhën e Temalit” të Pashko Vasës, botim i Rilindjes Prishtinë, mendoja se plakat e lagjes e kishin sajuar atë histori pasi kishin lexuar romanin në fjalë. Por jo, romani ishte shkruar në frengjisht e botuar në Paris më 1890. Ku dinin plakat e lagjes sime të lexonin frengjisht që ta mbartnin këtë histori tek Mrika. Por e kundërta edhe mund të kish ndodhë. Pashko Vasa ta ketë dëgjuar historinë e Mrikës e cila kur është shkruar romani mund të ketë qenë rreth të njëzetave. Ndoshta.

Plot enigma të tilla kishte rruga e fëmijërisë sime Badra. Kujtoj familjen me emrin e fshatit Barbullush dhe shoqen time të shkollës me emrin që më tingëllonte si kryeqyteti kuban, Havajana. Apo dhe familjen e vëllezërve Zef e Pjerin Baba. Më bënte çudi ky mbiemër, por edhe mbiemri i pijeshitësit Kol Kamdruni gjithashtu. Fare pranë shtëpisë sonë rrinte Nore Kolja, e reja e Ded Gjo Lulit me Katrinën e Luc Nishit, e bashkë me ta disa kohë ka ndenjë mësuesja Lena Lek Luli, gruaja e Gjelosh Lulit, të vrarë nga komunistët, saqë thonë i kishin prerë kokën nipit të Ded Gjo Lulit. Mësuese Lena jetonte me

vajzat e saj të bukura si dritë, Klara e Bela, me të cilat luanim në fëmijëri. Pastaj ikën se i internuan.

Aty pranë tyre jetonte familja e Mark Gjekës, me bijtë Lec, Lin e Anton Gjeka dhe bijën Vitore, martuar tek Rashajt. Rita Gjeka, aktorja, sot drejtoreshë e Teatrit “Migjeni”, vajza e Lecit, asokohe ishte një vogëlushe lojcake. Ngjit me shtëpinë e tim eti lartonte shtëpia e madhe e Cin Daisë që zinte kryevendin. Ishte si guri i unazës së rrugës sonë. Cin Daia, mjeshtër marangoz që kishte një punishte zdruktharie të madhe në katin e parë, ishte babai i kompozitorëve Tish e Tonin Daia. Mbushnim ujë në një pus të përbashkët. Pranë pusit kishte një man ku hipja gjithë verës për të ngrënë mana e për të parë sa më larg të qe e mundur. Dada Katrinë më thoshte se Kol e Tuk Jakova kishin kaluar fëmininë në këtë rrugicë, dy shtëpi afër asaj të babait tim.

Në fëmijërinë time ngjarjet zhvilloheshin si në një film që shfaqej vetëm një herë. Ish koha kur botën e masja së shumti me faqet e librave, me fluturimin e pëllumbave të mi, me fantazinë e lirë e të përflakur. Në lartësitë e degëve të manit ëndërroja sikur isha një fluturak i madh i qiellit. Ndoshta ai man m’i dha udhët. Më bëri një harrakat të vogël me dëshirat e ikjeve të largëta. E megjithatë fëmijëria ime mbeti aty. Aty ku ka kaq shumë emra e kaq shumë njerëz e kaq pafund dashuri, përzier bashkë me dhembje. Në të vërtetë edhe kthimi në kohë nuk është pa trishtim anipse na ndihmon në artin i krijimit.

Gjithsesi kjo është një botë fëminore të cilën nuk mund të mos e tregoj, nuk mund të mos i kthehem, përndryshe do ta ndjeja veten pa identitetin e dinjitetin që më dha kjo rrugë. Mësimi që nxjerr nga poetika ime e fëminisë është se arti ashtu si liria fillon nga kujtesa. Kjo kujtesë në rastin tim, sa herë e gërvish buron dhembje dhe atje ku ka dhembje ka art. Përmënda emra njerëzish të cilët përbënin ngjizjen e ngjarjeve të fëminisë, gjithnjë me mendimin që të vdekurit e mi janë gjallë, dhe kjo është e vërteta poetika pa të cilën nuk shkruaj dot as dhe një varg. E për më tej, në fushë të letrave e të meditimit, poetika ime më së shumti nuk është kurrgjë tjetër veçse kthim me fytyrë nga fëminia. Poezia ime është Trinia ime, që prej rrugicave të fëminisë

ka ardhur dhe atje kthen pafundësisht, pa mundur kurrë të shkëputet prej tyre.

Dhe të mendosh se rrugica ime e fëminisë u quajt që në atë kohë me emrin e lirikut të madhërishtëm Filip Shiroka, ndaj, pasi ua rrëfeva këto ngjarje e këtë botë njerëzore, besoj se nuk lind nevoja të pyesin edhe më tej, se kush të bëri poet.

Shkodër, 22 tetor 2016

Nji motiv i përbashkët mes Mehmet Ali Pasha dhe Të shtatë kralat rrehin telin

i. Tekstet përballë njeni tjetrit: mëvetësia tekstore

Kanga *Mehmet Ali Pasha*, që asht pjesë përbamëse e *Lahutës së Malcís*, - e renditun si e dheta në variantin përfundimtar të 1937^s dhe e cila gjen botimin fillestar në “Hylli i Dritës” më 1923,²- do të krahasohet për nga pikëpamja strukturore e për nga veçantësia e secilit tekst, me kangën popullore që përfshin këtë ndodhi të Gjakovës. Teksti i kangës, që gjendet në repertorin e kangëtarit Qamili i Vogël-Muhaxhiri³ dhe mban titullin *Të shtatë kralat rrehin telin*, do të përqaset me produktin fishtian tue u përpjekë që të dallohen njikohësisht edhe elementët fikcionalë e historikë.

Kanga *Të shtatë kralat rrehin telin*, i përket fondit tonë tradicional të kangëve dhe asht këndue nga shumë rapsodë të ndryshëm. Vlen të përmendet këtu varianti i Dervish Shaqes,⁴ i cili në krahasim me atë të Qamilit të Vogël ka diferenca të konsiderueshme tekstore, por gjithsesi ato mbërrijnë në një përqindje krejt të vogël. Po ashtu kemi variante të Bajrush e Hajdar Dodës, Hysen Ukës e shumë të tjerëve - qofshin edhe variante të vona. Tue u nisë nga serioziteti që kërkon puna, kemi parapëlqye variantin e kënduem nga Qamili i Vogël, meqenëse e kemi edhe të botuem si tekst. Në qoftë se tek *Mehmet Ali Pasha* dimë kohën e krijimit/botimit nga Fishta, tek *Të shtatë kralat rrehin telin*, nuk e dimë kohën kompozionale për shkak se asht shumë e vështirë të përcaktohet koha e lindjes së një kange, siç na thotë edhe Ernest Koliqi “*shumica e kangëve léjné gand dhe áshit e vështirë, në stinën e lulëzimit të tyne të plotë, me gjetë autorin e bërthamës së parë të vargjeve*”⁵, sepse kangët popullore (rapsoditë në rastin

2 *Mehmet Ali Pasha*, një epizod prej vepret ‘Lahuta e Malcís’ A. Gjergj Fishta O. F. M., HD vjeta IV, gusht 1923, nr. 8, ff. 361-373.

3 *Lule gjaku, këngë popullore nga repertori i Qamilit të vogël. (Të shtatë kralat rrehin telin)*, Prishtinë, 1975, ff. 13-14.

4 Vrej: http://www.youtube.com/watch?v=S3_jiS-9Gsc.

5 Ernest Koliqi, *Sprovë letërsie shqiptare, Vepra 4, (Si lén në Shqipni një kangë popullore)*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 68. Përkthye prej italishtes e pajisë me

tonë) lindin në mënyrë të vetvetishme, nxitun nga rrethanat historike, lindin e rilindin madje, tue u krijue në të mbishtresimi artistik ngaqë ato përçohen gojarisht brez mbas brezi. Pra, ajo (ri)merr identitete të ndryshme strukturore tue kalue në procese të ndryshme shndërrimi derisa ka një fazë përfundimtare, e cila mund të quhet *ngurtësimi tesktual* dhe respektohet nga të gjithë si variant definitiv. Kjo gja ka ndodhë me variantin e sjellë nga Qamili i Vogël, tekst i cili asht rimarrë thuajse pacenueshëm nga kangëtarët e tashëm. Po të ndalemi rishtas te Koliqi, e të bazohemi tek përvojat e tij në Mertur, sa i takon zbulimit të zanafillës së një kange popullore do të shohim se sprovat për një gja të tillë janë të parealizueshme, ngaqë ai pohon:

Mâ vonë u binda se një kangë popullore nuk lén përnjiherë, por herë mbas here; venitet e bje, mandej e merr veten: zakonisht lén përsëri në secilën gojë që e këndon. Kanga që mbërrinë kulmin e persosunisë, mbas gjumesh të randa e zgjimesh, pranohet që të bahet pjesë e palës shprehëse kombtare, e kristalizueme në një trajtë që në njëfarë mënyre mbetë e pandryshueme, sepse të gjithë, gati në mënyrë bestytse, respektojnë fazën e fundit të shndërrimit.⁶

Tekstet tona të marra në analizë, janë përballë një ndodhie në Gjakovë, ku funksionari i Portës së Naltë, vjen tek kulla e Abdullah Drënit për të kumtue atë çka ishte miratue në Berlin. Domethanë jemi përballë një fakti historik, që ngjau në kohën e Lidhjes së Prizrenit. Mirëpo teksti fishtian daton plot 45 vite mbas ngjarjes gjakovase dhe përfaqet si tekst letrar që ka një lidhni të caktueme me tanësinë e veprës, në të cilën ajo (kanga) ban pjesë. Por gjatë këtyne pesë dekadave pothuej, domosdo që kanga e këndueme nga Qamili ka pësue ndryshime strukturore derisa së fundmi ka këtë variant, që del në botimin e 1975^s. Për rrjedhojë, autori i parë ka kalue në **anonim**, teksti fillestar ka marrë trajta disadorëshe deri kohën që asht këndue nga kangëtari në fjalë, apo edhe të tjerë të cilët i përmendëm. Fjala

shënime nga Willy Kamsi.

6 *ibid.*, ff. 59-60.

vjen, lidhun me këtë ngjarje, gjejmë edhe kangë të mbledhuna nga Prensushi qysh në 1911 në *Kângë popullore gegnishte*, e që e kemi të përmbledhun në *Visaret e Kombit*, vëllimi I, me titull: *Vrasja e Mehmet Ali Pashës (Gjakovë 1878 - K. P. G.)* e që ka këto 10 vargje: “*Krisi pushka, gjimoi toka: / Kujton Pasha [Mehmet Ali Pasha] se janë topa. / Nuk janë topat e Vezirit, / Janë martinat e Inglizit, / Qi anë për anë ia qesin zidit [sllav. mûr]⁷/ Qesin zidit anë për anë, / Ja u pá sherrin Turk e Fanë*. / Turk e Fanë ja u pá sherrin: / Ahi, i mjeri Abdullah begu! / Vetë ka mbetë për saraj të djegun*”⁸. Tekste mbi vrasjen e pashës, mund të ketë në shumë variante të ndryshme, që kanë shërbye si tekst i destinuem për këndim. Me instrumente të ndryshme, kuptohet. Përtej ekzekutimit me lahutë. Me një fjalë, teksti nuk asht i përshtatun vetëm për monokordë por edhe çifteli e sharki. Apo qoftë me shoqim firzamonike, dajreje, fyelli etj.

i/a. Identiteti historik i teksteve

Më 6 shtator të vitit 1878, mbas disa ditësh qëndrimi në kullën e Abdullah Drënit, Mehmet Ali Pasha (Maxharr Pasha, i thirrun

7 Shën. në kllapa katrore [] janë shpjegime të nxjerra nga teksti, ku burimi po shënohet në footnote-n vijuese.

* Vargu “... *Turk e Fanë*”, ka kuptimin e turqve - mareshalit e shpurës së tij, por nuk mund të mohohet konteksti as për komunitetin muhamedan shqiptar që ndodhej në kullë, prejse e hasim shpesh këtë emërtesë ndër vepra të ndryshme. Kurse *Fanë* do të thotë: mirditas-fanas, prej Fanit të Mirditës. Në tekstin fishtian asht Oshi i Nuros së bashku me të tjerët (50 Fandë).

8 *Visaret e Kombi*, vëllimi I, Kângë trimnije e kreshnikësh (Pjesë të folklorës së botueme), zgjedhë e komentuem nga Prof. Karl Gurakuqi e Prof. Filip Fishta, Tiranë, Shtypshkroja “Nikaj”, 1937, f. 90. Po ashtu kemi edhe variantin tjetër me titull *Ka një pashë m’e mytë për vjet*: “*Të shtatë krajlat kuvenojnë: / - Prizereni shka po thonë? / Ni murtat na e çoi Dovleti, / Shkoi n’Xhakovë të Avdulla Begi. / Për dy djem ç’i kish mas veti, / Shaqir Agën, Bajram Rustemin! / Krisi pushka tu mejtepi: / Po lufton Avdulla Begi, / Për ç’at pashë ç’i kish ngat vedi. / Çilloi pasha kryçali, / Kish pasë gisht me shtatë krajli, / Lyp hudutin ç’ik n’Malsi. / Çitni futat shpi për shpi. / Shpi për shpi, mahallë n’mahallë, / Bini, djem, ju bajraktarët / Hanm’i pashës del në shkallë: / Kuku sot për pashallarë! / Ç’na u kanë kallë sarajet flakë. / Hanm i pashës seç po flet: /- Rrihnja telin babës mret: / Ali Pashën ç’ta ka xhetë? / Në ni hu te paska metë. / Kështu Shqipnia kish pasë adet; / Ka një pashë m’e mytë për vjet”. Khs.:Rrustem Berisha, *Këngë popullore të rilindjes kombëtare*: http://letersi.com/berisha_rrustem_kenge_popullore.*

nga shqiptarët), që kishte përqafue islamin e që ishte njikohësisht përfaqësues e anëtar i delegacionit osman në Kongresin e Berlinit,⁹ u vra nga shqiptarët pas një lufte të përgjakshme triditore. Tue qenë se pasha nuk ishte largue nga Gjakova, - siç na ban me dije studiuesja turke Bozborra, - simbas këshillimit nga paria jonë, atëherë shqiptarët: “*i vunë zjarrin shtëpisë ku ai strehohej, duke u djegur brenda të gjithë ata që gjendeshin aty së bashku me marshallin osman*”.¹⁰ Pyetjes pse pasha turk u strehë pikërisht në shtëpinë e Drënit, i janë dhanë përgjigje që me Koliqin, i cili mendon se tue mos pasë një ndërtesë të dëjë institucionalisht për të pritë funksionarin e dërguem nga P. O., ai (pasha) gjeti strehë tek Abdullah begu.¹¹ Shkaku nuk ishte vetëm ky. Mareshalin me gjakovasin e lidhte një miqsi e hershme, meqenëse Mehmet Ali Pasha kishte qenë në ushtri¹² me mikun që e priti në shtëpi dhe e mbrojti deri në flijim, për shkak të kodeve kanunore (për sa ofron teksti i Fishtës). Këtë veprim Abdullah Pasha e bani paçka se ishte anëtar i Lidhjes së Prizrenit, por atij nuk mund t’i mohohet roli si përkrahës (konservator) i politikave pro-osmane. Ne, kjo figurë do të na interesojë vetëm në plan artistik, ma saktë vetëm si ravijëzim fishtian. Pra, jashtë identitetit të mirëfilltë historik. Në këtë pikë, me anë të portretit të begut shqiptar, nuk kemi të bajmë me një njeri që bjen pré e korruptimeve apo kompromiseve të ndryshme në favor vetjak. Përkundrazi kemi të bajmë me një njeri që respekton traditën shqiptare. Atë traditë shumëvjeçare që funksionon si kod etnojuridik. Prandej po t’i drejtohem vargjeve të Fishtës, atyne fjalëve të A. Drënit vrejme: “*Veç, po, ’i punë baba m’ ká msue; / Miqt per t’*

9 Khs.: Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, përk.: Dritan Egro, Dituria dhe Shtëpia e Librit & Komunikimit, Tiranë, 2002, f. 172. Khs. po ashtu edhe Koliqin, Ernest, *ibid.*, f. 267.

10 *ibid.*, citue nga Alpan (f. 54), f. 173. Khs. edhe: Joseph Swire, *Shqipëria. Ngritja e një mbretërie*, përk.: Kujtim Ymeri, Dituria, Tiranë, 2005, f. 63. “*Zyrtari fatkeq, Mehmet Ali Pasha, dhe një njësit trupash u asgjësuan nga banorët e fiseve të Gjakovës gjatë rrugës për në zonën e diskutueshme*”. Studiuesi këtu pohon se ngjarja ka ndodhë gjatë rrugës, por në fakt pasha vritet i fshehur në mjediset e banesës së A. D., siç do kemi rastin ta shohim.

11 Khs.: Ernest Koliqi, *ibid.*, f. 267.

12 Khs.: Nuray Bozborra, *ibid.*, f. 173, po kështu dhe Koliqi, *ibid.*

gjallë un mos me i lshue".¹³ Kjo asht përgjigjja që u jep gjakovasi bashkëkombëve të vet, kur *halija* (shtresa e thjeshtë shoqërore, që përfaqësohej kanonisht nëpër kuvende)¹⁴ kërkon të negociojë për dorëzimin¹⁵ e atij *murtati* që e kishte mbajtur në shtëpi. Në mënyrë të përputhtë me *Kanunin e Lek Dukagjinit*, Drëni u përgjigjet shqiptarëve, sepse kushdo mund të falej prej gjakut tand por **miku i prëmëjo!** Atij sidomeqenë puna do t'i lëshohej kryet e vendit, përderisa të kishte ardhë për mik. Bash gjak me të pasë, do t'i thoshe të njëjtat fjalë që i takon çdo miku. Koliqi, lidhur me vendosmëninë e pashës gjakovar, vijon të na pohojë: "*Drëni s'pranoi në mënyrë të préme. Përgjegjën që dha e rrejten kangët popullore të asaj kohë*".¹⁶ Rrjedhimisht me këtë që pohon studiuesi, na duhet të mendojmë se Fishta *Mehmet Ali Pashën* (në vijim teksti A) e ka ngjizë në bazë të kontaktit me kangët e atëhershme e me atë jehonë të ngjarjes që ka pasë ndodhia e Gjakovës, kur poeti i ardhshëm ishte shatë vjeç. Domethanë *Të shtatë kralat rrehin telin* (në vijim teksti B), ka pasë një kompozim të atypëratyshëm, mbase jo me të njëjtin titull, e mbase jo me të njëjten strukturë, për pasojë të variueshmënisë së tekstit, për të cilën folëm ma nalt. Kjo vrehet edhe prej disa leksemave që janë të trashëgueme prej turqishtes, prej të cilave një pjesë janë vetë të mbartuna nga arabishtja e persishtja, si: *murtat*¹⁷ (tradhtar, armik),

13 L. M. *ibid.*, f. 118. Khs. dhe mendimin e Koliqit të dhanë mbas analizës së vargjeve nga Fishta, për betejën e Gjakovës: "*Sigurisht Poeti mendonte se heroizmi i shkapërderdhun për me vulosë shëjtninë e traditave më shembullore etnike nuk duhet mbajtur një humbje e kotë energjie, por një provë e zimjes së instinkteve bujare në gjakun shqiptar*", *ibid.*, f. 273.

14 Khs.: David Luka, *Studime gjuhësore XIV. Magjia e Fjalës te vepra "Lahuta e Malcís" e Atë Gjergj Fishtës*, Shkodër, 2012, f. 115. Po ashtu edhe fjalorin e mbasevendosun të At B. Demës, në botimin gjegjës të L. M., f. 530.

15 Madje edhe Oshi i Nuros i përgjigjet hoxhë Korenicës, si për negociimin si për nocionin e "mikut" që njih kanuni: "*Mbasi as doke s'po isht' n'Shqypní, / Me lypë mikun me pleqní, / [...] / Pse falë nieri tatë e vllá, / Falë të sháme e falë të ráme, / Por jo mikun n'bukë e n'krypë*", L. M., *ibid.*, f. 119.

16 E. Koliqi, *ibid.*, f. 269.

17 Shih: "**Murtat**-i m. mb. [...] Në shqiptet kudo kjo fjalë ka pasë kuptimin e tradhëtarit, të shitun tek i hueji, atdhemohuesi. [...] Tur. **murtat**, **mürtet** "ai që ka mohue islamin tue u konvertue në një tjetër fé, renegat" (< ar. **murtadd** [...]"). Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Instituti shqiptar i mendimit dhe i qytet-

*dovlet*¹⁸(mbreti, pushteti), *memleqet*¹⁹ (krahinë, vendlindje, atdhe), *saraj* (pallat), *azgan*²⁰ (i bashëm, i fuqishëm), *jyzbash*²¹(mareshal, komandant) etj. Nga ky hetim tekstor, shohim se përqindja e fjalëve me prejardhje turke dëshmojnë për hershmëninë e këtij varianti. Janë fjalë që nuk përdorën ma (shumica e atyne të listuemeve) në gjuhën shqipe, përpos qëllimit stilistikor për të ndërtue efekte të caktueme.

ii. Mehmet Ali Pasha vs. Të shtatë kralat rrehin telin: tekstet përballë

Ndodhia e Gjakovës në tekstet A dhe B, ka një shpërfaqje/shtrimje të ndryshme. Kjo asht e dukshme, sepse teksti fishtian ka 400 vargje e ai i Qamilit 44 vargje: pra, pak a shumë teksti A, ka pothuaj dhetëfishin e atij B. Tek Fishta shtrimja narrative, tue qenë produkt pastërtisht letrar, merr fizionomi tjetër. Narratori e përngadalëson çastin e pikës akute, që asht lufta tek kulla e Drënit, tue hy në marrëdhanie me detaje kanunore, tue përfshi dialogë, burgosjen e krenëve, vizione etike etj. Tek kanga e sjellë nga gjakovari i mirënjohun (Qamili i Vogël), shtjellimi i ndodhisë ka shtrimje tjetër. Teknikat narrative të secilit narrator, po kështu, ndryshojnë në varësi të specifikës së tekstit.

Në lidhje me Maxhar Pashën (që del veç në tekstin B me këtë ndajshtim, v. 28), të dy tekstet e kanë të përcaktueme si *murtat*:²²

ërimin islam (AIITC); Organizata islame për arsim, shkencë dhe kulturë (ISESCO), Tiranë, 2005, f. 674.

18 “*Dovlet-i*, m. [...] tur. *devlét*< ar. *daulát*”, që e gjejmë dhe në serbokroatisht e rumanisht, *ibid*, f. 228.

19 “*Memleqét-i* m. *Në Veri dhe mymleqet* (vjetruem): vendlindje, atdhe, krahinë [...] tur. *memleket*< ar.*mamlaká-tun* [...]”, *ibid.*, f. 639.

20 Tur. *azgîn* e reflektueme në serk. *azgîn*, *ibid.*, f. 51.

21 “*Jyzbásh-i* m. *kapiten, komandant në ushtrí* [...] Tur. *yüzbaşı* “oficer me gradë midis togerit dhe majorit”, *ibid.*, f. 461. Të tilla janë dhe fjalët: *teqé* (në geg.*téqe* - L. K. - kuvend, manastir) <tur. *tekké*< ar. *Tekjé*, *ibid.*, f. 1022; *shéh/ër,-i* - *qytet i madh, ma i haptë e ma i populluem se kasabaja* (= tur. < ar. *kasabá*, *ibid.*, f. 515). Khs. Tahir N. Dizdari, *Persizmat në gjuhën shqipe dhe studimi i tyre*, Ideart, Tiranë, 2010, f. 297.

22 Në vijim: në të majtë - teksti A, në të djathtë - teksti B.

Njat murtat qi ké te shpija *Ni murtat, o qi çoj dovleti*
*A thue bân n' dorë me na lshue, Ra n'Gjakovë tu Abdulla Begi.*²³

[...]

Ká qitë begu edhë i ká thanë:

*Se âsht murtat, se s' âsht murtat*²⁴ etc.

Kjo asht një leksemë, të cilën Fishta nuk e përdor aq dendun sa ato fjalë të tjera me prejardhje turke. Në këtë kangë e përdor pesë herë (ff. 112, 117 (x 3), 119), dhe një herë tjetër tek kanga *Dedë Gjo' Luli*. Gjithsej pra, minimalisht. Por prania e kësaj fjale në tekstin A, me frekuencë të madhe në krahasim me krejt poemën dëshmon për një fakt, që mund të jetë tregues konkret. Siç e cekëm dhe ma sipër, Fishta duhet të ketë qenë në dijeni të asaj kange të fundit të shekullit XIX, për atë çka i ngjau pashës. Kështu që ruejtja e asaj fjale deri tash edhe pse teksti, - meqë përcillet gojarisht brez mbas brezi mund të zëvendsojë fjalë, trajta të vjetra me të reja, sikundër pohon Skendi²⁵ a studiues të tjerë, - mund ta kishte humbë atë (fjalën pra), asht tregues i një konservimi të mirë dhe që dëshmon për vjetrinë e tekstit. Natyrisht, ka shprehje që ndoshta koha e gjatë i ka bjerrë, por vijimsia e ekzistencës së kësaj fjale, e po ashtu e atij numri leksikor me përbamje turke mund të dëftojnë për një kontakt të poetit me kangën mbi vrasjen e Mehmet Ali Pashës. Hymjet e dy teksteve, përpos tjerash, kanë edhe një strukturë të përafrueshme:

*Po rreh teli i vilajetit*²⁶ *Të shtatë kralat, o,rrehin telin:*²⁷

23 *ibid.*, f. 13.

24 *ibid.*, f. 117.

25 Khs. Stavro Skendi, *Poezia epike gojore e shqiptarëve dhe e sllavëve të jugut*, përk.: Xhevat Lloshi. IDK, Tiranë, pa vit botimi., f. 49: “këngët që transmetohen gojarisht nga një brez te tjetri, pësojnë ndryshime të vazhdueshme, që i zëvendësojnë format dhe shprehjet e vjetra me të reja”; khs. po ashtu: Ernest Koliqi, *ibid.*, f. 78.

26 *ibid.*, f. 110. Fjala këtu asht për Vilajetin e Kosovës, i cili i pakënaqun nga vendimi i Kongresit të Berlinit grishen të mblidhen në Gjakovë për ardhjen e pashës së ri. Dihet se fillimisht u vra telegrafisti i pashës, deri kur erdhi momenti i vrasjes së tij. Te kanga “Vrasja e telegrafistit të Mehmet Ali Pashës” jepet edhe data e saktë, ora, vendi, e dorasi. Më 27 gusht 1878 në Prizren, Ramadan Zaskoci “trim lumjanë” vret telegrafistin grek, të cilin e kishte sjellë me vete. Khs.:Rrustem Berisha, *Këngë popullore të rilindjes kombëtare, burim i cit.* Për sa i përket degëve të Vilajetit të Kosovës dhe emrave të drejtuesve të tij, shih: N. Bozborra, *ibid.*, f. 172.

27 *ibid.*, f. 13.

Sa i takon vjetërsisë së tekstit B, dëshmi tjetër asht edhe prania e zanores ë tek toponimi *Përzeren*. Trajtim të veçantë kësaj dukunie i ka dhanë studiuesi Zheji,²⁸ tue mbërritë në gjykimin se zanorja ë në sistemin gegë realisht nuk përban rrokje në pozicione të caktueme (siç dihet tashma), por tek *Eposi i Kreshnikëve*, që asht mbrenda këtij sistemi gjuhësor, kjo del si dukuni organizative e ritmit, dhe njikohësisht asht mbetje e traditës së autorëve tonë të vjetër. Megjithatë, ende sot në një pjesë të mirë të të folunës së Kosovës (tue mos përjashtue kangët),²⁹ ekziston ë-ja e ndërfitun në këtë toponim. Në rastin tonë, teksti B, me anë të kësaj zanoreje e realizon dhetërrokëshin të plotë edhe pse si rregull drejtshkrimor kjo ëna del si *apozicionale*. Tue u mbështetë sërish tek Zheji, kjo zanore ka ligjsi tradite dhe melodike, edhe pse nuk ka ligjshmëri ortografike. Prandej, ajo ka vlerën e vet si “*strukturë muzikore, duke ndërtuar melodinë e notën e vet gjegjëse*”.³⁰ Prania e zanores ëna del në disa kangë të mavonshme, të këndueme me lahutë. Nji ilustrim mund ta kemi nga rapsodi/lahutari prej Koplikut, Jonuz Delaj, në dy vargjet e shkëputuna nga *Këngë për Norën e Kelmendit*:³¹

*Nora, ishte nji vajzë malsore (vājz, malsoore)
E kësaj toke-o arbënore etc.*

Tradita gege fillimisht nuk e njeh aspak zanoren ë tek fjala *arbnore*. Por, në të vërtetë, po ma poshtë, te kjo këngë, nuk delë-ja tek fjala e marrë në analizë (e shënueme me të zeza):

*Mos kujto se gratë malsore (kujto-uo; grāt)
që m’jetojn në këtë tokëarbnore (në ktë took)
se ato jan siç ke mendua (menduaa)
gjith si t’duesh ti-o me veprua etc.*

28 Khs. Gjergj Zheji, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Rilindja, Prishtinë, 1990, ff. 309-318.

29 Përmendim këtu rock band-in kosovar të ’80: Gjurmët, *Në tren për Përzeren*, me vokalist Migjen Kelmendin. Vrej: <http://www.youtube.com/watch?v=JmeB-35WuSzo>.

30 Gj. Zheji, *ibid.*, f. 312.

31 Vrej: <http://www.youtube.com/watch?v=JWzlgcYv2E4>.

Të dy tekstet A dhe B, kanë të përvijuem një *konflikt* që pozicionohet në anën e shqiptarëve: njena palë kërkon ta mbrojë mikun, tjetra kërkon ta ekzekutojë atë, dhe e quen anmik. Krenët kërkojnë të dorëzohet me pleqni miku. Përgjigjja dihet! Nuk e dën pleqnia këtë punë, si shkak i kodeve të njohuna. Të tillë problem ngre edhe kanga e tekstit B:

*Memleqeti, o, m'ka rrethue,
Për qat mik qi s' deshta me lshue.
S'un e lshova, o, un' qet mik-e
Se m'ja nxanë, o, djalit sytë,
E i thonë »Baba t'u ka koritë!
S'kam çka bâj, veç me dhanë kët shpirt-e«³²*

Paçka mendimit të *halisë*, se A. Drëni po mbante “*gjarpnin në gjf*”, tekefundit gjakovari respekton një të drejtë zakonore, i vetëdijshëm se ajo luftë do kishte viktimë të mëdhaja. Po t'i referohemi Koliqit, përfundim që e ka vjelë nga hulumtimi historik i Xhafer Belegut (*Lidhja e Prizrenit dhe veprimet e sajë: 1878-1881*, Kristo Luarasi, Tiranë, 1939) e po ta marrim si të mirëqenë këtë fakt: lufta pati 400 të vdekun e 700 të plagosun. Kuptohet se ishte një kob ajo ndeshje mes dy kampeve, që mund t'i ndajmë *pro* kodit zakonor e *kundër* kodit zakonor.

ii/a. Identiteti historik i personazheve

Në të dy tekstet ka një identitet të saktë historik të personazheve. Tek teksti A, përpos dy pashëve, atij turk e atij shqiptar, kemi edhe personazhe të tjerë që vihen në kampin e Drënit. I pari që del asht Oshi i Nuros (a Hoshi i Nurës). Një fanas që vjen në ndihmë të kulla e gjakovarit, mbasi ishte nisë fillimisht për të ruejtë kishën në Gjakovë. Simbas kërkimeve e pohimeve të Koliqit, ishte kumbara i Hasan agë Batushës³³ (në fakt duhet: Islam agë Batusha), një ndër figurat e asaj lufte dhe pjesëmarrës në Lidhje. Oshi shkon në ndihmë të Batushës, i cili vetë kishte shkue në ndihmë për Drënin. Studiuesi këtu sheh edhe

³² *burim i cit.*, f. 14.

³³ *ibid.*, f. 270.

aspektin e kumbarisë mes besimeve të ndryshme. Mirëpo, ekziston një kangë e periudhës së Rilindjes shqiptare, që na e vështirëson pak problemin. Identiteti i Oshit jepet nga Novosella, dhe asht i biri i Nurë Zenelit:

*Hoshi i Nurës prej Novaselle,
Po i thotë pashë: - Or' mirë se erdhe!
[...]
Hoshi i Nurës, i Nurë Zenelit,
Po i thret Bajram Rustemit.³⁴*

Kështu që, përkatësia fetare (katolike) e Oshit dhe qenia nga Fani i Mirditës, që na del tek Fishta duket se na shfaqen të errëta. Nëse asht kështu si thotë teksti i masipërm, Hosh Nurë Zeneli nuk ka në Miriditë, tue e ditë se ai vend asht i populluem nga besimi katolik. Mund të kemi të bajmë me një rast *kriptokristianizmi* (?). Gjithsesi, ai na del si figurë që ka marrë pjesë në atë luftë dhe që ka ikë nga kisha për tek kulla. Këtë e dëshmon edhe kanga, që mban titullin: *Tu mirë metshi more prifta*. Megjithatë fakti që ai ka shkue për të ruejtë kishën, na çon edhe te rruga dhe përkatësia religjionale. Plus edhe fakti që një mirditas shkon në Gjakovë, tue e ditë se mirditasit janë të ardhun nga Gjakova (migrimi nga Pashtriku), ka një lidhje të pranueshme e të shpjegueshme. Përveç Oshit, tek Fishta na dalin edhe emna si: Shaqir Curri (i ati i Bajram Currit), Bajram Rustemi, të cilët së bashku me Islam agën ishin të vendosun në kullën që do të shkrumbohej ma vonë. Gjithashtu edhe teksti B ka protagonistët e vet realë:

*Veç un k'aj Abdullah Drênin, Islam Aga, o, n' Teqe t' Shehit,
Shaqir Currin, Ram Rustemin, Po i thret, o, Abdulla Begit
Edhë k'aj Oshin e Nuros, [...]
Qi per mik e shkrinë vedin.³⁵ K'ti Shaq' Currit, o, po i çon fjalë
Fjalë Shaqirit, o, m'i ka çue.³⁶*

34 Shih: Rustem Berisha, *Këngë popullore të rilindjes kombëtare*, *ibid.*

35 *ibid.*, f. 121.

36 *bur. i cit.*, f. 13. Për pjesëmarrjen në luftë të Islam agë Batushës shih: Prof. dr. Sadri

Sidoqoftë, teksti B jep përsëri tregues të personazheve realë që morën pjesë në luftën e Gjakovës. Ata janë Col Delia e Man Avdia,³⁷ pjesëmarrës po ashtu të Lidhjes së Prizrenit. Col Delija veç tjerash, njihet edhe si vrasësi i Mehmet Ali Pashës, i cili ma pas edhe ai mbetet i vramë. Sa i takon aktit të Col Delisë, dëshmim tekstor kemi edhe nga kanga e marrë në trajtesë:

*Col Delija, o, sy sahati,
I lumt' goja, o, mirë vikati:
«Vet' po jes, o, pashën p'e qarti».*³⁸

Veprimi i Col Delisë, kuptohet asht i peshuem, i matun mirë. Kjo na del e qartë nga përcaktori që del mbrapa emnit të tij. Duket se ai e ka llogaritë krejt saktë nismën që do ndërmerre. I vetëdijshëm për vrasjen e vet, gjithsesi e kryen këtë akt. Gjithashtu, përkim me dy tekstet kemi edhe sa i takon vrasjes së pashës. Ka një përkim që duhet nënkuptue si i tillë. Nënkuptimi duhet të merret për vendin e vrasjes, që kalohet në satirizim të figurës së tij. Sidoqoftë:

Po të shikojmë, vendi i vdekjes ka një domethanie jo të vogël. Pasha vdes në qilar, në atë vend, i cili përdorej për prodhimet ushqimore të familjes. Vdekja në qilar nënkupton njiherazi tragjiken dhe komiken. Tragjiken, sepse ardhja e pashës pati një fund të idhtë, jo veç për të, por edhe për shqiptarët, pasi ata u detyruen të vrisnin lajmsin, kundër *Kanunit*, dhe pati shumë të ramë gjatë asaj lufte. Komiken, sepse pozicioni i tij dhe vdekja në atë vend nuk janë fort të përkueshme.³⁹

Fetiu, “Veçoritë artistike të këngëve popullore për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”, Revista *Metafora*, Prishtinë, nr. 1, nëntor 2010, f. 15: “*Heroizmin dhe veprimet luftarake të djemve të atdheut, me gjithë përpjekjet e Abdullah pashë Drenit që të arsyetohet në emër të normave tradicionale për mbrojtjen e mikut në shtëpi, i paraqet si vendime të prera të popullit një nga figurat e dalluara të kësaj lufte, Islam agë Batusha*”.

37 Khs. vargjet: “*Man Avdinë po e thrret bajraki, / Po i rrin n’besë, o, sikur i jati. / Po i rrin n’besë, o, si baba i vet-e*”, *ibid.*, f. 14.

38 *ibid.*, f. 14.

39 Lisandri Kola, *Satira në epikën fishtiane...* Camaj-Pipa, Shkodër, 2010, ff. 81-2.

Teksti A për vrasjen e pashës thotë: “*Krisi pushka nper gjytet, / Dër qi s’ mbramit kulla u muer, / E u vrá pasha, mshilë në kjuer*”.⁴⁰ Ndërsa ai B: “*Maxhar Pasha, o, rrin mendue: / »Kush e rreh, o, ni tel për mue? / Babës dovetit, o, me ja çue. / Se n’gjakovë, o, më kanë rrethue, / Më kanë mshelë, o, porsì grue!«*”.⁴¹ Që të dy tekstet afrohen me njëri tjetrin në pikëpamje satirizuese e bashkëpërkese të vrasjes së pashës, tue u përftue kështu:

lidhnia tekstore

- Teksti A → Vrasja e Pashës → e determinueme → (vendi) në *kjuer*: qilar → efekt komik
- Teksti B → Vrasja e Pashës → e padeterminueme → *i mshelun porsì grue* → efekt komik
- Të dy tekstet kanë një rezultante: *prodhimi i efektit komik*

Nëse do kishim një interpretim logjik të përbashkët për të dy tekstet (ndërshkrimje) do mbërrinim në gjykimin se:

- Teksti B → (shkalla 0 e veprimit) **M. A. Pasha**: *Më kanë mshelë, o, porsì grue!* → (programimi; nisja e veprimit nga C. D.) **Rapsodi**: *Col Delija, o, sy sahati, / I lumt’ goja, o, mirë vikati*: / **Col Delija**: »Vet’ po jes, o, pashën p’e qarti + Teksti A → (përfundimi) **Narratori**: *E u vrá pasha, mshilë në kjuer*:

Pra, tekstet kanë një ekzistencë përbashkësore, që na çojnë në një rrjedhë të caktueme logjike, tue marrë kuptim të njëjtë edhe pse tekstet funksionojnë si të mëvetësishëm.

Po përsëri tek kjo kangë e *Lahutës*, ne na dalim personazhe realë, të cilët kanë një funksion të dhanë sa i përket përvijimit të produktit epik. Personazhi asht i renditun në anën e shqiptarëve që kërkonin eliminimin e pashës, dhe njihet si anëtar me peshë i Lidhjes. Ahmet Koronica na del në veprën e Fishtës, si personi që kërkon të negociojë

40 *ibid.*, f. 121.

41 *bur. i cit.*, f. 14.

me Oshin për dorëzimin e mareshalit osman: “Vall, ç’ ká thâñë hoxhë Korenica: / Pa ndigìò, ti Oshi i Nuros, / Qi jé Fandë e ha kuvend, / Edhe din si hecë kanuni: etc”.⁴²

iii. Mehmet Ali Pasha si fiksion letrar

Portreti i pashës osman, natyrisht merr përmasat e trillit letrar, edhe pse ka mbështetjet e veta në histori apo në kronikën e Gjakovës, e ka një lidhje të pashkëputshme me *Lidhjen e Prizrendit* e me *Lugatin*, për sa i përket kronologjisë së kangëve tashma. Fillimisht, pasha del krejt mbrenda natyrës së vet prej diplomati, i cili kërkon të mbërrijë një marrëveshje me parinë shqiptare, të cilët kanë ardhë në kullën ku asht strehue funksionari. Me vargun që ky pashë i ri: “*E ká ’i fjalë të madhe fort*”, narratori nis e krijon lidhjen, tue e justifikue me tonin e fjalët lajkatuese të jyzbashit të Abdylhamidit II. Me përcaktorin *i ri*, duhet nënkuptue se ai asht një nga pashët e radhës, që kanë ardhë për përmbushje detyrash në trojet shqipe. Kodi ligjërues i pashës, asht me fjalë të truellit turk: “*Baba Mbret u bâñ «selâm» / Se aj jue u ká, lule m’ saksí, / Se aj jue u ká, po, hajmalí, / Hajmalí bajtun nen [nên] sjetull:/ U rue porsi sý’n nêñ vetull*”.⁴³

Këto vargje janë parapërgatitëse për të shkue tek *kumti final*, dhe këtu vrejme një taktikë graduale për të hetue dy përfaqësuesit e parisë shqiptare se në ç’ nivele kishte shkue fryma nacionaliste në Lidhje, gjithashtu për të pajtue edhe ata me vendimet e Fuqive të Mëdha. Po përsëri para kumtit final, i cili vjen shumë shpejt: në v. 40, pasha portretizohet me elementë të burleskut. Mes statusit të tij dhe ligjërimit ekziston një mospërputhje, ashtu si nuk ekziston një mospërputhje mes stilit epik të poemës dhe nivelit ligjërimitor të ulët të mareshalit osman. Vargje si: “*Elè mâ qaj Knjaz Nikolla / Nuk po i shef kund mâje vedit, / Ke ká ngelë m’ krepa t’ Cetinës / Pip i lmuet, pa gjâ mbas shpirtit, / Me i u dhimtë gurit e drunit*”,⁴⁴ i përkasin stilit të ulët, që prodhojnë efekt qesharak tek receptuesi. Nën përshkrimin sa komik aq edhe të rafinuem për Nikollën e Malit të Zi - përftohet

42 *vep. e cit.*, f. 119.

43 *ibid.*, f. 111.

44 *ibid.*, f. 111.

burlesku, i cili së bashku me atë pjesë të frazeologjisë shqipe do t'i përgjigjej ma së miri produktit satirik të Fishtës. Por ndërputja e stilit, për këtë autor në gjininë e epikës nuk asht e re. Pasha vijon sërish në këtë trajtë ligjërimit, deri atëkohë kur kumton se sulltani e ka mendue mirë punën që: “*Me i a lshue Malit të Zí / Hot e Grudë, Plavë e Gusí...*”. Mbas reagimit të menjihershëm të Ali Pashës së Gucisë, mareshali ka të njejten paraqitje kontrastuese: mes stilit, dhe statusit.⁴⁵ Atij i mungon edhe të qenit i ftohtë, përderisa fyen krenët e Shqipnisë. Kështu, rezulton një person që nuk din të menaxhojë situatën. Nuk arrin të kompromentojë përfaqësuesit, paçka se ata dalin të vendosun për kufijtë territorialë e për autonominë e vendit tyne. Me të burgosë H. Zekën e A. P. Gucinë, portreti i pashës vijon të na paraqitet si njeri që konsumon - ngjashëm me mëtonjësit në Itakë - me tepri ushqim. Njikohësisht tregohet edhe ndera e respektimi i begut gjakovar, përtej kodit mikpritës: “*Q’ se i ká vojte Pasha per mik, / Mbrendë t’ u errë e mbrendë tue zbardhë, / Tuj u kndellë në bukë të tij, / Drejë e darkë ka [kah ose ka’]nji ferlik, / Cile e zemer ka [kah] ’i « misnik », / « Gjak e vramë » dér m’kupë të giûnit / Bukë Shqyptarit mbas kanûnit.*”⁴⁶

Ndërsa me vv.: “*Qe, edhë Pasha, Mehmet Pasha / Pat mendue n’ Stambollë me vedi, / Se Shqyptarët m’ godi s’ mund t’ bijn*”, autori na dëshmon krejt mekanizmin dhe mendsinë e P. O. për të zbutë faktorin nacionalist. Por, pasha tue mendue kështu, njikohësisht, ka planifikue interesin vetjak. Pra, ato të mira që do t’i vinin në karrierën politike. Kur pasha merr vesh, se në Gjakovë “*behi pika e djalit*”, nis e pendohet për veprimet e tij. Këtu ndryshon kodin e vet dhe përshkruhet me tiparet e një ushtaraku me grada që i hyn frika - tue thellue kësomënyre fermentin burleskor: “*Shka i tha, at herë, çaushit t’ zaptive? / Shpejt me i lshue Krenët e Shqypnis, / Persë... falë i paska Mbreti*”.⁴⁷

Në këtë pasazh, dukshëm del padrejtësia e vendimit për copëzimin e tokave tona, që pasqyrohet në frikën e mareshalit. Pasha

45 Për shndërrimin statusor të pashës, shih: Lisandri Kola, *ibid.*, ff. 80-86.

46 *L. M., ibid.*, f. 114.

47 *ibid.*, f. 116.

dialogisht nuk del ma në kangë, veçse pritet vdekja e tij, në atë vend të kullës, që shërbente për nevojat ushqimore të shtëpisë. Pasha vdes në *kjuer*, për të dalë sërish si lugat në *stjollin* e shtëpisë së Knjazit në kangën vijuese të poemës. Lidhun me vdekjen e tij, vetë narratori ndërhyr tue u ba za i drejtpërdrejtë në kangë e tue thanë: “*Sá per Pashen, drejt po u tham, / Kurrnji grimë un dert s’ po kam ; / S’ po kam dert, as s’ m’ vjen e vshtirë: / T’ i’n kênë dy, edhè fort mâ mirë*”.

Ndodhia si *fakt historik*, asht krejt ndryshe me *hipotipozën* që ndërton poeti. Thurja e vargjeve asht e gjitha letërsi, me larmi konfigurimesh të personazheve, të zhveshun nga identitetet historike, të shndërrueme në tekst letrar, dhe të përshtatun vetëm për qëllim autorial - kod tekstor. Nuk kemi të dhana historike, nëse vërtet pasha asht vra në qilarin e kullës së Drênit apo në një vend tjetër të shtëpisë. Për autorin ka qenë e mjaftueshme dijenia e ndodhisë, përvijimi i ngjarjeve, për ta kalue të gjithën në ekzistencë letrare, përtej zanafillës historike. Edhe sikur të ishte kjo e vërteta historike, prapëseprapë nënshtrimi ndaj organizimit poetik, vizionit të Fishtës, mesazheve që fshihen në vetvete në ato vargje etj., janë ato që i interesojnë trajtimit tonë.

Për ta mbyllë mund të themi se, teksti fishtian dhe ai i Qamilit kanë një përafri strukturore mes tyne - tekste që në fakt tipologjikisht, si destinim, masë metrike, në prozodi janë të përkundërt, por gjithsesi kanë një dominancë të përbashkët në pasqyrimin e saktë të historicizmit, identiteteve reale. Dhe simbas nesh kjo kangë e *Lahutës*, me gjasa të shumta ka mbështetje në traditën tekstore përcjellë prej rapsodëve anonimë. Variantet e kangëve të kësaj ndodhie, autori mund t’i ketë kontaktue përmes materialeve të botueme ndër blejtë e ndryshëm, ose meqenëse, transmetimi oral i kangës ishte funksional, mund ta ketë dëgjue të këndueme nga një rapsod. Siç kanë pasë rastin të kenë përvoja të tilla shumë autorë të ndryshëm të letërsisë shqipe dhe sidomos vëllaznit françeskanë, të cilët kanë kontribue vetë në mbledhjen e korpusit epik, në stabilizimin e botimeve të caktueme - padyshim dhe në studimin e tyne.

Nicolas Boileau / *L'art poétique* / 1674*Arti poetik* / Përkthyer nga Vinçens Marku***Kënga I***

Më kot një poet i ndërkryer në kreshtë të Parnasit mendon të arrijë me artin e vargjeve, nëse nuk ndjen nga qielli ndikimin e fshehtë, nëse ylli i tij në lindje nuk e ka bërë poet, ai nga dhunti e mangët është gjithnjë i zënë rob; për të Febi është shurdh, dhe Pegasi është i pashtruar.

O ju pra të cilët, duke u djegur nga afshi i rrezikshëm, ndiqni rrugën gjembore të poetit, mos u shkrini mbi vargje pa fryt, as mos e merrni për dhunti zellin për të rimuar; druani ngasjet e rrejshme të një kënaqësie të kotë, dhe pyesni gjatë veten dhe matni forcat tuaja.

Natyra, e pasur me cilësi të shkëlqyera, di mes autorëve të ndajë talentet: njëri mund të hedhë në vargje një afsh dashurie; tjetri me një shigjetë përqeshëse të mprehë epigramin. Malerbi mund të lartësojë bëmat e një heroi; Rakani, të këndojë Filen, barinjtë dhe pyjet, por shpesh një autor i cili lavdërohet dhe veten pëlqen nuk njeh dhuntinë e tij dhe shpërfill vetveten: kështu edhe ky që pamë njëherë me Faren të nxinte me vargjet e tij muret e kabaresë tani do t'i këndojë, pa vend, me një zë të pahijshëm, popullit hebre ikjen ngadhënjimtare, dhe, duke ndjekur Moisiun përmes shkretëtirave, rend me Faraonin të mbytet në detëra.

Te çdo subjekt që trajtojmë, ose komik, ose të madhërishtëm, gjykimi i shëndoshë të pajtohet gjithnjë me rimën; më kot njëri me tjetrën duken se urrehen; rima është një skllave e duhet që të bindet. Pavarësisht se për ta kërkuar si duhet në fillim na mundon, mendja lehtë mësohet për ta gjetur; në zgjedhën e arsyes ajo nënshtrohet pa zor dhe nuk e lëndon, por i shërben dhe e pasuron. Por, kur e shpërfill, ajo ngre krye, dhe, për ta kapur sërish, kuptimi rend pas saj. Ta doni pra arsyen: që gjithnjë shkrimet tuaja të nxjerrin vetëm prej saj dhe shkëlqimin dhe vlerën e tyre.

Të shumtit, të pushtuar nga një dëshirë e çmendur, shkojnë të kërkojnë mendimet e tyre gjithnjë larg gjykimit të drejtë: ata do të ndiheshin të ulur, në vargjet e tyre të panatyrshëm, nëse do të mendonin se dikush tjetër ka mundur të mendojë si ata. Të shmangim këto teprime, t'ia lëmë Italisë çmendurinë me nam e të gjitha këtyre shkëlqimeve të rreme. Gjithçka duhet të priret drejt gjykimit të shëndoshë, por, për të arritur aty, shtegu është i rrëshqitshëm dhe i mundimshëm për t'u kaluar; vetëm pak po të mënjanohesh, menjëherë bie. Arsyeja për të ecur nuk ka shpesh veçse një rrugë.

Një autor nganjëherë, tepër i dehur nga objekti i tij, asnjëherë pa e shteruar nuk braktis një subjekt. Nëse ai has një pallat, më pikturon fasadën; pastaj më shëtiti nga tarraca në tarracë; këtu jepet një shkallë; atje sundon një korridor; atje një ballkon rrethohet me një parmak të artë. Ai numëron rrathët dhe ovalet e tavaneve; *që nuk janë veçse lulime, nuk janë veçse astragale*. Kapërcej njëzet faqe për t'i gjetur fundin, dhe mezi arrij të shpëtoj përmes kopshtit. Shmangni teprinë shterpë të këtyre autorëve, dhe mos u ngarkoni me një hollësi të padobishme. E gjithë kjo që themi tepër është e pashije dhe e neveritshme; Mendja e velur e refuzon në çast. Kush nuk di të përmbahet nuk diti kurrë të shkruajë.

Shpesh frika për një të keqe na çon tek një më e keqe. Një varg ishte tepër i dobët, dhe ju e bëni të ashpër; mundohem të mos zgjatem, dhe bëhem i errët; njëri nuk është tepër i stolisur, por muza e tij është tepër e zhveshur; tjetri ka frikë se zvarritet, ai humbet mes resh.

A doni ju të meritoni pëlqimet e publikut? Pa pushim duke shkruar ndryshoni ligjërimin tuaj. Një stil tepër i njëjtë dhe gjithnjë i njëtrajtshëm më kot shkëlqen për sytë tanë, ai veç na vë në gjumë. Lexohen pak këta autorë, të lindur për të na mërzhitur, që gjithnjë mbi një ton duket sikur psalin. Lum kush di, në vargjet e tij, me një zë të lehtë të kalojë nga ton i rëndë në të ëmbël, nga komiku në të rreptin! Libri i tij, i pëlqyer nga Qielli dhe i dashur nga lexuesit, shpesh te Barbeni rrethohet nga blerësit.

Çfarëdo që ju të shkruani shmangni ultësinë: edhe stili më pak fisnik e ka fisnikërinë. Në kundërshtim me gjykimin e shëndoshë, burlesku i pacipë joshi sytë në fillim, u pëlqye për risinë. Në vargje

nuk shihje tjetër veçse thumbime të pista; Parnasi foli gjuhën e pazarit; liria për të rimuar atëherë nuk pati më fre; Apoloni i maskuar u bë Tabaren. Kjo molepsje preku provincat, nga shkruesi dhe nga borgjezi kaloi deri te princat. Gaztori më i keq pati përkrahësit e tij; dhe, deri madje d'Asusi, të gjithë gjetën lexues. Por nga ky stil së fundi oborri i zhgënjyer përbuzi ekstravagancën e lehtë të këtyre vargjeve, dalloj të dëlirin nga banali dhe qesharaku, dhe i la provincës të admirojë Tifonin. Ky stil të mos njollosë kurrë veprën tuaj. Të imitojmë qesëndinë elegante të Marosë, e t'ia lëmë burleskun gaztorëve të Urës së re.

Por mos shkoni gjithashtu, mbi hapat e Brebëfit, po si ai në një *Farsalë*, të ngritni mbi brigje *me të vdekur dhe me ato që po vdesin një qind male rënkuese*. Kapni mirë tonin tuaj, të jeni të thjeshtë në art, të madhërisëm pa krenari, të këndshëm pa zbukurim.

Mos i jepni lexuesit asgjë që atij të mos mund t'i pëlqejë. Të kini për kadencën një vesh të rreptë: që gjithnjë në vargjet tuaja, kuptimi duke prerë fjalët, të pezullojë hemistikun, të shënojë pushimin.

Ruani që një zanore, që vrapon tepër e ngutur, të mos ndeshet me një tjetër zanore në ecjen e saj, kjo është një zgjedhje fatlume për fjalët harmonike. Shmangni ndeshjen e urryer të tingujve të këqij: vargu më i plotë, mendimi më fisnik nuk mund t'i pëlqejë mendjes, kur veshi vritet.

Gjatë viteve të para të Parnasit francez trilli vetëm krejt bënte të gjitha ligjet. Rima, në fund të fjalëve të mbledhura pa masë, zinte vendin e zbukurimeve, të ritmit dhe të cezurës. Vijoni diti i pari, në këto shekuj të vrazhdë, të shpleksë artin e ngatërruar të romancierëve tanë të vjetër. Maroi, menjëherë më pas, bëri të lulëzojnë baladat, thuri triolette, rimoi maskaradat, nën refrene të rregulluara nënshtroi rondot dhe tregoi udhë krejt të reja për të rimuar. Ronsari, që e pasoi, me një metodë tjetër, rregulloi gjithçka, ngatërroi gjithçka, bëri një art sipas mënyrës së tij, dhe prapëseprapë për një kohë të gjatë pati një fat të lumtur. Por Muza e tij, që në frëngjisht fliste greqisht dhe latinisht, shikoi në periudhën e mëpasshme, nga një përmbysje groteske, të gremiset shkëlqimi pedantesk i fjalëve të tij të mëdha. Rënia e këtij poeti krenar nga një majë e tillë, i bëri më të

përmbajtur Deport dhe Berto. Më në fund Malerbi erdhi, dhe, i pari në Francë, bëri të ndihet në vargje kadenca e duhur, tregoi fuqinë e një fjale në vendin vet, dhe vuri muzën nën rregullat e detyrës. Nga ky shkrimtar i ditur gjuha e ndrequr nuk dha më asgjë të ashpër për veshin e pastruar. Stancat mësuat të bien me hir, dhe vargu mbi varg nuk guxoi më të kalërojë. Të gjithë ia njohën ligjet; dhe ky prijës besnik për autorët e kohës sonë shërben ende si model. Ecni pra në hapat e tij, t'ia doni pastërtinë; dhe t'ia imitoni qartësinë e shprehjes fatlume, nëse kuptimi i vargjeve tuaja kapet me vonesë, mendja ime menjëherë fillon të shpërqendrohet, dhe, e gatshme të shkëputet nga ligjërimet tuaja të kota, nuk e ndjekë një autor që duhet gjithnjë ta kërkosh.

Ka disa njerëz mendimet e errëta të të cilëve janë mbështjellë gjithnjë nga një re e dendur; drita e arsyes nuk do të mund t'i depërtojë. Pra para se të shkruani, mësoni të mendoni. Sipas idesë sonë qoftë më shumë ose më pak e errët, shprehja e ndjek, ose më pak e qartë, ose më e pastër. Atë që e mbrujmë mirë e shprehim qartë dhe fjalët për ta thënë arrijnë lehtë.

Mbi të gjitha në shkrimet tuaja gjuha e nderuar qoftë gjithnjë e shenjtë edhe në teprimet tuaja më të mëdha. Më kot, ju më joshni me një tingull melodik, nëse fjala është e pavend ose shprehja me cen: mendja ime nuk e pranon një barbarizëm madhështor, as solecizmin krenar të një vargu të fryrë. Pa gjuhë, me një fjalë, autori më hyjnor është gjithnjë, çfarëdo që të bëjë, një shkrimtar i keq.

Punoni me nge, çfarëdo urdhri që ju të merrni, dhe mos u ngutni me një shpejtësi të çmendur. Një penë vërtet e shpejtë, e që rend duke rimuar, tregon dhunti shumë më të pakët sesa gjykim të pakët. Më pëlqen më shumë një rrëke që, mbi dheun e butë, në një lëndinë plot me lule shëtiti ngadalë, sesa një përrua i tejmbushur që, me një rrjedhë të rrëmbyer, rrokulliset, plot me zall, mbi një terren të baltosur. Nxitoni ngadalë, dhe, pa humbur guximin, njëzet herë rikthejuni veprës suaj: pastrojeni pa pushim dhe ripastrojeni; shtoni ndonjëherë, dhe shpesh fshini.

Nuk mjaftojnë që në një vepër ku gabimet gëlojnë, disa shkëndija të talentit, të mbjella kohë pas kohe, të shndrijnë. Duhet që çdo gjë

aty të vihet në vend të vet; që fillimi, fundi, të përputhen me mesin; që pjesët e lidhura me një art delikat të formojnë veçse një tërësi të vetme me pjesë të ndryshme, që kurrë ligjërimi, duke iu shmangur subjektit të mos kërkojë tepër larg ndonjë fjalë të shndritshme.

A keni frikë ju për vargjet tuaja gjykimin publik? Të jeni për veten tuaj një kritik i rreptë. Padituria është gjithnjë e prirë për t'u admiruar. Të bëni miq të gatshëm për t'ju kritikuar; që ata të jenë të besuar të sinqertë të shkrimeve tuaja, dhe kundërshtarë të zellshëm të të metave tuaja. Hiqeni para tyre arrogancën e shkrimtarit, por të dini të dalloni mikun nga lajkatari: ai që ju duket se ju duartroket, ju përqeshë, ju vë në lojë. Të doni t'ju këshillojnë, dhe jo t'u lëndojnë.

Një lajkatar menjëherë kërkon të entuziazmohet: çdo varg që ai dëgjon e bën të mahnitet. Gjithçka është magjepse, hyjnore, asnjë fjalë nuk e lëndon, ai kërcen nga gëzimi, ai qan nga mallëngjimi; ju mbulon kudo me lavdërime madhështore: e vërteta nuk ka aspak këtë mënyrë të papërmbajtshme. Një mik i ditur, gjithnjë i rreptë, i palëkundshëm, për të metat tuaja nuk ju lë kurrë në paqe: ai nuk i fal aspak pjesët e shkujdesura, ai çon në vendin e tyre vargjet e vendosura keq, ai zbut emfazën ambicioze të fjalëve; këtu kuptimi e vret, dhe më pas edhe fraza. Ndërtimi i juaj duket sikur errësohet pak; ky term është i pakuptueshëm, ai duhet të qartësohet. Kështu ju flet një mik i vërtetë.

Por shpesh për vargjet e tij një autor kryeneç, mendon se është në dobi të tij t'i mbrojë të gjithë, e që në fillim merr në dorë të drejtën e të fyerit. «Shprehja e këtyre vargjeve, - do të thoni ju, - është e ulët - Ah! Zotëri, për këtë varg ju kërkoj të falur, do të përgjigjet ai në fillim. - kjo fjalë më duket e ftohtë, unë do ta hiqja. - Është pjesa më e bukur! Ky ndërtim nuk më pëlqen. - Të gjithë e admirojnë.» Kështu gjithnjë i vendosur për të mos hequr asgjë, nëse një fjalë në veprën e tij ju është dukur sikur ju lëndon, kjo është një arsye për të që të mos e fshijë. Megjithatë, po ta dëgjosh, ai e do fort kritikën; ju keni për vargjet e tij një pushtet despotik, por gjithë ky ligjërim i bukur me të cilin ai iu lajkaton nuk është gjë tjetër veçse një kurth i zgjuar që ju t'i recitoni. Ai, menjëherë, ju lë; dhe, i kënaqur nga muza e tij, shkon të kërkojë diku tjetër ndonjë sylesh për ta mashtruar; sepse

shpesh e gjen: ashtu si me autorë të marrë, shekulli ynë është i pasur edhe me admirues të marrë; dhe, pa ata që dyndin kryeqytetin dhe provincën, ai është te duka, ai është te princi. Vepra me më pa shije, te oborrtarët, e të gjitha kohërave ka gjetur përkrahës të zellshëm; dhe në fund për ta kryer me një shigjetim satire, një i marrë gjen gjithnjë një më të marrë që ta admirojë.

• *shënime mbi tekstin* •

Kënga I

Vargu 2 Parnasi, mal në Fokidë, në Greqinë Qendrore, kushtuar Apolonit dhe muzave. Ai shpesh simbolizon frymëzimin poetik dhe vështirësinë e artit të vargjeve.

Vargu 3 Huazim nga astrologjia.

Vargu 4 Një ide të ngjashme e gjejmë edhe tek proverbi latin: *Nascuntur poetae, funt uratores* “Poet lindesh, orator bëhesh”.

Vargu 5 Horaci tek *Arti Poetik* (v. 409-411) shpreh saktësisht të njëjtën teori: “*Kushti i parë për të shkruar vargje është të kesh dhunti.*”

Vargu 6 Feb Apoli, perëndia e poezisë lirike.

Vargu 6 Pegasi, kalë me flatra i cili mbart poetët e frymëzuar.

Vargu 10 Bualo i ka dhënë këtu kësaj fjale ngarkesë ironike. [*Boileau oeuvres poétiques*. Georges Pellissier. Édition nouvelle avec notice, commentaire et lexique, Huitième édition. Paris, 1900.]. Në fillim, për secilin burim, kemi të dhënat e plota, ndërsa më pas vetëm versionin e shkurtuar të tij.

Vargu 12 Horaci, *Arti poetik*, v. 38-40.

Vargu 17 Fransua dë Malerb (François de Malherbe, 1555-1628) poet zyrtar i mbretit Henri IV dhe i Mbretëreshës Maria de’ Mediçi.

Vargu 18 Filisa, emër mjaft i përdorur në poezinë baritore dhe dashurore.

Vargu 18 Honora dë Byeje (Honorat de Bueil), markezi i Rakanit (1589-1670), shkroi *Les Bergeries* (*Vathët e dhenve*) më 1625.

Vargu 21 “Sent Aman. Autor i *Moïse sauvé*.” [Bualo, 1674]. Mark-Antuan Zhirar dë Sent-Aman (Marc-Antoine Girard de Saint-

Amant, 1594-1661), autori i *Moïse sauvé (Moisiu i shpëtuar)* më 1653. Qe ndër pjesëtarët e parë të Akademisë franceze dhe ndjekës i preciozizmit.

Vargu 21 “Fare autor i librit të titulluar *Honnête Homme* dhe mik i Sent Amanit.” [Bualo, 1713]. Nikola Fare (Nicolas Faret, 1600-1646). Më 1630 shkroi *Honnête Homme, ou L’art de plaire à la cour (Njeriu i ndershëm, ose arti i të pëlqyerit në oborr)*.

Vargu 22 Marciali, *Epigrame*, XII, v. 62: “Një poet i dehur që shkruan poemat e tij me thëngjill ose me shkumës mbi muret e një taverne me tym.”

Vargu 31 Për gjetjen e rimës dhe vështirësinë e saj Bualo është shprehur edhe te *Satira II* (Molierit) dhe te *Letra XI* (“Kopshtarit tim”).

Vargu 38 Horaci, *Arti poetik*, v. 309: “Themeli dhe burimi i artit për të shkruar mirë është arsyeja.”

Vargjet 39-42 kanë bashkëpërkim idesh me kreun II dhe IV tek *E madhërishtësia* e Pseudo-Longinit.

Vargu 51 Astragali është një zbulim me derdhje gjysmërrethore në kolonat antike, pikërisht në vendet ku bashkon kolonën me pjesën e poshtme dhe të sipërme të saj.

Vargu 51 “Varg i Skyderisë.” [Bualo, 1674].

Vargu 62 Horaci, *Arti poetik*, v. 337: “çdo gjë e tepërt nuk pranohet nga stomaku plot”.

Vargjet 64-68 janë reminishencë nga *Arti poetik* i Horacit, v. 31, 25-28, 230.

Vargjet 75-78 krahaso me v. 343-346 të *Arti poetik* të Horacit: “Pëlqimin e plotë do të ketë ai që të dobishmen e gërsheton me të këndshmen / duke argëtuar lexuesin por edhe duke e këshilluar / ky libër çok do t’u sjellë dobi Sosive, do të kalojë edhe detin, / dhe shkrintarit të famshëm do t’ia sigurojë lavdinë e përjetshme.” [Përktheu nga latinishtja: Dr. Engjëll Sedaj]. Sosi, librarë në Romën antike.

Vargu 78 Barbeni. “Botues dhe librar i pallatit mbretëror”. [Bualo, Shënimi i *Letrës X*].

Vargu 81 “Stili burlesk që jashtëzakonisht në modë nga fillimi

i shekullit fundit deri më 1660, ku ai bie.” [Bualo, 1713]. Burlesku është një lloji parodie, në të cilën heronjtë e epikës, që shquhen për një ligjërim të lartë, përdorin një gjuhë të thjeshtë të njerëzve të zakonshëm, dhe anasjelltas, ku njerëzit e zakonshëm përdorin gjuhën e heronjve të mëdhenj.

Vargu 86 Antuan Zhirar (Antoine Girard, 1584-1626), autor farsash i njohur për kohën.

Vargu 86 “Aludim për *Virgile travesti (Virgjili i maskuar)* të Skaronit” [Bualo, 1713].

Vargu 88 Shkruesi, ai që kryente detyrën e sekretarit në shërbim të një noteri ose të një njeriu të ligjeve.

Vargu 90 “Autor i mjerë, që kompozoi *Ovide en belle humeur.*” [Bualo, 1713]. Kjo vepër e Charl d’Asusisë (Charles d’Assoucy, 1605-1674) nuk është gjë tjetër veçse kthimi në burlesk i *Metamorfozës* së Ovidit, të cilën e titulloi *Ovide en belle humeur (Ovidi në humor të mirë, 1650)*.

Vargu 94 *Thyphon ou la Gigantomachie* (1644), poemë e Skaronit në pesë këngë që parodizonte luftën e gjigantëve me perënditë; pra një parodi e epopesë. [*Boileau Le lutrin et L’art poétique. Rene D’Hermies. 10e Édition, Classiques Larousse, Paris, 1928. Shënimi 13, f. 66,*].

Vargu 96 Klemen Maro (Clemént Marot, 1496-1544), autor i njohur i krijimeve të vogla.

Vargu 97 “Shitësit e barërave kundërhelme dhe lojtarët e marionetave u vendosën për shumë kohë mbi Urën e Re.” [Bualo, 1713].

Vargu 98 Zhorzhe de Brebëf (Georges de Brébeuf, 1618-1661), Kishte përkthyer *Farsalën* e Lukanit te *La Pharsale de Lucain ou les Guerres civiles de César et de Pompée en vers français (Farsala e Lukanit ose Lufta civile e Cezarit dhe e Pompeit në vargje frëngjisht)* dhe vargu të cilin Bualo e citon më poshtë (vargu 100), duke e shtrembëruar, është përkthyer mjaft saktë nga Brebëfi në veprën e tij te vargu 897 i këngës VII.

Vargu 100 “Varg i Brebëfit.” [Bualo, 1674]. Këtë shënim të Bualosë nuk e gjejmë te botimi 1713.

Vargu 115 Poezia franceze e pranoi rimën e plotë aty nga shekulli XII. Kjo u parapri nga rima asonantike. [Rene D’Hermies, Paris, 1928, shënimi 9, f. 67.]

Vargu 117 Vijoni, poet i madh i shekullit XV dhe njëkohësisht i pari i një brezi poetësh, si: Maro dhe Rabële.

Vargu 118 “Pjesa dërrmuese e romaneve tonë të vjetër janë në vargje të pështjelluara dhe pa rregull, si *Roman de la rose* dhe shumë të tjerë.” [Bualo, 1713].

Vargu 120 Trioleta është një poezi tetëvargëshe me dy rima (abaaabab), në të cilën vargu 1, 4, dhe 7 janë të njëjtë dhe vargu 8 është përsëritje e vargut 2. *Maskaradat* pjesë me vargje pa formë të veçantë, të bëra për personazhet e baletit. [Rene D’Hermies, Paris, 1928, shënimi 1, f. 68.]. Duhet shtuar këtu se Maroi nuk ka shkruar as trioleta as maskarada.

Vargu 121 Rondo, një poemë me trembëdhjetë vargje me tri strofa (5+3+5) me dy rima dhe refreni përbëhet nga vargu i parë ose nga disa fjalë të vargut të parë, që përsëriten në fund të strofës së dytë dhe të tretë. Vargjet i ka tetërrokësh ose dhjetërrokësh. [Rene D’Hermies, Paris, 1928, shënimi 2, f. 68.]

Vargu 123 Pjer dë Ronsar (Pierre de Ronsard, 1524-1585), poet francez humanist i Plejadës, një ndër poetët më të mëdhenj francez.

Vargu 126 Teprim i Bualosë. Ronsari ishte, siç qe Rabële, kundërshtar i prerë i latinizuesve dhe greqizuesve.

Vargu 130 Filip Deport (Philippe Deportes, 1546-1606), abati i Shën-Tironit, shkroi sonete dhe elegji dhe qe ndjekës i Ronsarit.

Vargu 130 Zhan Berto (Jean Bertaut, 1552-1611), ipeshkëv i Séezit, shkroi sonete, letra dhe stanca.

Vargu 139 Këto vargje të Bualosë na kujtojnë Danten tek *Ferri*, kënga II, vargjet 139-140: “Tu duce, tu senior e tu maestro” (Ti prijësi, ti imzot dhe ti mësuesi), që i drejtohet Virgjilit.

Vargjet 153-154 janë reminishencë nga *Arti poetik* i Horacit te v. 40-41 e sidomos v. 311: “dhe fjalët e pafuara do ta ndjekin përmbajtjen e menduar mirë”. [Përktheu nga latinishtja: Dr. Engjëll Sedaj]

Vargu 160 Barbarizmi, këtu, është një gabim në fjalor ose në

gjuhë, ndërsa solecizmi është gabim sintaksor. [Rene D’Hermies, Paris, 1928, shënimi 12, f. 68.]

Vargu 163 “Skyderi thoshte gjithmonë, për t’u shfajësuar për punën me kaq ngut, se ishte urdhëruar ta mbaronte.” [Bualo, 1713].

Vargu 171 Shprehje e perandorit August “Festina lente”.

Vargjet 171-174 janë reminishencë, në mos përkthim i lirë i vargjeve 291-294 të *Artit poetik* të Horacit: “mundi që sjell dora e fundit dhe durimi. / Ju. O gjaku i Pompilit, mos e pranoni këngën, / para se ta shlyeni, ta frenoni e ta korrigjoni shumë, / dhe dhjetë herë ta përmirësoni me thonj”. [Përktheu nga latinishtja: Dr. Engjëll Sedaj]

Vargu 174 “Nëse shkruaj katër fjalë, unë do të fshij tri prej tyre” (Satira II, 52). Reminishencë e Kuintilianit, *Instituti i oratorisë*, X, 4: “Kemi besuar, me arsye, se stileti (pena) nuk vepron më pak kur fshin.”.

Vargu 176 Horaci, *Letra II*, I, v. 75. Nëse mes këtyre vargjeve (ata të Liv Andronikut) ndrit një fjalë e shkëlqyer, nëse një ose dy vargjeve nuk iu mungon eleganca, është krejt e padrejtë që poeti të lavdërojë tërë poemën e tij.”

Vargu 178 Horaci, *Arti poetik*, v. 93 dhe 152.

Vargu 180 Horaci, *Arti poetik*, v. 23: “Shkurt: sidoqoftë, çdo veper le të jetë një tërësi e plotë!”. [Përktheu nga latinishtja: Dr. Engjëll Sedaj]

Vargu 184 Horaci, *Letra II*, II, v. 107: “Ai që do të dëshirojë të bëjë një poemë sipas rregullave, të mbajë ndaj veprës së tij qëndrimin e një kritiku të drejtë.”

Vargu 185 Horaci, *Letra II*, II, v. 106: “Përqeshim poetët e këqij; por vetë ata janë të kënaqur për atë që shkruajnë, vetveten ata admirojnë dhe me kënaqësi lavdërojnë atë që kanë shkruar.”

Vargu 190 Horaci, *Arti poetik*, v. 424-425: “një të akuzuar rëndë, do të habitem, a do të jetë në gjendje / ai i lumi të dallojë mikun nga gënjeshtari?” [Përktheu nga latinishtja: Dr. Engjëll Sedaj]. Dhe aty më poshtë v. 436 “Nëse krijon poema të mos bie në mashtrim të ndjenjave hipokrite në bisedë me ta.”

Vargje 195-198 janë pothuajse përkthim i vargjeve 428-430 të

Artit Poetik të Horacit.

Vargu 199 Horaci, *Arti poetik*, v. 438-450.

Vargu 219 Reminishencë nga Moliere (Oronti te *Mizantropi*).
[Rene D'Hermies, Paris, 1928, shënimi 1, f. 72.].

Vargu 228 Ndoshta aludohet për Charl Koten (1604-1681), abat, filozof dhe poet francez, i cili shoqërohej me shtresat e larta. U bë pjesëtar i akademisë franceze më 7 janar 1655.

Komisia Letrare e Shkodrës në 100 vjetorin e saj

Shefik Osmani

Komisia Letrare Shqipe

Vitet 1916-1918 qenë vite të rënda, të ngarkuara me të papritura, rrjedhojë e furisë së Luftës së I Botërore. Rrezikohej gjithçka: liria, gjuha, kultura kombëtare, traditat. Në këto kushte të rënda, me nismën e Luigj Gurakuqit, u ngrit më 1 shtator 1916, Komisia Letrare Shqipe.

Komisia Letrare Shqipe është pjellë e një plejade të tërë veprimtarësh atdhetarë - shqiptarë, gjuhëtarësh dhe shkrimtarësh, mësuesish dhe pedagogësh si L. Gurakuqi, Gj. Pekmezi, S. Peci, H. Mosi, A. Xhuvani, N. Mjeda, M. Logoreci, S. Nivica, etj. të cilët, ndonëse punuan në kushtet e pushtimit austrohungarez, nuk iu shmangën synimeve të përcaktuara në platformat e Rilindjes, ku shumica e tyre kishin qenë pjesëtarë aktive. Në këtë kuptim, ajo qe një vazhdim i natyrshëm i punimeve të Kongresit të Manastirit (1908-1910), kongresit të Elbasanit (1909) etj. Në këtë vazhdë, Komisia Letrare Shqipe me qendër në Shkodër u bë shpejt një institucion i rëndësishëm dhe kreu funksionin e një Komisioni gjuhësor dhe të një Këshilli Shkencor pedagogjik, pa lënë të humbasin kot dy vjet kohë, siç ishin ato të asaj periudhe. Në të bënë pjesë si anëtarët e saj edhe dy gjuhëtarë të huaj, albanologë të njohur: Maksimilian Lambertzi dhe Raiko Nahtigali.

Gjatë dy vjetëve të jetës së saj, Komisia Letrare Shqipe zhvilloi mbi 60 mbledhje pune, duke pasur në qerthull të veprimtarisë *“lërimin e gjuhës shqipe dhe zhvillimin e letërsisë së saj”* dhe *“hartimin, qortimin, miratimin dhe botimin e teksteve shkollore”* (Neni 2/c statut). Ajo hartoi plane të qarta dhe mori vendime me interes për gjuhën e përbashkët, për termat ose skajet administrative, gjuhësore, shkollore etj., për ngritjen e institucioneve kulturore, botimin e literatures artistike, nxjerrjen e organeve periodike, përgatitjen e teksteve mësimore etj. Përpunoi dokumente të rëndësishme, siç qe ai i drejtshkrimit të përbashkët që çoi përpara njësimin e shqipes së shkruar.

Duke u nisur nga një konceptim i drejtë i problemeve që shtronte perspektiva në ato momente politike, krahu përparimtar i KLSH e shtriu rrezen e veprimit të tij në katër drejtime: në atë të gjuhësisë, letërsisë, kulturës dhe pedagogjisë. Vendimet që ato morën qenë konkrete dhe patën karakter të theksuar funksional.

Në gjuhësi, të rëndësishme janë problemet e drejtshkrimit. Në mbledhjen e dhjetorit 1916, në vazhdim të diskutimit të problemeve të drejtshkrimit, kryetari i KLSH Dr. Gjergj Pekmezipohte se: “ku s’kagjuhë, s’ka ortografi. Gjuha e përbashkët sot për sot është qëllim i parë!” Në funksion të kësaj teze të frymëzuar nga L. Gurakuqi dhe të sanksionuar në statut, i mbështetur në të dhënat shkencore të kohës, ai shtroi edhe variantet e zgjidhjes, të cilat u bënë objekt diskutimesh të zjarrtë në Komisi. U rrah mendimi që të merrej bazë një dialekt e prej këtej të bëhet një skelet, i cili të mvishej e të zbukurohej pastaj me frazeologji dhe leksikografi të dialekteve të tjerë. U shtrua edhe teza që të mbeten dy dialektet e sotëm të gjuhës së shkruar, njëri pranë tjetrit, duke i afruar ata, duke i përhapur në çdo mënyrë dhe në të tëra trevat e Shqipërisë. U fol edhe për variantin e tretë, por ndërhyrja e Gurakuqit qe vendimtare: «Sot për sot, – theksoi Gurakuqi, – kemi nevojë që të zgjedhim për dialekt që të jetë si urë në mes dy dialekteve, i cili është për t’u kërkuar në Shqipërinë e Mesme, prandaj mund të merret dialekti i Elbasani». Pas marrjes së këtij vendimi u ftua filologu Aleksandër Xhuvani si ekspert për të zgjidhur problemet speciale që lindin dhe për t’u dhënë rrugë problemeve praktike. Mbi këtë bazë, më 20.12.1916u vendos «ortografia e gjuhës së shkruar të katër librave shkollorë». Më 20.2.1917, u vendos «karakteri i ortografisë është përgjithësisht fonetik mbi themel të dialektit të Elbasanit», më 20.2.1917, u trajtua problemi i «terminologjisë», kurse në mbledhjet e marsit 1917 u morën vendimet për rregullat e drejtshkrimit. Këto probleme vazhduan të diskutohen, të përpunohen dhe të merren vendime për to, edhe më vonë, p.sh. në mbledhjen e datës 28.8.1917, pasi ishin rrahur gjerësisht tezat shkencore, u arrit në përcaktimin e kritereve bazë të drejtshkrimit të shqipes, që u formuluan në dokumentin «Parimet e rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe» përbërë nga njëmbëdhjetë paragrafë. Në mbledhjen

e datës 24.9.1917 u vendos që këto rregulla të shpallen publikisht nëpërmjet shtypit.

Përsa i përket problemeve të letërsisë KLSH, i dha shtytje krijimtarisë artistike. Që në nenin e parë të statutit të ri, përmbajtja e të cilit u komunikua në mbledhjen e datës 7.12.1917, thuhet: «Do t'i jap shkas literaturës shqipe, tue botuem vjersha shkrimtarësh e vjershëtarësh shqiptarë që (nuk) janë shtypë ende. Botimet do të jenë vëllime të thjeshtë dhe të lirë». Në këtë nen statuti u jepet e drejta anëtarëve të Komisionit që, kur konstatojnë ose njoftohen se ka vjersha të pabotuara vjershëtarësh e shkrimtarësh shqiptarë, – të cilat janë të denja për botim t'i paraqesin në Komisioni të shoqëruar «me një recensim me shkrim të mbështetur në arsye të shëndosha» për t'i botuar.

Stimulimi për të zhvilluar më tej veprimtarinë artistike letrare shtrihet në përcaktime më të hollësishme. Në statut, për shembull, përcaktohet edhe botimi i «vjershave shqipe klasike e popullore». Këto të fundit gjejnë zbatim në projektin e përmbajtjes së organit botues «Lajmet e Komisionit Letrare Shqipe», që do të botohej më vonë.

Problemet e letërsisë ishin të pandara nga ato të zhvillimit që duhej të merrte kultura kombëtare. Është shumë i rëndësishëm vendimi që u mar për themelimin e një biblioteke me karakter albanologjik dhe artistik. Nevoja e themelimit të këtij institucioni u shtrua më 16.4.1917. Më 1.5.1917, pas diskutimit të gjërë të domosdoshmërisë dhe dobisë së tij, u mar vendimi për «Organizimin e Bibliotekës» dhe u ngarkua me detyrën e drejtorit të saj, anëtari i kësaj Komisioni, Hilë Mosi. Siç dihet, ajo është bërthama e parë e fondit të Bibliotekës Kombëtare, e cila u emërtua me këtë emër më 10.XII.1922, duke pasur në krye Sotir Kolenë.

Një kujdes të veçantë KLSH i kushton dhe përgatitjes dhe botimit të një të përkohshmeje mujore që do të përmbante «hartime, referate, kritika, lëndë gjuhësie d.m.th. mbi gramatikë, kritika mbi literaturë shqipe si dhe mbi libra shqip të vjetër e të rinj» si dhe «krijimtari letrare popullore». Programi i kësaj reviste, përmbajtjes së saj, afateve, vëllimit etj. KLSH i kushtoi disa mbledhje. Në mbledhjen e datës 22.5.1918 u caktua «Komiteti i redaksionit» detyrë që iu ngarkua Mati Logoreci dhe Maksimilian Lambertzi. Ky i fundit

u ngarkua dhe me kujdesin për ta dërguar e për ta shtypur në një shtypshkronjë të Vjenës. Botimi i numrit të parë të këtij organi që u bë në Vjenë, punë të cilën e ndiqte M. Lambertzi, u bë objekt kritike në dy drejtime: për gabimet e shumta gjuhësore dhe ato drejtshkrimore si dhe për futjen e ndonjë pjese të pamiraturar. Për këto arsye Gurakuqi i cili që nga dhjetori 1917 është edhe Kryetar i KLSH në vend të Gjergj Pekmezit, anulloi qarkullimin e tij. Çështja shkoi edhe më gjatë. Në mbledhjen e datës 10.4.1918, ku bën pjesë M. Logoreci, N. Mjeda, S. Nivica etj., u shtrua vlerësimi i Nr.1 të «Lajmet e Komissisë Letrare Shqipe» të botuar në Vjenë. Gurakuqi kritikoi rëndë shtypjen plot gabime të këtij organi. Në procesverbal thuhet: «Misët e Komissisë Letrare dëftojnë një papëlqim të plotë në të shtypunit e të përkohshëm» dhe se Komisia duke vlerësuar se «numri i parë i të përkohshëm është mbushë plot me gabime shtypidhe «gjuhe» dhe se nuk është marrë parasysh vendimi i saj i datës 27.2.1918 përmbi lëndë të këtij numri, vendosi të mos qarkullojë dhe «të ndalohet të shtypunit e numrave të tjerë në Vjenë», por të shtypen në Shkodër.

Siç mësohet nga epistolari i L.Gurakuqit me A.Xhuvanin, preokupimi i Gurakuqit për këtë revistë dhe sigurimi i bashkëpunimit të Xhuvanit në to që i madh. Më 10.6.1918, Gurakuqi e njofton Xhuvanin se është anuluar revista e shtypur në Vjenë e se është në procesin e rishtypjes në Shkodër. Nr. 7 i kësaj reviste, do të dalë në Shkodër. «Dorëshkrimi juaj - i shkruan ai Xhuvanit – do të dalë në Nr. 5-6, pra, duhet të na dërgoni sa më shpejt vijimin e tij për ta botuar në Nr.7, që do të dalë në korrik.

Gurakuqi i dha drejtim gjuhësor-letrar e kulturor këtij organi. Duke u kufizuar në këto fusha, ai përpunonte një rrugë të efektshme për emancipimin kulturor dhe në këtë kuadër përçonte ndjeshëm edukimin patriotik. Ai pati parasysh çdo herë se kishte të bënte me një pushtet të huaj, pushtues e ushtarak, të cilit i detyrohej t'i raportonte. Diapazoni i shikimit të perspektivës nga Gurakuqi që i admirueshëm. Në revistë lejoheshin dhe artikuj e studime të karakterit shkencor, por jo politikë dhe fetarë. «Tema degësh diturije kanë për t'u pëlqye për botim, vetëm atëherë kur të ketë një bukuri gjuhe të posaçme në vedi.»

* * *

Drejtimi i katërt që ai pedagogjik, arsimor, i përqëndruar kryesisht në përcaktimin e kriterëve të hartimit të teksteve mësimore, përgatitjen dhe botimin e tyre. Në mbledhjen e datës 7.5.1917, si dhe të 6.6.1917, tekstet e përgatitura nga S. Peci, Gj. Pekmezi, H. Mosi, u nënshtrohen diskutimit. Më 7.12.1917 u formua N/komisioni për librat shkollorë. Mbledhja e datës 22/5/1918 iu kushtua «Vështrimit dhe qortimit të librave shkollorë.»

Vendimet e KLSH për gjuhën letrare e për drejtshkrimin, si dhe tekstet e përgatitura nga ajo mbetën në fuqi edhe më vonë. Kongresi Arsimor i Lushnjës i gushtit 1920 i miratoi ato. Ato gjetën miratim edhe më 1923. Deri në Çlirim, drejtshkrimi i shqipes mbështetet në ato vendime.

Në një kuptim më të gjerë Komisia Letrare vazhdoi veprimtarinë e vet edhe pas vitit 1920. Sotir Peci i caktuar Ministër Arsimi në Qeverinë e Lushnjës të viti 1920, i cili gjatë funksionimit të KLSH-së kishte qenë vetë anëtar efektiv i saj, formoi Këshillin e Epërm Arsimor dhe në gjirin e tij, Komisinë Letrare Shqipe, po tashti në kushtet e çlirimit nga pushteti i huaj ushtarak.

(Marrë në: Gazeta “Drita”, 31.08.1986)

Át Gjergj Fishta (1871-1940)

Këtë vit u mbushën 145 vjet nga dita e lindjes së Át Gjergj Fishtës. Ai u lind në fshatin Fishtë të Zadrimës, në familjen e Ndokë Simonit, mbas tre fëmijësh të tjerë. Emni i pagëzimit ishte Zef. Për rastësi apo profeci, emnin ja pati njëjtë një tjetër françeskan i madh me origjinë shqiptare Át Leonardo de Martino.

Emnin Gjergj, e pati marrë vite më vonë, kur kreû kurset e nalta të përgatitjes meshtarake dhe mbërthehej përjetësisht në zhgunin e fratit.

Udhët e dijes dhe të meshtarisë i filloi në Kolegjin e famshëm Françeskan të Troshanit, e më vonë studimet filozofike dhe teologjike i plotësoi në kuvendet dhe manastiret e Bosnjës, si: Sutiska, Livno dhe Guca Gora, ku veç tjerash u njoh edhe me poetët e Rilindjes kroate, që lënë mbresa të pashlyeshme e u bënë muza poetike e epikës, aq të përdorun nga Fishta.

Me shugurimin e meshës së parë më 25 shkurt 1894, françeskanët fituen një vëlla të denjë për provincën e tyne, ndërsa Shqipnia, një shkrimtar, filozof, politikan dhe atdhetar të përmasave të mëdha. Qe pra një prej “fretënve minorë”, do të bahej një prej “Francheskanve të Mëdhaj”.

Veprimtaria e gjithanshme e Fishtës, në lamë të fesë, letërsisë dhe lëvizjes kulturore-patriotike e gjykueme ndër vite u shtri në dy faza: prej fundit të shekullit XIX e deri me shpalljen e Pavarësisë; për me u bënë figurë qëndrore e kulturës shqiptare e gjysmës së parë të shek. XX.

Ásht prift i Gomsiqes, (1899), mësues në Troshan; drejtor i Shkollës Fretnore të Shkodrës (1902), ku futi gjuhën shqipe në vend të asaj italiane; me Imzot Preng Doçin, abatin e Mirditës áshtë bashkëthemelues i shoqnisë “Bashkimi” (1899). E si përfaqësues i saj në Kongresin e Manastirit më 1908, zgjidhet edhe Kryetar i komisionit për caktimin e alfabetit. Qysh në vjetin 1905, boton në Zara blenin e parë të kryeveprës së tij “Lahuta e Malcís”, e më vonë edhe blenin e dýtë “Vranina”. Në Sarajevë me 1907, boton vëllimin: “Anzat e Parnasit”. Dy vjet më vonë nis me shkruar tragjedinë “Juda Makabe”, që e përfundon më 1910. Në vjetin 1911, shërben si ndërmjetës për

arritjen e Marrëveshjes së Paqes mes malcorëve të revoltuem të Dedë Gjo Lulit dhe Portës së Naltë. Gjatë këtyne vjetve nuk i mungojnë as mirënjohjet ndërkombëtare. Sulltani i Madhnishëm në 1912 e dekoron me urdhnin “Mearif”, për *Shërbime paqe dhe humaniteti*, ndërsa qeveria austro-hungare me urdhnin “Ritter Kreuz”.

Veprimtaria e Át Gjergj Fishtës, në fushën e letrave – i cilësuem edhe si Homeri shqiptar – është e gjanë. Ma poshtë po rendisimin disa prej tyne, tue iu referue kontributeve bibliografike të bashkwëllazënve të tij. Po mâ parë po japim një kronologji të veprimtarisë së autorit, si edhe të ngjarjeve që lidhen me figurën e tij.

1913. Më 12 qershor valvit flamurin kombëtar në kumbonen e Kishës françeskane në qendër të qytetit të Shkodrës dhe shkruen himnin e flamurit: “Porsi fleta e Ejllit t’Zotit”; në tetor themelon revistën “Hylli i Dritës”, “Vatër Kulture Shqiptare”, (me mjaft neshtrasha ndër vite nga autoritet shtetnore të hueja, por edhe shqiptare të kohës) ndërsa me 28 nandor në përvjetorin e parë të Pavarësisë, drita e një vargu kandilash lidhin kumbonen e kishës se fretënve me minaren e xhamisë, tuj zbukurue manifestimet, e tuj ftue muslimanë e katolikë të bashkoheshin për të mirën dhe përparimin e Atdheut.

1916. Së bashku me Luigj Gurakuqin është iniciator i “Komisisë letrare” dhe botues i gazetës “Posta e Shqypnis”.

1919. Sekretar i Përgjithshëm i Dërgatës qeveritare, në Konferencën e Paqes në Paris.

1921. Deputet dhe nënkryetar i të parit parlament shqiptar, dalë nga zgjedhjet e para në Shqipni.

1922. Gjatë vizitës së bame në Shtetet e Bashkueme të Amerikës, takohet me autoritetet e nalta fetare dhe civile tue ndikue në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

1930. Qeverija greke e dekoron me urdhnin “Phoenix”.

1933. Mbas polemikave të shumta me autoritetet civile të Ministrisë së Arsimit, mes të cilëve edhe me Hilë Mosin për çështjet e arsimit fetar dhe laik, me vendim të qeverisë së Ahmet Zogut në vitit 1933, mbyllën edhe shkollat e mbajtura prej fretenve. I prekun në shpirt e gati më lot për faqe¹, nxanësve të liceut “Illyricum” të

1 Daniel Gjeçaj, (Pal Dukagjini) *Jeta dhe veprat e Gjergj Fishtës*. Provinca françeskane shqip-

krijuem nga vetë ai në 1921, iu drejtue me fjalët: “Bij të dashtun, ç’me sot shkoni ndër shpia tueja e në shkolla Shteti, mbasi Shqipnia nuk po don ma veprën tonë! Por ani: Shqipnia rrhoftë edhe pa ne”.²

1935. Bashkëvëllaznit i japin mirënjohjen ma të madhe tuj e zgjedhë përmes votimit, Provincial të Provincës Françeskane shqiptare, post që e mban deri në vitin 1938.

1939. Emnohet Akademik i Italisë për “talentin e tij të rrallë, për kulturën e tij të hapët dhe për squetsinë e tij të bindshme”.³

1940. Sëmuret randë nësa ishte në Troshan me kalue do ditë, e me u taku me familjarët. Edhe përpjekjet e mjekëve të spitalit civil të Shkodrës, nuk mujtën me ndalë përkeqësimin e gjëndjes shëndetsore. Nderroi jetë në mesnatën e 29 dhjetorit.

“Mas një funerali, shoqin e të cilit s’e pau kurrë as Shkodra as Shqipnia arka e përmotshme... e mbulueme me flamurin autentik të Dedë Gjo’ Lulit... u vendos në Kishën e Gjuhadorit”⁴, më 31 dhjetor.

Gjatë viteve 1941-1944 françeskanët u munduen me botue korpusin e plotë të veprës së Át Gjergj Fishtës që përmblihdhte krahas veprave “Anzat e Parnasit” e “Mrizit të Zanavet” të ribotueme disa herë edhe “Gomari i Babatasit” (1923), “Lahuta e Malcís” (1937), e sa vepra të tjera në poezi, prozë, drama, përkthime, haggiografi, ligjerata, studime historike etj.

Pak para se me vdekë, Át Gjergj Fishta shkruente: “Shka u ka detyrë Shqipnia Françeskanëve? Kurrja. Pse? Françeskanët janë të Shqipnisë!”

Me ardhjen në pushtet të regjimit komunist, vepra e Át Gjergj Fishtës u përjashtue nga historia e letërsisë shqiptare. “Lahuta e Malcís” dhe vepra të tjera jo vetëm që u hjekën nga programet shkollore, por edhe u ndaluen të qarkullojnë. Fishta u cilësue shovinist, antikomunist, agjent i imprealizmit austro-hungarez, shërbëtor i fashizmit etj. , simbas etiketimeve të kohës.

Në vjetin e mbrapsht 1967, “...ia dhunuen vorrin; ...ia lujtën

tare, 1992, f. 147.

2 Po aty: f.147.

3 Po aty: f. 158.

4 Po aty: f.162

bucat, ia zbuluen rrasën; ia shlyen emnin...”;⁵ ia hodhën eshtnat në lumin Drin.

Siç përcaktojnë studiuesit: “*Fishta si gjithë të mëdhenjtë e tjerë, ka qenë dënue të kalojë dy fazat ma të rrezikshme për një personalitet njerëzor. Fazën e lavdisë për rreth 50 vjet dhe fazën e mohimit, për rreth 50 vjet. Le të shpresojmë Zotin se tash ka mbërritë për të faza e tretë: ajo e vlerësimit, ma e vërteta, ma e vështira*”.

Gjatë kësaj periudhe më se 25 vjeçare, – fatkeqsisht tranzitore të demokracisë, – u banë mjaft përpjekje për rivlerësimin e figurës së poetit.

Më 1991 në Shkodër themelohet shoqata kulturore “Át Gjergj Fishta”; në vitin 1992, fillon botimi i veprave të Fishtës, një vjetë ma vonë edhe botimi i “Hyllit të Dritës”; më 1995 gjenden pak eshtna në vorrin e tij, dhe i rindërtohet vendvorrin në Kishën e Françeskanëve, por gjithsesi vlerësimi mbetet prapë “ma e vështira” punë edhe në ditët e sotme.

Nuk ka si shpjegohet ndryshe veç si ripërtrimje e përbaltjes së figurës së Fishtës, si në vitet e para të çlirimit, “zbulimi”, publikimi dhe analiza e cekët, jashtëkontekstit kohor, nga ana e z. Nasho Jorgaqit, e një letre të Fishtës, drejtue një koloneli italian. Zoti Nasho Jorgaqi me një letër të epistolarit privat të autorit, don me rrëzue një monument të kombit dhe kulturës kombtare si Fishta. Ai po gabon në përcaktime të tilla, të pavërteta, të cilat nuk janë aspak të frýtshme dhe në këto çaste është e mira me i kujtue edhe një herë zotnisë në fjalë, shkrimet e njohësve cilësorë të Át Gjergj Fishtës, mes të cilëve edhe Pal Duka-Gjinin, i cili shprehej: “Derisa kjo tokë të qëndrojë, deri sa ky vend të vazhdojë të livrohet me parmendë ilirase, deri sa në gji të vet të rrisë filiza arbnorë, kjo tokë-po them- ka në dhé të vet pluhunin fishtjan. Ky pluhun s’pret tjetër shpërblim jashta se të jetë i tokës shqiptare: këtë të drejtë s’mund t’ia mohojë as s’mund t’ia heqë kush... E Fishta është i Shqipënisë edhe atëherë, kur Shqipënia nuk guxon ta përmendë, apo tue përmendë, shtrembënon buzët në shej alergjie”.⁶

5 Po aty: f. 163 Daniel Gjeçaj, (Pal Dukagjini) *Jeta dhe veprat e Gjergj Fishtës*, idem, f.164.

Bibliografi e veprave të Át Gjergj Fishtës

A. *Vepra poetike*

a. *Lirika*

1. *Pika voëset*, Zara, 1909.
2. *Mrizi i Zanavet*, Shkodër, 1913, 1924, 1931, 1941.
3. *Vallja e Parrîzit*, Shkodër 1925, 1941.

b. *Epika*

1. *Lahuta e Malcís*, Shkodër, 1937.

c. *Dramatika*

1. *Sh' Françesku i Asizit*, Shkodër, 1909.
2. *Shqyptari i gjytetnuem*, Shkodër, 1911.
3. *Juda Makabé*, Shkodër, 1920; Lezhë 1995.
4. *Barít e Betlemit*, Shkodër, 1925.
5. *Sh'Luigj Gonzaga*, Shkodër 1927.
6. *Shqyptarja e gjytetnueme*, Shkodër, 1929.
7. *Ifigenija n'Aullí*, Shkodër, 1931.
8. *Odisea*, Shkodër, 1931.
9. *Jerina ase Mbretnesha e lulevet*, Shkodër, 1941.

d. *Satira*

1. *Anzat e Parnasit*, Sarajevë 1907; Shkodër, 1928, 1942; Romë, 1971; Prishtinë, 1990.
2. *Gomari i Babatasit*, Shkodër, 1923, 1941, 1942; Romë, 1971; Tiranë, 1994.
3. *Taralloqja e Ballkanit*, Shkodër, 1944.
4. *Visku i Babatasit*, Tiranë, 1994.
5. *Nikolejda*, Tiranë, 1994.

e. *Agiografi*

1. *Shna Ndou i Padues*, Shkodër, 1927.

f. *Përshtatje dhe përkthime*

1. *I ligu per mend*, Shkodër, 1921.
2. *Dredhitë e Patukut*, Shkodër, 1924.
3. *Prozodi latine*, Shkodër, 1924.
4. *Nji darkë në konvikt*, Shkodër, 1924.
5. *Shkolla e muzikës*, Shkodër, 1924.

g. *Botime antologjike*

1. *Poezi, Lezhë*, 1994.
2. *Mrizi i Zanavet, Tiranë*, 1994.

h. *Të ndryshme*

1. *Kombsia e kleri katolik, Shkodër*, 1907.
2. *Epopeja e fisit shqyptar, Shkodër*, 1920.
3. *Shqyptarët e të drejtat e tyne, Shkodër*, 1920.

A. PROZA

I. Sociologji. II. Polemikë. III. Ligjërata. IV. Miscelanea (Në Albania: *Hylli i Dritës; Posta e Shqypnís; Gruaja Shqyptare; Ora e Maleve; Vullneti; Afrimi e Politika e Vlorës; Dielli (Boston); Zâni i Shna Ndout; Perparimi; La nazione Albanese; Kalendari i Veprës pijore; Leka; Shkëndia etj.*

TË PABOTUEME

1. *Ushtrimet e para poetike;*
2. *Dekolacjoni i Sh. Gjonit (dramë);*
4. *Aneksioni i Bosnes;*
5. *Gjashtë net kazanash (pralla kombtare);*
6. *Makabejt;*
7. *Kufijt e Shqypnís;*
8. *Psikologjia e popullit shqyptar;*
9. *Mjek perdhuni (nga Molière);*
10. *Në dekë të Franz Jozefit;*
11. *Roma e Çezarve e Shqypnija;*
12. *Për alfabetin latin;*
13. *Pata (farsë me një akt);*
14. *Triumfi i virtytevet mbi vese;*
19. *Tingllime e kangë të Françesk Petrarkës;*
20. *Epistolari.*

***Gjurmë të At' Shtjefën Gjeçovit në Bibliotekën
Publike "Marin Barleti"***

Dihet tashmë se Biblioteka Publike "Marin Barleti" ka një pasuri të madhe me koleksione të rëndësishme (i antikuariatit, i dorëshkrimeve, i albano-ballkanologjisë e i hartave), ndër të tjera, edhe për studimet albanologjike. Prandaj kemi të sistemuar në fondin e Albano-Balkanologjisë, gjithë ato (libra, periodikë, harta etj.) që janë vlerësuar nga intelektualë të ndryshëm ndër vite të përshtatshme për atë fond.

Krijimi i kësaj biblioteke ishte fryt i një tradite të vyer të qytetit tonë, traditë e filluar që në mesjetë, e vijuar më pas me bibliotekën Bogdani, dhe atë të Myftiut të Tabakëve. Biblioteka të rëndësishme të Shkodrës kanë qënë edhe ato të institucioneve fetare siç ishte biblioteka e Medrezes së Naltë pranë Kalasë, bibliotekat e çmuara të etërve Jezuitë (1858) dhe atyre Françeskanë (1875). Bibliotekat e shoqërive dhe private: bibliotekat e shoqërisë: "Bashkimi", "Agimi", "Gjuha shqipe", "Komisia Letrare" etj. Biblioteka e P.Vasës, Z. Jubanit, F. Shirokës, vëllezërve Ivanaj, familjes Kamsi, H. Gjylbegu, H. Bushati, Ll. Karafili, K. Idromeno, K. Gurakuqi, M. Krujës, E. Koliqit, J. Kastrati etj. Bibliotekat publike: e para bibliotekë publike dhe ndër të parat biblioteka albanologjike, e njohur si biblioteka e "Komisisë letrare", u krijua në Shkodër në vitin 1916, me drejtues Hilë Mosi.

Biblioteka Franceskane njohu lulëzimin në vitin 1921 në sajë të përkushtimit të Gj. Fishtës, P. Dodajt, Sh. Gjeçovit, P. Bardhit e sa të tjerëve. Në bibliotekë ruheshin dorëshkrime me vlerë të Zarishtës, Gjeçovit, Marlaskajt etj... Në vitin 1945 me mbylljen e institucioneve fetare dhe organizimeve shoqërore, një pjesë e fondit të bibliotekave të tyre i kaluan në zotërim bibliotekës publike. Në fondet e saj ruhen libra të shekullit XV-XVI të shtypur në qendra të mëdha të Europës, si: Gjermani, Zvicër, Paris, Itali etj., të cilët dallohen nga teknika e shtypjes dhe bukuria e tyre në paraqitje.

Pra, në koleksionet me vlerë, ndër të tjera, kemi gjetur një numër të konsiderueshëm të librave që mbajnë firmën e At' Gjergj Fishtës,

At' Sh. Gjeçovit, P.Bardhit e sa të tjerëve si dhe vulën e Bibliotekës Françeskane.

Këtu do të pasqyrojmë një listë me libra të fondit të Albano-Ballkanologjisë, që mbajnë firmën e At' Shtjefën Gjeçovit, e cila është mjaft interesante nga pikëpamja e zgjedhjes së titujve të librave. Ndër to të tërheq vëmendjen: *"Jeta e sheites Sc.Drano Virgin"*, në faqen e prapme të kopertinës lexojmë, *"Maâ i pari liber knnue n' Brukhase Gjûhadol 30.I.1907 Me firmen Gjecov"*.

Me të drejtë lexuesi mund të pyesin: Prej kah erdhën këto libra në bibliotekën e qytetit? Kemi me pasë rasin me e trajtue ndër shkrime të tjera pyetjen që mund të bahet, por qëllimi i jonë këtë radhë asht me demonstru një pjesë të pasunive arkivore të bibliotekës. Gjithsesi për me shue kureshtjen e lexuesve, po sjellim këtu dëshminë At Zef Pllumit o.f.m të shkrueme në librin: "Histori kurr e shkrueme".

Më 9 qershor të vitit 1946. Kuvendi i françeskanëve dhe çdo gja që ndodhej mbrenda këtij kuvendi, mes të cilave edhe biblioteka u shtetëzuan. Një pjesë e vlerave muzeale dhe arkiva e Kuvendit u përpoq të shpëtoheshin nga françeskanët tuj u groposë, ndërsa biblioteka jo.

"Biblioteka-shkruen Atë Zefi- sado që kishte libra të rrallë dhe shumë të çmueshëm , nuk kishte mundësi me u lëvizë sepse binte në sy, mbasi ishte njoftun prej shumëkujt, dhe mjaft intelektualë vijshin dhe kërkoshin herë një libër herë një tjetër. Grushtin e parë ajo e pat vetëm në fillim të vitit 1945, kur një ekipi njerëzve të kulturës, të ardhun prej Tiranë, me listë në dorë, kërkoi fotokopjet e Buzukut dhe të Matrangës, Hahnin dhe një sasi librash që i dijshin për ma t'çmueshmit, thanë se ishin tue i marrë për Bibliotekën Kombëtare, dhe se duheshin vu në dispozicion të gjith popullit e jo vetëm për një komunitet të vogël siç ish Kuvendi Françeskan"¹

Një pjesë e fondit të kësaj bibliotekë gjatë vitit 1946 u vendos edhe në bibliotekën e qytetit tonë.

Na jepet rasti në këtë shkrim me falenderu punëtorët e bibliotekës ndër vite, për kujdesjen që treguan në ruajtjen e mirëmbajtjen e kësaj pasunie të rrallë.

*Libra e revista që mbajnë firmën e At' Shtjefën Gjeçovit
(në renditje kronologjike)*

- A. Bussieres(de), Joannis. *Miscellanea poetica Scanderbegus*, Lugduni, Ex officinal Anissoniana, 1675, F. 528, Al. 21 / 18 F
- A. Bogdano, Pietro. *Cuneos Prophetarum de Christo Salvatore Mundi. Pars I...*, Patavi, 1685, Al 25 / 2 E
- A. Sagredo, G., *Memorie Istoriche de monarchi ottomani*, Venetia, 1688, F.829, Bal. 34 / 16 A
- A. *Selectae e Profanis scriptoribus.Historiae...*, Venetis, 1817, F. 386, Al. 24 / 3 F
- A. *Martiç, Pjesniçka djela*, Sarajevë, 1893, F. 689, Bal. 32 / 33 E
- A. Frashëri, Naim.*Histori e Skënderbeut*, Bukuresht, Shtypshkronja “Shqipëtarëvet” 1898, F. 309, Al. 1 / 39 B
- A. Frashëri, Sami. *Abetare e guhësë cqip*, Bukuresht : Shtypshkronja e Shoqërisë “Dituria” , 1900, F.75 + 4.fl.alf., Al. 1 / 100 E
- A. Frashëri, Naim. *Poima*, Sofie, Shtypshkronja”Mbrothësia” K.Luarasi, 1903, F. 16, Al. 1 / 83 G
- A. Olschki,Leo.S.*Histoire de l’Empire Ottoman...*, Florence, Imp. Franceschini & C., 1903, F. 183, Al. 22 / 61 B
- A. Siljani,A. *Besa a fea e cqihtarëvet të vjetër*, Sofie, Shtypshkronja”Mbrothësia” K.Luarasi, 1907, F.80, Al. 2 / 69 D
- A. Fishta, Gjergj. *Pika voëset: vjersha*, Zader (Zarë), Shtypshkronja “Ernesto Vitaliani”, 1909, F. 62, Al. 8 / 2 D
- A. *Memoire sur la decision prise par l’Assemblee generale...*, S.l, 1911, F. 8 frëngj.+8 shqip, Al. 22 / 23 D
- A. *Albania. Guida militare*, Roma, Lab.Tip. Del Comando del Corpo di Stato Maggiore,1915, F. 62+4 appendici, Al. 22 / 18 D
- A. *Excerpta ex Codice Juris Canonici P II X...*, Shkodër, Shtypshkronja”Nikaj”, 1918, F. 134, Al. 21 / 12 E
- A. *Hylli i Dritës, Vjeti II - 1921*, Shkodër, Shtypshkronja ”Franciskane”, 1921,F. 376, Al 18 / 3 A
- A. Karafilii,Llukë.*Histori e Shqipërisë Pj.II(Epiri)*, Vlorë,

- Shtypshkronja “Vlorë”, 1921, F.77, Al. 1 / 62 G
- A. *Organizim i Administratës së Provincës së Shkodrës*, Shkodër, Shtypshkronja ”Nikaj”, 1921, F. 15, Al. 1 / 163 C
- A. *Qarkoret e Ministrisë së Punëve të Mbrendshme të vjetit 1920*, Shkodër, Shtypshkronja”Nikaj”, 1921, F.102, Al. 1 / 97 A
- A. Selenica, Teki. *Shqipëria më 1923*, Tiranë, Shtypshkronja”Tirana”, 1923, F.242. Al. 1 / 66 B
- A. *Statuta Provinciae SS. Annuntiationis Patrum Franciscanorum in Albania*, Scodrae, Typis Franciscanis, 1923, F. 18, Al. 22 / 6 G
- A. *Jeta e sheites Sc.Drano Virgin....*, P.v., p.v., F. 15, Al. 10 / 26 F
- A. Nieuport, G.H. *Antiquitates Romanorum*, S.l., s.a., F.552+Index 39 f., Bal. 34 / 17 E

Koleksioni i dorëshkrimeve është një koleksion relativisht i pasur. Në të gjenden rreth 155 dorëshkrime e daktilografime .

Në koleksionin e dorëshkrimeve gjejmë:
(në renditje alfabetike)

1. Arkiv e kishes Prekalit, F.17-134
2. Bibliografija e At’ Shtjefën Gjeçovit, F.90
3. Copëza shënimesh historike, F.8.
4. Dera e brezat e Dukagjinëve, F. 138.
5. Një letër e At’ Shtjefën Gjeçovit dhe letra..., F. 44fl+3f. e daktilografuar
6. Parradija e popullit ase Kryengritja e Dheut të rrethit të Krues me 54 pleq në krye, kundra urdhënve e dokeve të reja t’osmanllive: 1903-1904-1905-1906, Laç-Sebaste, 1922, F. 6+1.
7. Shënime historike, F. 35+4+1fl.
8. Shënime të “*Kanunit të Lek Dukagjinit*”, F.51
9. Shënime të *Kanunit Lekë Dukagjinit*, F. 51.

*Vepra të At' Shtjefën Gjeçovit që ndodhen
në bibliotekën tonë (në renditje kronologjike)*

1. *Pajtorja e Durzit A se Sc.Lucia V. e M....*, Sckoder, Ne sctepsckroje t'Zojes Zanun pa mkat t' rriejscem,1905, F. 37, Al. 3 / 35 E
2. *Agimi i gjytetniis*, Shkodër, Shtypshkronja”Nikaj”, 1910, F. 144, Al. 4 / 36 D
3. Bergamo, A.F. *Vajza e Orleansit asé e Lumja Joana D'Ark*, (Shqypnue prej) Shtjefën K. Gjeçovit, Shkodër: Shtypshkronja e Zojës s'Paperlyeme, 1915, F.174, S. 124 / 9 E
4. *Kanunit të Lek Dukagjinit*, Shkodër: Botime françeskane,1933, F.144, Al. 2 / 71 A
5. Fox, Len (përkth.), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Neë York, Gjonlekaj, 1989, F. 296, S / 55 / 23 E ; Al 15 / 30 A;S 159 / 1 C
6. *Kanunit të Lek Dukagjinit*, Lezhë: Kuvendi, 1998+2001, F. 135, Al. 5 / 2 C e 15 / 3 C
7. *Shtyllat e Kombit: Publicistikë*, Tiranë,Reklama,1999,F. 112, Al. 14 / 1 F; S. 64 / 76 B
8. *Tomorr e Pashtrik përpiquni*, Tiranë,Reklama,2000, F. 64, Al.14 / 2 F; S. 64 / 81 B
9. *Kanunit të Lek Dukagjinit*, Shkodër: Botime françeskane, 2010, F.144, Al. 10 / 23 A

Shkodër, më 25.10.2015

***Mbi sprovën etnomuzikologjike “Pse qanë kuajt e Akilit?
“E qara me bote” dhe prejardhja e iso-polifonisë
popullore shqiptare” me autor Prof. dr. Vasil Tole***

Në studimin “Pse qanë kuajt e Akilit? “E qara me bote” dhe prejardhja e iso-polifonisë popullore shqiptare”, autori bën objekt një nga format më arkaike të artit muzikor e letrar të popullit tonë: *vajtimin*, veçanërisht atë të Jugut të Shqipërisë të emërtuar edhe si e “qara me bote” si dhe *iso-polifoninë* që e shoqëron atë.

Punimi ndahet, në: Parathënie; Hyrje; si dhe në kapitujt: I. “E qara me bote- ulërimë”, shtrati i lindjes së iso-polifonisë; II. Iso-polifonia, kultura shpirtërore kundër dhimbjes; III. Iso-polifonia si kor muzikor; IV. Pse qanë kuajt e Akilit. Ritualet tragjike tek *Iliada* dhe *Odiseja* dhe tiparet e përbashkëta të vajtimeve; Epilog. Sikundër shprehet autori në parathënie studimi është një përpjekje për t’u futur në domethënien e praktikave ritualistike arkaike vajtime, si një mundësi më shumë për t’iu afruar rrënjëve të antropogjenezës shqiptare, thelbit dhe prejardhjes së muzikës dhe këndimit iso-polifonik vajtues si kulturë për jetën, kundër dhimbjes. Autori nis prej konceptit se tradita jonë popullore përbëhet prej shtresash kulturore të cilat duke u studiuar mund të na japin rezultate të reja për historinë tonë kulturore, shpirtërore e artistike.

Më tej në hyrjen me titull: “*Mbi vajin dhe vajtimin tragjik*” na janë dhënë dhe parashtruar disa informacione dhe hipoteza interesante mbi lashtësinë e vajeve shqiptare mbi të vdekurin, të pranishme këto si në Veri ashtu edhe në jug. Mbështetur edhe në mendimin e studiuesve të kësaj fushe autori e përcakton vajtimin si një ritual arkaik të lidhur ngushtë me besimet politeiste prej kohëve mitike, i cili përmban një përzierje elementesh që përfshijnë: të folurën patetike, të thirrurat, kujën, ulërimat dhe këngëtimin vajtimor, si shprehje e pasqyrit të zisë në kulmin e dëshpërimit dhe të dhimbjes njerëzore⁴⁸. Në këto elemente të ritualit të vajtimit autori sheh edhe *paraelemente* të

48 Tole, Vasil S. *Pse qanë kuajt e Akilit? “E qara me bote” dhe prejardhja e iso-polifonisë popullore shqiptare*. Mediaprint, Tiranë 2011, f. 17-18-19.

*lashta muzikore*⁴⁹. Gjurmë të vajeve dhe ritualeve arkaike autori gjen në gjamën e burrave në Veri të Shqipërisë, të shprehur edhe në këngët e eposit të kreshnikëve, përveçse në gjamët e mirëfillta në traditën popullore të Veriut, ndërsa në dokumente të shkruara kemi të dhëna që nga Antonio Sabelliki, e më pas nga Barleti, për ekzistencën e vajeve për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriotin- Skënderbeun, e pastaj sistematikisht në dokumentet e autorëve të tjerë shqiptarë e të huaj: Bogdani, Dhimitër Frangu, Budi, Bardhi, Evlia Çelebia, Dorsa, von Hahn, Elena Gjika, Jubani, De Rada, Gurakuqi, Prennushi, Lambertzi etj. Nga ana muzikore vëren autori se në këto vajtime të Veriut dallohet ekzistenca e një sistemi muzikor të patemperuar ku bie dukshëm në sy modaliteti i shkallëve muzikore popullore, të mbështetura në të kënduarin muzikor njëzërësh⁵⁰ndërsa në vajtimet e Jugut kemi të qarën dhe të kënduarin shumëzërësh, isopolifonik⁵¹ në dy tipa kryesorë: në Labëri, iso-polifoni labe, në Toskëri, si isopolifoni toske. Rrënjët e lashta të iso-polifonisë autori i kërkon tek “e qara me bote” të cilën e karakterizon *si bërthama arkaike e të menduarit dhe e praktikës muzikore shumëzërëshe, por edhe lënda artistike që krijoi ansamblin e parë interpretues në botë: korin*⁵². Në vajtimin iso-polifonik të Jugut, autori vëren, si ritualin e lashtë të ceremonive mortore, të lidhura ngushtë me poezinë popullore dhe me vallëzimin, ashtu edhe krijimin e modelit artistik muzikor të vajtimet shumëzërësh në grup⁵³. Të kënduarin në grup ai e sheh edhe si një tregues të nivelit të demokracisë dhe shoqërizimit të njeriut në kohërat antike. Ndërkaqpërmes këtyre ritualeve vajtimore të gjallët nderojnë të vdekurit dhe shërojnë veten nga dhimbja, duke realizuar një lloj terapie muzikore natyrore.

Në kapitullin: I. “*E qara me bote- ulërimë*”, shtrati i lindjes së iso-polifonisë autori shpjegon etimologjinë e fjalës “bote” që ka kuptimin “shtamë”- enë balte me të cilën mbushej ujë, por që ka

49 Po aty, f. 19.

50 Po aty, f. 24.

51 Po aty, f. 28.

52 Po aty, f. 29.

53 Po aty, f. 30.

lidhje edhe me kuptime të tjera si: *botë, dhe, baltë, deltinë*; që mund të interpretohet si “e qarë me bote” “e qarë me shtama” por edhe me kuptimin simbolik “e qarë për dheun, tokën”, si vajtim për njeriun dhe tokën. Në strukturën e saj ajo ruan bërthamën e iso-polifonisë. Duke u ndalur në konceptimin e vdekjes nga shqiptarët sipas këngëve të tyre, autori ka mendimin se iso-polifonia, si prodhim shumëtingullor i të “qarës me bote” ka lindur në një hallkë shumë të rëndësishme kohore, e cila përfaqëson momentin e ndërmjetëm që qëndron mes vdekjes trupore mbi tokë dhe përcjelljes në botën e pasosur⁵⁴; ajo qëndron si lumi Akeront, mes jetës dhe vdekjes. Isoja, shprehet autori, në fakt është motori i gjenerimit të çlirimit për shkak të natyrës së saj të thjeshtë: thithje dhe nxjerrje e ajrit në formë tingulli, përmes diafragmës që hapet e mbyllet pambarimisht në harmoni sublime me veten dhe të tjerët, duke çliruar prej së brendshmi substancën shëruese të endorfinës dhe analgjezisë, pasi muzika e isos ka një efekt të d.p.d. për qetësimin e ritmit të zemrës dhe të frymëmarrjes⁵⁵. Një nga përjasjet e preferuara të autorit është ajo e përjasjes me botën antike greke. Faktin se lumi i vdekjes Akeronti dhe Hadesi që përshkruan Homeri, gjenden në Thesprotinë e dikurshme, Çamërinë e sotme, në Shqipërinë e Jugut, mund të dëshmojnë edhe në favor të pranisë së vajtimeve iso-polifonike, pikërisht në këtë zonë, si zonë ndërmjetëse mes jetës dhe vdekjes, por edhe si zonë në të cilën riti i varrimit në tuma e ka filluesën që në epokën e bronzit, duke u bërë riti kryesor i varrimit gjatë epokës së hekurit. Qëndrimi në formë gjysëm rrethi i korit të iso-polifonisë, ka lidhje me kultin e diellit dhe me vallet mortore rreth varrit në kohët e lashta, si dhe me faktin se ajo ka qenë shoqëruese e këtyre valleve.

Më tej në këtë studim autori na njeh me veçoritë e këndimit të “vajtimit me bote” isopolifonisë ku veprojnë *Marrësit, Prerësit, Kthyesit, Hedhësit dhe Isoja* e grupit të mbështetësve. Autori ynë e kërkon zanafillën e iso-polifonisë tek kultet e vjetra mbi jetën dhe vdekjen, dritën dhe errësirën, ku iso-polifonia lidhet me ngjyrën e zezë, me errësirën, me vdekjen dhe me zinë e mbajtur për të vdekurin

54 Po aty, f. 43.

55 Po aty, f. 47.

përmes vajtimit apo përmes teshave të trupit në ngjyrë të zezë. Dhe isoploifonia na del edhe si kod muzikor i ngjyrës së zezë, vdekjes, që është edhe shenjë simbolike e identitetit kulturor e historik krahas ngjyrës së kuqe, si raport mes jetës dhe vdekjes, të mishëruara edhe në flamurin tonë kombëtar.

Në kapitullin: II. *Iso-polifonia, kultura shpirtërore kundër dhimbjes*, na përshkruhet procedura e ritualit të vajtimit, të quajtur edhe *ksoll*, që përgatit iso-polifoninë, llojet e iso-polifonisë. Ksoll përfshin lajmërimin e njerëzve për vdekjen, hapjen e vajtimit, të qarën me bote, gjestikulacionet dhe lëvizjet gjatë vajtimit, mbylljen e vajit, kohën e zisë dhe mbylljes së saj. Në shtjellimin e llojeve të iso-polifonisë autori mendon se duhet studiuar edhe më thellë çështja se si nga modelet iso-polifonike vajtuese, populli arriti të ndërtonte një repertor muzikor të plotë, larminë e llojeve dhe të strukturave të organizimit të saj si dukuri bazë në gjithë muzikën popullore të Shqipërisë së Jugut⁵⁶ pavarësisht nga prirja për të kërkuar një gjini muzikore larg iso-polifonisë vajtuese. Kështu kemi “të qarën” e Kabasë me gërneta dhe violina, apo “të qara” me instrumente të tjera popullore, të cilat kanë marrë motivin bazë të iso-polifonisë për të ndërtuar diçka të re por të lidhur me strukturat e vjetra. Pastaj lloje të tjera të iso-polifonisë janë “E qara”, “E qara me ligje”, “Gjëma”, “Këngët me griqë”, “Borrohitjet”, “Logatjet”, “Logorisjet”, “Dy tre vetçe Dukaçe”.

Në kapitullin: III. *Iso-polifonia si kor muzikor*, janë shumë interesante dhe të guximshme qasjet mes iso-polifonisë shqiptare dhe korit në tragjedinë greke të antikitetit. Fjalën “kor” autori e shpjegon si *valle në rreth*, që na kujton vallen në rreth varrit dhe gjysëm rrethin e iso-polifonisë, rrethin si simbol i diellit. Autori kërkon prejardhjen e korit të tragjedisë në ritualet arkaike të lidhura me vdekjen si dhe me vajtimet korale të natyrës iso-polifonike pa vegla muzikore. Sikurse në iso-polifoni edhe në tragjedinë antike greke eskiliane Kori ka një rol të rëndësishëm. Numri ideal i pjesëtarëve të korit të iso-polifonisë ka qenë 12 veta duke përfshirë edhe solistët e zërave kryesorë që janë tre, pra po aq sa në tragjeditë e Eskilit. Gjithashtu stili i vajtimit

56 Po aty, f. 123.

tek e “qara me ligje” nënkuptonte një vajtim të shoqëruar me tekst, vajtoret profesioniste që ishin pothuajse aktore dhe luanin në shfaqje të ndryshme, afronin ritualin mortor shqiptar me tragjeditë antike. Ndërkaq sikurse në tragjedi veprimi edhe në iso-polifoni zgjat sa një rrotullim dielli, ose e kalon këtë masë fare pak. Poashtu si në tragjedi edhe në iso-polifoni bashkëveprojnë me njëra-tjetrën: e folura, e ligjëruara- e kënduara me zë, dhe lëvizjet, gjestikulacioni. Në qendër të vajtimit masiv qëndron kori i isos. Në iso-polifoni si në tragjeditë antike, zëri i parë është protagonist, aktori kryesor, ai që fut në veprim korin, zëri i dytë është i kundërti i të parit, isoja masive është shprehje dhe organizim i korit anonim popullor. Autori mbërrin në përfundimin se: ashtu si kultura dhe tragjedia antike greke lindi prej epikës dhe ritualit edhe iso-polifonia nuk është gjë tjetërveçse formë artistike e tragjedisë njerëzore, e gdhendur në muzikë prej dhimbjes së masës së familjarëve të mbledhur në ksoll⁵⁷. Prandaj ai e sheh iso-polifoninë si një dramë me një akt me tri personazhe kryesore: marrësi, prerësi, dhe kthyesi, të mbështetur nga kori- sinonim i popullit që nuk vdes kurrë ndërsa vlerëson se kori shumëzërësh vajtimor epik e kishte krijuar modelin e tij në traditën e gjallë folklorike përpara se sa të krijoheshin modelet e para artistike të tij në skenë⁵⁸. Gjithashtu autori në këtë kapitull vlerëson se edhe në periudhat e mëvonshme muzika bizantine është ushqyer nga kulturat tradicionale të popujve që praktikonin fenë e krishterë në lindjen evropiane.⁵⁹

Në kapitullin: IV. *Pse qanë kuajt e Akilit*, hyn edhe më në detaje të përkimeve të ritualeve të vdekjes dhe vajtimeve të përshkruara në veprat e Homerit dhe atyre në traditën tonë folklorike. Te *Iliada* është madhështor përshkrimi i ritualit të vdekjes për nderimin e Patroklit që përfshin, lajmërimin e vdekjes së tij, vajtimin, ritualin e varrimit etj. Fillimisht ai qahet prej kuajve të pavdekshëm të Akilit. Këtë element e gjen studiuesi ynë edhe në vajtimet iso-polifonike labe të mbledhura nga Th. Mitko te vepra e tij *Bleta shqiptare*”, ku vajtori, përmend edhe vajtimin e kuajve për të zotin, po ashtu Elena Gjika

57 Po aty, f. 143.

58 Po aty, f. 145.

59 Po aty, f. 159.

thotë se në poezinë popullore shqiptare gjendet shembulli kur kali qan për vdekjen e të zotit Skenderbeut, derisa sa plasi. Po ashtu në eposin tonë të kreshnikëve gjogu i Mujit si kali i Hektori ushqehet me elb dhe verë. Dhimitër Kamarda te arbëreshët thotë se në poezinë arbëreshe kuajt flasin me zotërit e tyre, zogjtë flasin etj. Akili vajton duke vikatur dhe duke rrahur gjoksin me duar sikurse bëjnë gjamatarët shqiptarë etj. Po ashtu kemi edhe ritualin e vdekjes së Hektorit, që shënohet me njoftimin e vdekjes, vajtimin, ritualin e vdekjes, varrimin, ngritjen e muranës etj. E njëjta skemë përshkruan edhe ritualin e vdekjes së Akilit, ku kemi përsëri kuajt që flasin si në poezinë tonë popullore. Studiuesi ynë gjen elemente të ngjashme mes vajtimit që përshkruan Homeri për Akilin me ritualet që gjenden në Shqipërinë e Jugut, me të qarën jashtë dhe brenda, ku brenda qajnë gratë të vdekurin ndërsa jashtë qajnë burrat. Akilit pas vdekjes në shenjë nderimi i ndërtojnë një muranë prej guri të ashpër, ndërsa studiuesi ynë na flet për gjurmë të qivureve prej guri në bregdetin malor të Himarës, në shenjë nderimi ndaj të vdekurve.

Sigurisht në këtë studim që autori e emërton si “sprovë etnomuzikologjie” trajtohen edhe shumë çështje të tjera veçanërisht në rrafshin muzikologjik, të lidhura me iso-polifoninë, që zgjojnë interes jo vetëm për specialistët e kësaj fushe por edhe për lexuesit e tjerë të interesuar për kulturën dhe traditën tonë të lashtë kulturore, e cila siç e tregon edhe ky studim ka ende të fshehta të pandriçuara. Punimi përshkohet nga një ligjërim i zhdërvjellët ku harmonizohen me mjeshtëri informacioni enciklopedik me interpretime e dekodifikime interesante të dukurive nëpër të cilat ka kaluar në shekuj kultura jonë kombëtare. Duke i uruar punime të tjera autorit do t’i sugjeroja një studim të ngjashëm për gjamën e Shqipërisë së Veriut, një studim që do të ishte ndoshta një vazhdim i këtij studimi për të cilin diskutuam sot.

cip katalogimi